

Botues:
Komuniteti Mysliman i Shqipërisë

Zani i Naltë

Revistë shkencore dhe kulturore

VITI XII (XXVI) 2024, NR. 39 (192)

Merret me shkenca islame, sociologji, filozofi, psikologji,
histori, gjuhësi, letërsi, moral dhe literaturë kombëtare

www.zaninalte.al

Tiranë, 2024

Zani i Naltë

Revistë shkencore, organ i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë

Themeluar në tetor 1923, rifilluar në tetor 2012

VITI XII (XXVI), qershor - dhjetor 2024 nr. 39 (192)

Nën kujdesin e: H. Bujar Spahiu

Drejtor: Dorian Demetja

Kryeredaktor: Armand Asllani

Bordi editorial: Prof. Dr. Gjergj Sinani, Universiteti Bedër
Prof. Asoc. Dr. Genti Kruja, Universiteti Bedër
Prof. Asoc. Dr. Rahim Ombashi, Universiteti Bedër
Dr. Skender Bruçaj, Universiteti Bedër
Dr. Brikena Smajli, Universiteti Bedër
Dr. Hasan Bello, QSA, Instituti i Historisë
PHD. Cand. Elton Karaj, Universiteti Bedër
H. Jusuf Zimeri, Bashkësia Fetare Islame e Maqedonisë së Veriut
MA. Ramadan Shkodra, Bashkësia Islame e Kosovës

Redaktor: Mehmet Disha

Në anglisht: Redaksia

Zani i Naltë

Bordi shkencor: Prof. Dr. Ayhan Tekines, Austri
Prof. Dr. Hajri Shehu, Tiranë
Prof. Dr. Qazim Qazimi, Kosovë
Prof. Dr. Sadije Bushati
Prof. Asc. Dr. Saimir Shatku, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës
Prof. Asoc. Tidita Abdurrahmani, Universiteti Bedër
Prof. Asoc. Dr. Fahrush Rexhepi, Fakulteti i Studimeve Islame, Prishtinë
Prof. Asoc. Dr. Majlinda Peza-Perriu, Universiteti “Al. Xhuvani”, Elbasan
Doc. Dr. Fahredin Ebibi, Fakulteti i Shkencave Islame, Shkup
Doc. Dr. Naser Ramadani, Fakulteti i Shkencave Islame, Shkup
Doc. Dr. Ramadan Çipuri, Universiteti i Tiranës
Dr. Ana Uka, Universiteti Bedër
Dr. Agron Tufa, Zvicër
Dr. Ardian Muhaj, Instituti i Historisë, Qendra e Studimeve Albanologjike
Dr. Atakan Derelioglu, SHBA
Dr. Erlis Çela, Universiteti Bedër
Dr. Ilirjana Kaceli, Universiteti Bedër
Dr. Matilda Likaj, Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës
Dr. Xhemal Seferti, Universiteti Bedër
PhD. Cand. Ali Zaimi, Universiteti Bedër
PHD. Cand. Hysni Skura, Universiteti Bedër
MS/MA Fatos Kopliku, Washington DC, SHBA
MA. Sabri Bajgora, Instituti për Hulumtëme dhe Studime Islame, Prishtinë
Msc. Lorela Shehu, Universiteti Florida
H. Resul Rexhepi, Prishtinë
Xhemal Balla, Tiranë

Fushat: Shkencat Islame / Tefsir / Hadith / Fikh / Sociologji / Filozofi / Gjuhësi / Letërsi / Psikologji / Histori / Kulturë / Art, etj.

Realizimi grafik: Erzen Carja

Fotoja në kopertinë: Xhamia e vjetër e Durrsit, viti 1862

Adresa: Komuniteti Mysliman i Shqipërisë
Rr. “George W. Bush”, Nr. 50, Tiranë - Shqipëri

e-mail: info@zaninalte.al

Web: www.zaninalte.al

Përmbajtja

Studime

1. Periodiku Islam në Shqipëri gjatë luftës së dytë botërore – Revista “Kultura Islame”, **Msc. Dorian Demetja, Drejtor i Kulturës në KMSH** 07
2. Qasja e dijetarëve klasikë dhe modernë rreth “El-Huruf el-Mukatta’a” Shkronjave të Ndërprera, **Armand Asllani** 12

Shkenca Islame

3. Krijimi i Ademit dhe Havasë sipas Imam Maturidiut, **Dr. Osman Nuri Demir** 38

Histori

4. Arabët para Islamit, **Prof. Dr. Qazim Qazimi** 52

Filozofi

5. Konak me Edisonin, **Nuredin Nazarko** 70

Moral

6. Etika shpirtërore dhe parimet morale të Imam Gazaliut, **Prof. Dr. Hajredin Hoxha** 85

Personalitet

7. Hasan ef. Nahi, **Resul ef. Rexhepi** 92

Recensë

8. Recension për librin: “KONFERENCA E BUJANIT GURTHEMEL I SHTETËSISË SË KOSOVËS (31 Dhjetor 1943 dhe 1 e 2 Janar 1944)” nga autori Alban Dobruna, **Prof. Asoc. Dr. Ilirjana Kaceli** 102

9. Recension për librin “Bardhësitë e atdheut” me autor z. Afrim Mustafa, **Prof. Dr. Mehmet Halimi** 107

Retrospektivë

10. Gruerja ne myslimanizme 112

Abstracts in English 116

Rregullat e shkrimit



Periodiku Islam në Shqipëri gjatë luftës së dytë botërore - Revista “Kultura Islame”

Msc. Dorian Demetja

Abstrakt

Periodikët islam shqiptarë që zunë fill nga shekulli XX, kerabas periudhës së pavarësisë së Shqipërisë, marrin fizionominë e plotë me rastin e themelimit të Komunitetit Mysliman Shqiptar. Fillimi i luftës së dytë botërore solli ndërprerjen e botimit të revistës “Zani i Naltë”, organ i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë. Për disa kohë nuk kemi asnjë periodik islam, gjë që la një boshllëk të madh për edukim islam dhe patriotik njëkohësisht sipas nevojave të kohës. Veprimtarinë e botimit të shtypit periodik, Komuniteti Mysliman i Shqipërisë e vazhdoi me revistën “Kultura Islame”, e cila iu ofrua publikut nga shtatori i vitit 1939 deri në shkurtin e vitit 1946. Revista “Kultura Islame” e filloi botimin e saj si revistë e përmuajshme fetare, filozofike, letrare, morale e shoqërore dhe më pas, si revistë fetare, letrare, ditunore, artistike.

Periodikët islam shqiptarë kishin për qëllim edukimin fetarë të besimtarëve në përputhje me të gjitha normat e fesë islame dhe synonin ta kultivojnë njeriun me moralin e fesë, duke e pajisur atë me virtyte të bukura dhe duke e përgatitur si një besimtar të dobishëm për shoqërinë e atdheun. Shtypi shqiptar islam u mor edhe me çështjen se ç’detyrë dhe obligim kanë intelektualët ndaj popullit dhe

në veçanti ndaj rinisë shqiptare për edukimin e tyre fetar dhe kombëtar.

Në periodikun islam shqiptar të periudhës së luftës së dytë botërore, që më së shumti identifikohet me revistën “Kultura Islame”, një vend të rëndësishëm zënë artikujt fetarë, të cilët flasin dhe ftojnë për besim në një Zot, duke u treguar njerëzve se ky besim siguron unitet dhe vëllazërim të vërtetë. Nëpërmjet mesazhit fetar për besimin në

unitetin e Zotit, bazuar në këtë revistë, arrihej një vëllazërim, një solidarësi shoqërore e kombëtare shumë e fortë dhe e shëndoshë: *“Tu e konstatoe se ekziston vetëm një Zot, pason se të gjithë njerëzit janë një para Zotit, i cili na urdhënon me adhurue vetëm atë, Prej këndeje, një ideal i përbashkët stabilizohet për të gjithë njerëzit për të gjitha këto qenie të krijueme.”*¹

Ky është themeli i parë i fesë islame që e përshkruan revista “Kultura Islame”, pastaj aty flitet që njerëzit ta adhurojnë Zotin, si dhe aftësitë e talentin që na ka dhuruar Ai ta përdorin në të mirë të shoqërisë, mos t’i bëjnë keq askujt, ta duan njëri-tjetrin, të jenë të bashkuar, duke lënë anash përçarjet dhe grindjet ndërmjet veti. Krahas kësaj, nuk mungonin edhe shkrimet e herëpashershme rreth çështjeve kombëtare dhe plagëve të atdheut.

Revista “Kultura Islame”, por dhe i gjithë periodiku islam shqiptar i kësaj periudhe, i kushtuan rëndësi të veçantë çështjes fetare dhe kombëtare. Ky periodik ftonte për një unitet politik të shqiptarëve pa dallim feje e krahine etnografie, duke potencuar sidomos nevojën për unitet dhe tolerancë fetare ndërmjet shqiptarëve. Populli shqiptar ftohet që të mos bie pre e propagandës së

huaj, e cila synonte t’i fusë shqiptarët në vëllavrasje, duke penguar në të njëjtën kohë edhe bashkimin kombëtar.

Njohuritë për fenë dhe kulturën islame që zinin vend në faqet e revistave islame, u ndërthurën në mënyrë të natyrshme nga dijetarët myslimanë patriot, me edukatë për dashurinë ndaj atdheut të përbashkët, Shqipërinë. Dashamirësia për njëri-tjetrin që predikohej në faqet e revistave të kësaj periudhe, mbështetur në moralin islam dhe në rrethanat e Shqipërisë, ishte në të njëjtën kohë edhe mesazh bashkimi mes shqiptarëve për t’i bërë ballë armikut të përbashkët të tyre.

Me interes është të evidentohet se revista “Kultura Islame”, edhe pse në tërësinë e shkrimeve trajton dashurinë që duhet të kenë besimtarët për njëri-tjetrin dhe me popujt e tjerë, ajo bëri objekt temash trajtimi edhe simbolet kombëtare. Ashtu si gjuha dallon një popull nga një tjetër “ashtu edhe flamuri dallon kombet njërin prej tjetrit.” Dhe vazhdon: *“Çdo komb krenohet me flamurin e vet, e do, e admiron dhe e naltëson. Një komb, të cilit i dhunohet flamuri, ka të drejtë me tund qiell e dhe, e deri ku të mundet. Sikurse nuk mund të ketë dritë pa diell, aq mundet me qenë një komb pa gjuhë e flamur.”*²

1. Vexhi Demiraj (Prof.), *Besimi në unitetin e Zotit in siguron njerëzve vllaznim të vërtetë*, revista “Kultura Islame”, nr. 10, qershor 1944, f. 270.

2. Revista “Kultura Islame”, nr. 9-10, maj-qershor 1944, f. 50, 51.

Botimi i revistës “Kultura Islame” ka qenë një kontribut i rëndësishëm i myslimanëve shqiptarë në debatin publik të asokohshëm. Për nga përmbajtja, revista “Kultura Islame”, kishte ndjekur rrugën e revistës “Zani i Naltë”, por me një vizion më të gjerë. Ajo u përpoq të ruajë fizionominë patriotike pararendëse të saj. Gjuha që përdori kjo revistë dhe problemet që shtroi në tryezën e diskutimit, krijuan mjedise tërheqëse për intelektualët myslimanë.

Revista “Kultura Islame” kishte në krye të saj dy përfaqësuesit më të rinj të kulturës islame, që kishin kryer studimet teologjike në universitetin Ezher të Egjiptit dhe në Lahorë të Pakistanit. Këta ishin Sadik Bega, drejtor dhe Sherif Putra, redaktor. “Studimet dhe temat e paraqitura aty kanë pasur cilësi të lartë. Mbizotërojnë ato origjinale ndaj përkthimeve, materiali është më i vëllimshëm. Në faqet e saj ka pasur shumë studime me vlerë shkencore në vartësi të rolit qytetëruar e përparimtar të kulturës islame shqiptare. Revista u drejtua nga Sadik Bega me redaktor Sherif Putrën, të cilët afruan si bashkëpunëtorë penda të njohura të studiuesve islamë shqiptarë të kohës, si dhe të rinj studentë universitarë nga vendet islame e nga Perëndimi, që ndikuan për ngritjen e efikasitetit të saj formues

e edukativ, filozofik e moral të lexuesve shqiptarë.”³

Krahas emrave të vjetër si Hafiz Ali Korça, Dr. Behxhet Shapati, Haki Sharofi etj., në faqet e kësaj reviste filluan të paraqiten edhe emra të rinj me prirje islame dhe të talentuar në fusha të ndryshme si Sadik Bega, Vexhi Buharaja, Sherif Putra, Jup Kastrati, Muhamed Bala, Shefik Osmani etj.⁴ Formohet një komision për të shqyrtuar artikujt që do të botohen në revistën “Kultura Islame”. Kryetari i komisionit është Sulejman Kadiu, anëtarë: Haki Sharofi, Vexhi Demiraj, me pjesëmarrjen edhe të Sadik Begës dhe të Sherif Putrës.⁵

Revista “Kultura Islame” luante rol të rëndësishëm për formimin e shpresës te besimtarët, duke sjellë herë pas here shkrime me karakter psikologjik, rreth forcimit të individit dhe shoqërisë, duke forcuar së pari besimin dhe mbështetjen te Zoti i Lartësuar. Përkthimet dhe studimet kanë sjellë në shqip frytet më bashkëkohore të mendimit filozofik të kohës, duke e njohur lexuesin shqiptar me prurjet e reja në këto fusha.

3. Faik Luli – Islam Dizdari, *75-vjetori i botimit të revistës “Zani i Naltë”*, gazeta “Drita Islame”, nr. 23 (154), viti i VII i botimit, dhjetor 1998.

4. Ramiz Zekaj (Dr.), *Zhvillimi i kulturës islame te shqiptarët gjatë shekullit XX*, Tiranë 1997, f. 173.

5. AQSH, fondi 482, viti 1942, dosja 5.

Megjithatë, kjo revistë nuk pati vetëm qasje ndaj opinionit publik, ajo ndihmoi jashtëzakonisht për ide, mendime e koncepte të nevojshme mbi problemet e kohës, duke dhënë një kontribut të vyer në zhvillimin dhe emancipimin e shoqërisë shqiptare. Përveç trajtimit të problematikave të kohës, revista “Kultura Islame” ka ofruar një material të pasur me njohuri e me studime në fushën e mendimit, kulturës dhe shkencës.

Gjatë periudhës që u botua, në këtë revistë spikat qëndrimi që ky organ mbajti në fillimet e veta ndaj pushtimit italian, ku mendimet ishin pro qeverisë fashiste të asokohshme, sigurisht duke dhënë arsyetimet dhe pikëpamjet e këtij qëndrimi, ku në bazë të shkrimeve, vërejmë se mbështetej fakti se qeveria fashiste nuk përzihej në punët e brendshme të fesë dhe se gëzohej me plot të drejta liria e ushtrimit të besimit dhe të aktivitetit fetar, gjë që, sipas këndvështrimit të dhënë këtu, kishte pasur problematika në qeverinë e mëparshme, ku thuhet se indirekt i qenë mohuar këtij populli ushtrimet e traditat fetare si anulim i të drejtave fetare, dhe se qeveria merrte masa antifetare që në të shumtën e rasteve dëmtonin më tepër elementin mysliman.⁶

6. Shiko Behxhet Shapati (Dr.) Kryetar i Komunitetit Mysliman, *Gjendja e djeshme dhe e sotshme e elementit shqiptar mysliman në Shqipëri*, revista “Kultura Islame”, nr. 6-7, viti i I i botimit, Mars 1940, f. 1-2.

Revista “Kultura Islame”, në faqet e veta shkroi edhe për personalitete, që nuk u pajtuan me pushtimin e huaj fashist, duke u bërë shprehje e qëndrimit të popullit shqiptar. I tillë ishte Fuad Dibra që gjatë katër viteve zotërimi italian, qe shprehje e gjallë e shpirtit të kombit shqiptar. Mohimi i bashkëpunimit të tij me pushtuesin ishte nga çdo pikëpamje mohim i krejt popullit shqiptar. Ky shkrim vlerësonte lartë idealin e tij të vetëm: “Për t’i bashkuar shqiptarët rreth një programi të aftë për me i siguruar shpëtimin tonë të përjetshëm për realizmin e Shqipërisë etnike.”⁷

Në pjesët e revistës “Kultura Islame”, u trajtuan edhe tema dhe probleme me karakter teorik e studimor si “Përhapja e Islamizmit” që u botua në disa numra, pastaj “Hyrje në filozofinë Islame”, i cili po ashtu vazhdoi në disa numra. Në aspektin moral, teologjik e filozofik u shtruan tema si “Problemi i së mirës dhe i së keqes”, kategori filozofike-morale këto, që kanë qenë objekt diskutimi për shumë doktrina. Shtjellimi u bë mbi bazën e tezave të “Masës së ligjit të evolucionit”, “Moralit dhe epsheve në masë”, “Para vendimit ose fatit”. Po ashtu, në këtë revistë u botuan edhe studime nga fusha e arteve dhe e historisë, siç ishin: “Kuptimi i artit dhe kufijtë e tij”, “Historia e bibliotekave” etj.⁸

7. Revista “Kultura Islame”, nr. 1, shtator 1943, f. 208-210.

8. Fahrush Rexhepi (Dr.), *Periodiku shqiptar islam, gjysma e parë e shekullit XX*, Prishtinë

Revista “Kultura Islame” si dhe revistat e tjera islame që u botuan në Shqipëri gjatë luftës së dytë botërore, me shkrimet e veta ndikuan jo vetëm në formimin e edukimin e besimtarëve, por kontribuuan në mbajtjen gjallë të frymës së luftës për çlirimin kombëtar, duke iu përgjigjur fuqimisht mendimit të rilindësve tanë se besimtarët që u drejtoheshin, ishin në radhë të parë shqiptarë dhe për Shqipërinë duhej të jepnin gjithçka, përfshi dhe jetën.

Nëse do të flitnim për çështjen kombëtare, të pasqyruar në revistë, nuk do të ishte e mjaftueshme, po të mos trajtohej roli që kanë luajtur fetë në këtë çështje, si për formimin e ndërgjegjes kombëtare, ashtu dhe për edukimin e saj. Është kjo njëra nga arsyet që shpesh përdoret togfjalëshi “pa fe nuk ka atdhe.” Prandaj ndër format më të larmishme që ndesheshin në shkrimet e këtyre revistave për çështjen kombëtare,

2013, f. 162.

ishin shkrimet me karakter historik. Evokimi i historisë së lavdishme të popullit tonë, bëhej që në zanafillën e lindjes së idesë kombëtare, duke përmendur momentet më të mprehta të historisë, ku varej e ardhmja e shqiptarëve.⁹

Revista “Kultura Islame” ndaloi së botuari në mars të vitit 1946, si rrjedhim i politikës ateiste të regjimit. Kjo revistë, i shërben kohës së sotme me pasuritë e saj, për të kuptuar se myslimanët duhet të forcojnë urat mes së shkuarës dhe së ardhmes për të qartësuar identitetin e tyre. Në vitin 2012 botohet për herë të parë kolana e revistës “Kultura Islame” e shtrirë në 3 vëllime, e cila vjen si botim i shoqatës Alternativa e së Ardhmes, ALSAR. Kjo kolanë me rreth 2000 faqe, përmbledh 73 numra të revistës “Kultura Islame” të botuara nga viti 1939 deri më 1946.

9. Ali M. Basha, *Rrugëtimi i fesë Islame në Shqipëri (1912-1967)*, Tiranë 2011, f. 420.

Qasja e dijetarëve klasikë dhe modernë rreth “El-Huruf el-Mukatta’a” Shkronjave të Ndërprera

Armand Asllani

Abstrakt

Ky punim trajton një nga temat më komplekse dhe të diskutueshme në studimet e Kur’anit: “El-Huruf el-Mukatta’a” (shkronjat e ndërprera) që shfaqen në fillim të 29 sureve të Kur’anit Famëlartë. Këto shkronja të veçanta, të cilat lexohen veçmas dhe jo si fjalë të përbëra, kanë ngjallur debate të thella dhe interpretime të ndryshme që nga fillimi i studimeve islame. Dijetarët kanë ndarë mendimet e tyre në dy grupe kryesore: disa mendojnë se kuptimin e këtyre shkronjave e di vetëm Allahu, ndërsa të tjerët argumentojnë se ato kanë kuptime të caktuara dhe mund të interpretohen.

Në punim shqyrtohen mendimet e dijetarëve klasikë dhe modernë, duke përfshirë qasjet që i trajtojnë këto shkronja si simbole të mrekullisë hyjnore, argument për paarritshmërinë e Kur’anit, shenja të profetësisë së Mubamedit (a.s.), apo si kode sekrete që mbartin kuptime të thella. Diskutimi përfshin gjithashtu analiza mbi përdorimin e shkronjave si elemente për të tërhequr vëmendjen, si betime hyjnore, apo si një mjet për mësimin dhe njohjen e shkronjave arabe.

Punimi përpiqet të hedhë dritë mbi kompleksitetin dhe diversitetin e mendimeve për këto shkronja, duke u bazuar në burime të ndryshme të tefsirit (komentimit të Kuranit) dhe literaturës bashkëkohore islame. Në përfundim, theksobet se megjithëse këto shkronja mbartin një kuptim të thellë dhe hyjnor, interpretimi përfundimtar i tyre mbetet i fshehtë, duke u lënë hapësirë hulumtimeve të mëtejshme për të zbuluar misterin që ato përfaqësojnë.

Fjalët kyçe: “El-Huruf el-Mukatta’a”, Kur’an, dijetarë klasikë, dijetarë modern, mrekullia e Kur’anit.

Kur’ani Fisnik është libri i fundit që krijuesi i gjithësisë, Allahu (xh.sh) ka dërguar si udhërrëfyes për njerëzimin deri në ditën e kiametit. Që në fillimet e zbritjes së Kur’anit, njerëzit kanë treguar një interes të gjerë rreth tij. Njerëzit e mendjes janë përpjekur me kujdes që t’i kuptojnë mirë mësimet e Kur’anit dhe tua përcjellin ato të tjerëve. Në çdo periudhë, dijetarët e tefsirit (komentimit të Kur’anit) janë përpjekur t’i komentojnë versetet e Kur’anit sipas kohës dhe kushteve të tyre.

Një nga temat që ka qenë objekt i hulumtimeve të gjera, i diskutimeve akademike në literaturën islame, dhe që ka tërhequr edhe vëmendjen e studiuesve perëndimorë apo orientalistëve, janë “El-Huruf el-Mukatta’a” shkronjat e ndërprera.

Në këtë punim shtjellohet kuptimi i “El-Huruf el-Mukatta’a” (shkronjave të ndërprera) si dhe qasja e dijetarëve klasikë dhe atyre modern rreth këtyre shkronjave. “El-Huruf el-Mukatta’a” që në arabisht shkruhen si الحروف المقطعة fjalë për fjalë ka kuptimin i shkurtuar ose i ndërprerë. Ato janë kombinime unike të shkronjave arabe me të cilat fillojnë 29 kapituj të Kur’anit Fisnik. “El-Huruf el-Mukatta’a” njihen gjithashtu edhe si hapëse, pasi ato formojnë versetin hapës të kapitujve përkatës në Kur’anin Fisnik.

Këto shkronja shkruhen së bashku si një fjalë e vetme në gjuhën arabe, por çdo shkronjë shqiptohet veçmas. Diskutimi i dijetarëve rreth kuptimit të shkronjave të ndërprera është zhvilluar në dy boshte kryesore. Njëri grup, ku më së shumti bëjnë pjesë dijetarët klasik, mendon që kuptimin e tyre e di vetëm Allahu (xh.sh). Ndërsa grupi tjetër mendon që kuptimi i tyre është i njohur dhe kanë përmendur mbi njëzet kuptime të ndryshme të këtyre shkronjave.

“El-Huruf el-Mukatta’a” është një temë e rëndësishme në kuptimin e plotë dhe të qartë të mesazhit hyjnor. Pavarësisht rëndësisë së temës, punimet e plota dhe të gjera rreth “El-Huruf el-Mukatta’a” shkronjave të ndërprera janë të pakta në gjuhën shqipe. Qëllimi i këtij punimi modest është që të hedhë një dritë sado të vogël në kuptimin e “El-Huruf el-Mukatta’a”.

Ky punim është përfutur nga burimet më të spikatura origjinale të tefsirit (komentimit të Kur’anit), qofshin ato të shkruara nga dijetarët klasikë apo modernë. Tek dijetarët klasikë bëjnë pjesë të gjithë interpretuesit e Kur’anit fisnik që nga koha e zbritjes së tij deri në shek.. XIX. Ndryshimet dhe zhvillimet e shumta që ndodhën në shek. XIX në botën islame, patën ndikim edhe në qasjen e dijetarëve ndaj interpretimit të Kur’anit fisnik. Të ndikuar nga mendimet e Xhemaludin Afganit, Muhamed Abduh dhe Reshit Riza

u bënë iniciatorët e një fryme të re në kuptimin dhe interpretimin e Kur'anit. Të gjithë interpretuesit e Kur'anit që prej kësaj periudhe e deri në ditët e sotme njihen si dijetarët modern apo bashkëkohor në fushën e tefsirit (komentimit të Kur'anit).

Gjithashtu, më këtë punim janë marrë si referencë edhe mendimet e studiuesve të gjuhës arabe, të cilët kanë dhënë një kontribut të gjerë në kuptimin e drejtë të mesazhit hyjnor.

Punimi përbëhet nga dy kapituj kryesorë. Në kapitullin e parë është bërë përkufizimi i “El-Huruf el-Mukatta’a” dhe është dhënë një statistikë në lidhje me këto shkronja. Në kapitullin e dytë janë shtjelluar qasjet e dijetarëve klasikë dhe atyre modern në lidhje me “El-Huruf el-Mukatta’a”.

Termi “El-Huruf El-Mukatta’a”

1.1 Përkufizimi i “El-Huruf El-Mukatta’a”

1.1.1 Kuptimi leksikor:

“El-Huruf El-Mukatta’a” është togfjalësh i përbërë nga dy fjalë. Fjala e parë, “huruf” është shumësi i fjalës “harf”. “Harf” në gjuhën arabe ka kuptimin e cepit, anës së diçkaje. Me këtë emër janë quajtur shkronjat e alfabetit, shumësi i të cilave është “ehrruf” dhe “hurruf”.¹

1. Ibni Mendhur, *Lisenu'l-Arab*, Bejrut: Sadir 1994, lënda (harf), 9, 41-42.

Maja e diçkaje, kufiri i saj.² Zërat të cilat kanë kuptim, por që nuk janë emra, folje dhe as fjalë.³

“El-Mukatta’a” rrjedh nga “kata” që ka kuptimin e ndarjes së pjesëve nga njëra-tjetra dhe nga pjesa origjinale.⁴ “El’kat’u”, “Mikata” pres, shkëput, ndaj nga njëra-tjetra.⁵ Shkronjat që nuk lexohen ashtu siç lexohen kur formojnë fjalën, por lexohen siç janë në formën origjinale, quhen “El-Huruf El-Mukatta’a” (shkronjat e ndërprera).⁶

1.1.2 Kuptimi terminologjik

Dijetarët e kanë përkufizuar si: “Ato janë shkronja nga shkronjat e alfabetit arab me të cilat Allahut ka filluar disa nga suret e Kur'anit Fisnik. Mund të jetë një shkronjë ose më shumë. Çdo shkronjë lexohet e veçuar.”⁷ Emri i përbashkët i shkronjave që gjenden në fillim të njëzet e nëntë sureve (kapitujve) të Kur'anit fisnik dhe që lexohen me emrat e tyre.⁸

2. Fejrur Ebedi, *el-Kamusu'l-Mubit*, Bejrut: el-Muesesetu'l-Arabije 2008, 3, 130-131.

3. Po aty.

4. Ibni Mendhur, *Lisenu'l-Arab*, 9, 41-42.

5. Po aty, lënda (kata), 8, 276-278.

6. Zeki Duman, Mustafa Altundag, *El-Huruf Mukata'*, DIA, 18, Stamboll: Botim i Fondacionit të Dijanetit Turk, 1998, f. 401-408.

7. Zerkeshi, *el-Burban fi Ulumi'l-Kur'an*, Bejrut: Darul Marife 1972, 1, 167. Shiko Sharau, *Tefsir Sharau*, 1, 103. Shiko Abdul Xheber, *Muxbeç Tefsir el-Kur'ani'l-Kerim*, vëllimi i dytë, Bagdad: Daru Thekafetu Islamiye viti nuk përmendet, 1, 16.

8. Duman, *El-Huruf Mukattaa'*, DIA, 18, f. 401-408.

1.2 “El-Huruf El-Mukatta’a” në Kur’an

1.2.1 Vendi dhe forma e tyre në Kur’an

Qëllimi i këtij kapitulli është që të paraqesë një statistikë të përmbledhur rreth “El-Huruf el-Mukatta’a” dhe në cilat sure (kapituj) të Kur’anit gjenden këto shkronja me të cilat fillojnë këto sure.

Kur’ani Fisnik përbëhet nga 114 sure (kapituj), nga të cilat 29 prej tyre fillojnë me “El-Huruf el-Mukatta’a”.

P.sh: (الم)، (الر)، (كهيعص)، “Elif lam mim, elif lam rra, kef he je ajn sad”.

Këto shkronja që përmenden në fillim të sureve janë 78 shkronja, ndërsa pa përsëritje janë 14 shkronja të tilla.⁹

Për lehtësim të punimit dhe për të qenë sa më të qartë, po paraqesim një tabelë me emrat e sureve ku përmenden këto shkronja si dhe shkronjat:

9. Zerkeshi, *el-Burrhan fi Ulumi’l-Kur’an*, 1, 167.

Nr.	Nr. i sures (kapitullit) në Kur’anin Fisnik	Emri i sures (kapitullit)	El-Huruf El-Mukatta’a
1	2	Bekare	الم (elif lam mim)
2	3	Ali Imran	الم (elif lam mim)
3	7	Araf	المص (elif lam mim sad)
4	10	Junus	الر (elif lam rra)
5	11	Hud	الر (elif lam rra)
6	12	Jusuf	الر (elif lam rra)
7	13	Rad	المر (elif lam mim rra)
8	14	Ibrahim	الر (elif lam rra)
9	15	Hixhr	الر (elif lam rra)
10	19	Merjem	كهيعص (kef he je ajn sad)
11	20	Taha	طه (ta ha)
12	26	Shuara	طسم (ta sin mim)
13	27	Neml	طس (ta sin)
14	28	Kasas	طسم (ta sin mim)
15	29	Ankebut	الم (elif lam mim)
16	30	Rum	الم (elif lam mim)
17	31	Lukman	الم (elif lam mim)
18	32	Sexhde	الم (elif lam mim)
19	36	Jasin	يس (je sin)
20	38	Sad	ص (sad)
21	40	Gafir	حم (ha mim)

22	41	Fusilet	حم (ha mim)
23	42	Shura	حم عسق (ha mim ajn sin kaf)
24	43	Zuhruf	حم (ha mim)
25	44	Duhan	حم (ha mim)
26	45	Xhathije	حم (ha mim)
27	46	Ahkaf	حم (ha mim)
28	50	Kaf	ق (kaf)
29	68	Kalem	ن (nun)

1.2.1.1 *Këto shkronja nuk kanë ardhur në numër të njëjtë në çdo sure.*

Në disa raste ka ardhur vetëm një shkronjë, në disa të tjera dy shkronja, tre shkronja, katër shkronja apo edhe pesë shkronja.

Me një shkronjë gjenden në 3 sure: ”ص Sad” në suren Sad, ”ق Kaf” në suren Kaf dhe ”ن Nun” në suren Kalem.

Me dy shkronja gjenden në 9 sure: 6 herë ka ardhur ”حم Ha Mim”, në suret Gafir, Fusilet, Zuhruf, Duhan, Xhathije dhe Ahkaf. ”يس Je Sin” dhe ”طه Ta He” në suret me të njëjtat emra si shkronjat. Si dhe ”طس Ta Sin” në suren Neml.

Me tre shkronja gjenden në 13 sure. 6 herë ka ardhur ”الم Elif Lam Mim”, në suret Bekare, Ali Imran, Ankebut, Rum, Lukman dhe Sexhde. 5 herë ka ardhur ”الر Elif Lam Rra”, në suret Junus, Hud, Jusuf, Ibrahim dhe Hixhr. Dhe dy herë ”طسم Ta Sin Mim”, në suret Shuara dhe Kasas.

Me katër shkronja gjenden në 2 sure.” المصص Elif Lam Mim

Sad” në suren Araf dhe ” المر Elif Lam Mim Rra” në suren Rad.

Me pesë shkronja gjenden në 2 sure. ”كهيعص Kef He Je Ajn Sad” në suren Merjem dhe ”حم عسق Ha Mim Ajn Sin Kaf” në suren Shura.¹⁰

Nga këto shkronja më së shumti janë përdoruar shkronjat ”elif lam mim”. Nëse elifin e cilësojmë si një shkronjë, ajo është përsëritur në mënyrë të barabartë me shkronjat e alfabetit 29 herë. 29 nga këto sure që fillojnë me ”El-Huruf el-Mukatta’a”, 2 prej tyre kanë zbritur në periudhën medinase, ndërsa të tjerat kanë zbritur në periudhën mekase. Këto sure mund t’i radhisim në këtë formë sipas radhës së zbritjes: Kalem, Kaf, Sad, Araf, Jasin, Merjem, Tahe, Shuara, Neml, Kasas, Junus, Hud, Jusuf, Hixhr, Lukman, Gafir, Fusilet, Shura, Zuhruf, Duhan, Xhathije, Ahkaf, Ibrahim, Sexhde, Rum, Ankebut, Bekare, Ali Imran dhe Rad. Kjo është sipas radhës së njohur. Në të gjitha suret veç sureve Merjem, Ankebut, Rum

10. El-Bejdai, *Enueru Tenzil ue Esrarru Te’uil*, Bejrut: Darul Ihja 1997, 1, 35.

dhe Kalem, menjëherë pas “El-Huruf el-Mukatta’a” vijnë ajete që flasin rreth Kur’anit apo rreth librit, që ka kuptimin e Kur’anit. Pas këtyre ajeteve, flitet rreth fillimit të jetës, universit, krijimit, kiametit dhe rreth temave të tilla thelbësore.¹¹

Allahu (xh.sh) duket sikur shkronjat në alfabetin arab i ka ndarë në tre grupe:

Pjesa e parë nga Elifi tek Dhel (أ، ب، ت، ث، ج، ح، د، هـ، و، ز، ح، ط، ي) është me 9 shkronja. Allahu i Lartë nga ky grup shkronjash ka zgjedhur vetëm dy shkronja Elif dhe Ha, shtatë të tjerat i ka lënë.

Pjesa e dytë përbëhet nga 9 shkronjat e fundit të alfabetit, nga Fe deri tek Je (ك، ل، م، ن، هـ، و، ز، ح، ط، ي) (ق، ف). Nga grupi i dytë ka lënë pa përmendur vetëm shkronjën Fe dhe Uau, ndërsa 7 të tjerat i ka përmendur.

Ndërsa grupi i tretë përfshin shkronjat midis grupit të parë dhe të dytë, pra nga Rra deri tek Gajn (ع، غ، ف، ق، ط، ص، ش، س، ز، ر، هـ، و، ز، ح، ط، ي) që janë 10 shkronja. Nga këto 10 shkronjat e këtij grupi, një shkronjë e ka përmendur një e kalënë.¹² Kjo radhitje shkronjave tregon që shkronjat e ndërprera nuk kanë ardhur rastësisht siç pretendojnë orientalistët. Por, ato tregojnë mrekullinë e paarritshme të

Kur’anit. Kjo zgjedhje dhe renditje e shkronjave nuk është rastësi, por është zgjedhje dhe renditje sipas një qëllimi të caktuar.¹³

1.2.2 Diskutime të ndryshme

1.2.2.1 *A janë këto shkronja të ndërprera emra apo shkronja?*

Ajo që transmetohet nga Profeti Muhamed (sal’allahu alejhi eue sel’lem), është sqaruar në përgjigjen që i jep Sheukeni pyetjes: “A ka diçka të saktë nga Profeti (a.s.) rreth ‘El-Huruf maukata’at?” Sheukeni përgjigjet: “Nuk di që Profeti (a.s.) të ketë folur diçka rreth kuptimit të tyre. Ajo që është transmetuar nga Ai (a.s.) është vetëm numri i tyre. Transmeton Ibn Mes’udi që Profeti (a.s.) të ketë thënë: “Kush lexon një shkronjë nga libri i Allahut ka një sevap, dhe sevapi shpërblehet me dhjetë fish. Nuk po them që elif lam mim është një shkronjë, por elifi një shkronjë, lami një shkronjë dhe mimi një shkronjë”¹⁴.¹⁵

Edhe pse gjendet transmetimi i qartë i profetit Muhamed (s.a.s) që këto shkronja të ndërprera janë shkronja, shohim që dijetarët myslimanë kanë dy qasje të ndryshme në lidhje me qenien e këtyre shkronjave të ndërprera thjesht shkronja apo emra:

13. Davud Ayduz, *Huruf-i Mukattaa*, revista “Yeni Umit”, Stamboll, nr. 76, 2006.

14. Tirmidhi, Sunen, *Theuebu’l-Kur’an*, Bejrut: Darul Fikr 1983, 1, 25.

15. Sheukeni, *Fetbu’l-Kadir*, Bejrut: Darul Fikr 1993, 1, 50-51.

11. Zerkeshi, *el-Burrhan fi Ulumi’l-Kur’an*, 1, 168.

12. Razi, *Mefetihu’l-Gajb*, Bejrut: Darul Ihja 1999, 26, 250; Sheukeni, *Fet’hul-Kadir*, 1, 35.

E para: Dijetarët e rëndësishëm të tefsirit (komentimit të Kur'anit) si Zemahsheri¹⁶, Bejdau¹⁷, Alusi¹⁸ dhe gjuhëtarët si Khalili¹⁹ dhe Sibeuejhi²⁰ mendojnë se këto shkronja të ndërprera janë emra. Janë quajtur emra, sepse emrat tregojnë kuptim për veten e tyre, ndërsa shkronja tregon kuptim për të tjerët.²¹ Po ashtu, edhe mënyra e shqiptimit të tyre tregon që janë emra dhe jo thjesht shkronja.²²

E dyta: Qasja që këto shkronja të ndërprera janë shkronja dhe jo emra.

Dijetarët e tefsirit (komentimit të Kur'anit) të cilët kanë jetuar para Zemahsherit kanë pasur këtë mendim. Vetë Zemahsheriu e përmend që ky mendim është shprehur prej tyre.²³

Këto shkronja janë shkruar në Kur'anin Fisnik në formën e

shkronjave që përdoren në të folur, dhe jo në formën që ato lexohen. Shkaku sipas Ashur është: “Sepse qëllimi janë shkronjat e alfabetit. Dhe shkronjat e alfabetit shkruhen me formën e tyre, dhe jo me emrat e tyre”²⁴.

1.2.2.2 *A janë këto shkronja pjesë e Kur'anit Fisnik?*

Mendimi që kanë hedhur përgjatë historisë armiqtë e Islamit dhe në kohët moderne orientalistët që shkronjat e ndërprera nuk janë pjesë e Kur'anit, fatkeqësisht kanë gjetur mbështetës edhe në botën Islame.²⁵ Në fakt për gjatë gjithë historisë Islame, në asnjë periudhë nuk ka ekzistuar ndonjë version Kur'ani ku të mos jenë shkruar “El-Huruf mukuta’at” (shkronjat e ndërprera) në të. Përkundrazi disa sure e kanë marrë emrin nga këto shkronja.²⁶ Për më tepër, nga të parët tanë nuk ka ardhur as shenja më e vogël që të tregojë që këto shkronja nuk janë pjesë e Kur'anit. Në të kundërt, përveç hadithit që përmendëm më sipër nga Profeti (s.a.s) transmetohet që Ai ka lexuar edhe në namaz në formën “Elif Lam Mim”. Për më tepër, ekzistenca e këtyre shkronjave në librin e Kur'anit, është argument i qartë që ato nuk mund të mohohen që janë

16. Zemahsheri, *el-Keshef an Hakaiku Tenzil ue Ujunnul-Ekail fi Vuxhubi Te'uil*, 1, 19.

17. Bejdau, *En'uerru Tenzil ue Esrrarru Te'uil*, 1, 35.

18. Alusi, *Rubu'l-Meani fi Tefsirru'l Kur'ani'l-Adhim ue Seba' Metheni*, Bejrut: Daru Ihja 1985, 1, 98.

19. Ahmed b. Abdurrahmen, *Enbehu Ru'uat ale Enbehu Nuhut*, Kairo: Daru Fikri Arabij 1986, 1, 376.

20. Sibeuejhi, *el-Kiteb*, Bejrut: Daru'l-Xhelil, 3, 320.

21. Zemahsheri, *El-Keshef an Hakaiku Tenzil ue Ujunul Ekail fi Vuxhuhi Te'uil*, 1, 79.

22. Sibeuejhi, *El-Kiteb*, 3, 320.

23. Zemahsheri, *el-Keshef an Hakaiku Tenzil ue Ujunnul-Ekail fi Vuxhubi Te'uil*, 1, 78.

24. Ibn Ashur, *E'tebriru ue Tenuiru*, 1, 206.

25. Duman, *Huruf-i Mukattaa'*, DIA, 18, f. 405.

26. Ali Nasuh Tahir, *Eucilu Su'uer fi'l-Kur'ani'l-Kerim*, Kairo 1986, f. 50-51.

pjesë e Kur'anit.²⁷ Për këtë arsye, ky lloj mendimi që “El-Huruf el-Mukatta’a nuk janë pjesë e Kur’anit, nuk është aspak i saktë.

1.2.2.3 A janë këto shkronja të ndërprera ajete Kur’anore?

Mund të themi se dijetarët kanë dy qasje kryesore në këtë çështje. Gjuhëtarët nga Basra nuk i shohin “El-Huruf el-Mukatta’a” si ajet të veçantë, por i cilësojnë si pjesë e ajetit pasardhës. Shumë prej komentuesve të Kur’anit e transmetojnë këtë mendim në librat e tyre. Ndërsa gjuhëtarët nga Kufe mendojnë se disa nga shkronjat e ndërprera janë ajet i veçantë dhe disa të tjera janë pjesë e ajetit pasardhës. Në këtë pikë nuk mund të bëhet analogji për të gjitha rastet e shkronjave të ndërprera, sepse ajetet janë caktuar me shpallje hyjnore.²⁸ Një prej dijetarëve të parë, i cili ka trajtuar këtë temë është edhe Tusi, i cili thotë se përpjekja e dijetarëve për tu dhënë kuptim shkronjave të ndërprera, tregon në mënyrë të tërthortë që ata e pranojnë idenë që këto shkronja janë ajete të veçanta.²⁹

Sipas gjuhëtarëve nga Kufe, rastet e shkronjave të ndërprera janë si më poshtë: Në 6 rastet ku kalon “Elif lam mim” cilësohet ajet, “Elif

lam mim sad” është ajet, “Ta sin mim” në dy rastet që kalon cilësohet ajet, “Ha mim” në gjashtë rastet që kalon cilësohet ajet, “Ha mim ajn sin kaf” cilësohen si dy ajete të veçanta, “Ta he” një ajet dhe “Je sin” një ajet. Ndërsa, rastet kur kalon “Elif lam rra” nuk cilësohen ajete, as “Nun” “Kaf” dhe “Sad” nuk cilësohen ajete të veçanta.³⁰ Komentuesit e rëndësishëm të Kur’anit si Zemahsheri dhe Bejdau, mendojnë se kjo nuk është çështje që mund të bësh analogji por është e përcaktuar me shpallje hyjnore.³¹

Qasja e Dijetarëve Rreth “El-Huruf el-Mukatta’a”

Çështja e shkronjave të ndërprera ka tërhequr interesin e dijetarëve të hershëm e të sotëm. Janë të shumta mendimet dhe idetë e hedhura në këtë fushë. Këtë temë e kanë trajtuar me detaje dijetarë të ndryshëm të tefsirit. Disa prej tyre janë mjaftuar duke thënë “Allahu e di më së miri”, ndërsa disa të tjerë i kanë komentuar kuptimet e këtyre shkronjave, duke qenë të sigurt që ai është kuptimi i tyre.³² Në lidhje me temën nuk kemi

30. Bejdau, *En’ueru Tenzil ue Esrraru Te’uil*, 1, 35; Zerkeshi, *el-Burrhan fi Ulumi’l-Kur’an*, 1, 167; Xhelaludin Sujuti, *el-Itkan fi Ulumi’l Kur’an*, Bejrut: Daru’l-Kutub viti 1988, 3, 25.

31. Zemahsheri, *el-Keshef an Hakaiku Tenzil ue Ujumu’l-Ekavil fi Vuxhubi Te’uil*, 1, 25; Bejdau, *En’ueru Tenzil ue Esrraru Te’uil*, 1, 10.

32. Sheukeni, *Fethu’l-Kadir*, 1, 48-49.

27. Ali Nasuh Tahir, *Eucilu Su’uer fi’l-Kur’ani’l-Kerim*, f. 50-51.

28. Zerkeshi, *el-Burrhan fi Ulumi’l-Kur’an*, 1, 170-171.

29. Ebu Xhaferr et-Tusi, *et-Tibjenu el-Xhami’ li Ulumi’l Kur’an*, Bejrut: Daru Fikr, 1, 47-51.

ndonjë hadith të transmetuar nga Profeti Muhamed (a.s.) dhe as ndonjë argument ku shokët e Tij (sahabët) t'i kenë kërkuar ndonjë sqarim Profetit (a.s.) në lidhje me shkronjat e ndërprera. Por, pavarësisht kësaj, të gjithë shokët e Profetit (a.s.) i kanë cilësuar "El-Huruf el-Mukatta'a" si pjesë të pandashme të Kur'anit dhe mbi këto baza kanë ndërtuar edhe leximet e tyre.

Mendimet kryesore rreth "El-Huruf el-Mukatta'a" mund të klasifikohen në forma të ndryshme. Çdo komentues Kur'ani ka përdorur formën dhe metodën e tij të klasifikimit të shkronjave të ndërprera. Në këtë punim, komentet dhe mendimet që janë të përafërt me njëri-tjetrin, i kam klasifikuar nën të njëjtin titull.

Qasjet dhe komentet e dijetarëve rreth shkronjave të ndërprera mund t'i ndajmë nën dy tituj kryesorë:

I pari: Kuptimi i këtyre shkronjave është "muteshabih" (jo krejtësisht i qartë), i fshehtë dhe e di vetëm Allahu.

I dyti: Shkronjat e ndërprera tregojnë kuptim. Zerrkeshi thotë që dijetarët kanë përmendur më shumë se njëzet kuptime të ndryshme rreth këtyre shkronjave.³³

2.1. Cilësimi i këtyre shkronjave si "muteshabih" (me kuptim jo të qartë)

Shumë dijetarë klasikë janë

33. Zerkeshi, *el-Burrhan fi Ulumi'l-Kur'an*, 1, 173.

të mendimit që "El-Huruf el-Mukatta'a" janë nga "muteshabih", kuptimin e tyre e di vetëm Allahu i Lartë. Ato janë sekretet e Allahut në librin e Tij, Kur'anin fisnik. Nuk lejohet që të flasim rreth kuptimit të tyre, por i besojmë ato dhe i lexojmë ashtu siç kanë ardhur tek ne.

Thonë që ato janë sekretet midis Allahut dhe të dërguarit të Tij (a.s.).

Prej dijetarëve që janë të këtij mendimi mund të përmendim: Sheabij³⁴ dhe Sufjan E'theurrij³⁵. Nga komentuesit e Kur'anit mund të përmendim: Ebu Hajen³⁶, Alusi³⁷ dhe Zekerija Ensarij³⁸. Kjo qasje përcillet edhe prej katër kalifëve të drejtë, Ebu Bekrit, Omerit, Osmanit, Aliut dhe Ibn Mes'udit (r.a.).³⁹

Prej atyre që kanë ndjekur këtë rrugë është edhe Sheukeni.

34. Kurtubi, *el-Xhemiu Li'ahkemi'l-Kur'an*, 1, 154. Sheabij është Amir b. Sherrahil el-Hemdenij nga Kufe, nga populli Hemden. Lindi në kohën e Kalifatit të Omerit (r.a). Ka qenë imam, hafiz dhe jurist. Ka transmetuar nga Ebu Hurejra, nga Ibni Abasi, nga Aishja, nga Abdullah b. Omer dhe të tjerë. Shih Dhehebi, 1, 63.

35. Ibn Kethirri, *Tefsiru'l-Kur'an*, 1, 36. Sufjani është Ebu Abdullah Sufjan b. Said nga Kufe. Ishte imam në shkencën e hadithit dhe të tjera. Ka lindur në vitin 97 hixhri dhe ka vdekur në vitin 161 hixhri. Shih Ibn Halken, *Ufejejt E'ajen ue Enbeu Ebneu Zemen*, 2, 386-389.

36. Ebu Hajen, Muhamed b. Jusuf, *el-Bahrul Mubit fi Tefsir*, 1, 60.

37. Alusi, *Ruhu'l-Meani*, 1, 100.

38. El-Ensarij, Ebu Jahja Zekerija, *Fet'hu Rrahman Bikeshfi me Jeltebisu fi'l Kur'an*, fq 19.

39. Ibn Kethir, *Tefsiru'l-Kur'an*, 1, 35.

Ai është prej fanatikëve të këtij mendimi dhe ka folur ashpër për ata të cilët i komentojnë këto shkronja: “Kush flet për kuptimin e këtyre shkronjave në mënyrë kategorike që kjo është ajo që ka dashur të thotë Allahu, ka bërë gabimin më të rëndë. Transmetohet qartë që ne e kemi të ndaluar të hulumtojmë kuptimin e “muteshabih” apo të përpiqemi ta kuptojmë atë, edhe pse ato janë shkronja arabe dhe në formë të kuptueshme. Allahu thotë që ata që në zemrat e tyre kanë anim kah e shtrembërta, ata gjurmojnë atë që nuk është e qartë (muteshabih)⁴⁰”⁴¹

Urtësia e fshehjes së kuptimit të këtyre shkronjave

Ky grup dijetarësh mendon që urtësia e fshehjes së kuptimit të tyre është sprovë nga Allahu për robërit e Tij. Thotë Zerkeni: “Thonë me këtë mendim që kuptimi i tyre është nga të fshehtat që i di vetëm Allahu dhe askush nga krijesat e Tij. Dhe kjo fsheh një urtësi prej urtësive të Tij të larta. Kjo urtësi është prova nga Allahu për robërit e Tij, që të veçoj të mirin nga i keqi, atë që ka besim të vërtete nga hipokriti, pasi u ka sqaruar atyre argumentet e tij të shumta, argumentet e udhëzimit dhe u ka treguar mëshirën e Tij të gjerë në ajete dhe sure të shumta të Kur’anit fisnik përveç këtyre shkronjave të ndërprera. Këto shkronja në krahasim me argumentet e pafundme

40. Kur’an, Surja Ali Imran, 7.

41. Sheukeni, *Fetbu’l-Kadir*, 1, 48-49.

të Allahut, nuk cilësohen as sa një pikë në oqean.”⁴²

Thotë Mekij b. Ebi Talib: “Kjo tregon qartë se disa shkronjave ju është mbuluar kuptimi i tyre për të gjithë si sprovë nga Allahu dhe si test prej Tij. Kush u beson atyre do të shpërblehet dhe do të jetë i lumtur, ndërsa kush i mohon ato dhe ka dyshime rreth tyre, është në mëkat.”⁴³

2.1.1 Kuptimi dhe përmbajtja e “muteshabih”

Kuptimi leksikor i “muteshabih” është: “Diçka që ka pjesë që janë të ngjashme me njëra-tjetrën dhe në të cilën ka konfuzion dhe pështjellim.” Ndërsa si term ka kuptimin e fjalëve apo ajeteve të Kur’anit që nuk kanë kuptim të qartë, që janë të vështirë për tu kuptuar dhe që mund të kenë disa kuptime të ndryshme. Nuk mund të mësohet kuptimi i tyre vetëm nga vetja e tyre por kanë nevojë për argument të jashtëm. Siç është dita e kiametit, dalja e dexhalit, apo “El-Huruf el-Mukatta’a” në fillim të sureve. E kundërta e “muteshabih” është “muhkem” (me kuptim të qartë).⁴⁴

Në Kur’an siç gjejmë shprehje që tregojnë se të gjitha ajetet e tij janë “muteshabih”, po ashtu gjejmë shprehje që të gjitha ajetet e tij janë “muhkem”. Ajeti: **“Elif, Lam,**

42. Zerkeni, *Menebilu’l-Ifjan*, 1, 227.

43. Mekij, Ebu Muhamed b. Ebi Taliib el-Kisij, *el-Umdetu fi Garribi’l Kur’an*, fq 69.

44. Kurtubi, *el-Xhemiu Li’ebkemi’l-Kur’an*, 4, 9-10; Sujuti, *el-Itkan*, 2, 299.

Ra, (ky është) Libër, ajetet e të cilit janë radhitur (në mënyrë të përsosur, njëkohësisht) edhe shkoqitur nga i Dijshmi” (Surja Hud, 1), thotë që i gjithë Kur’ani është “muhkem” (me kuptim të qartë). Pra, kur thotë që është i gjithi “muhkem”, flitet që nuk ka asnjë mangësi apo të metë nga ana gjuhësore dhe ngjasim me njëri-tjetrin nga ana e vërtetësisë.⁴⁵ Në një ajet tjetër: **“Allahu ka shpallur Fjalën më të bukur (Kur’anin) në formën e një libri, pjesët e të cilit i ngjasojnë njëra-tjetrës dhe përsëriten**” (Surja Zumer, 23), tregon që i gjithë Kur’ani është “muteshabih”. Në këtë ajet “muteshabih” është përdorur me kuptimin “përngjasim”.⁴⁶ Në këtë kuptim, fjalët e Kur’anit nga fillimi deri në fund, për nga mënyra e shpjegimit dhe kuptimit të tyre i ngjasojnë njëra-tjetrës, dhe janë në përputhje me njëra-tjetrën. Kështu që, ajetet e Kur’anit nuk bien në kundërshtim me njëri-tjetrin.

Kur’ani Fisnik ndahet në “muhkem” (ajete me kuptim të qartë) dhe në “muteshabih” (ajete me kuptim jo krejtësisht të qartë) duke u bazuar tek ajeti: “Ai është që ta zbriti librin ty e që në të ka ajete të qarta dhe ato janë bazë e librit, e ka të tjerë që nuk janë krejtësisht të qartë (muteshabih).”⁴⁷

45. Cerrahoglu, Tefsir Usulu, f. 29.

46. Razi, Mefetihu’l-Gajb, f. 129.

47. Surja Ali Imran, ajeti 6.

Në emërtimin e “muhkem” dhe “muteshabih” janë thënë mendime të ndryshe:

I pari: “Muhkem” është që i dihet kuptimi i qartë ose kuptohet me komentim. Thotë Kurtubi: “Ky është mendimi më i saktë që është thënë për muhkem”.⁴⁸

I dyti: “Muhkem” është që kur komentohet ka vetëm një kuptim, ndërsa “muteshabih” është që kur komentohet mund të dalim kuptime të ndryshme”.⁴⁹ Ky është mendimi i Ibni Abasit.⁵⁰

Itreti: “Muhkem” është i pavarur (në kuptim), ndërsa “muteshabih” nuk është i pavarur (ka nevojë për diçka tjetër që të kuptohet).⁵¹ Ky mendim transmetohet nga Imam Ahmedit.⁵²

I katërti: Thuhet që “muhkem” ka kuptim të qartë, i kuptueshëm dhe që nuk mund të jetë i shfuqizuar. Ndërsa “muteshabih” ka kuptim të fshehtë që nuk mund ta kuptojmë dot as me logjikë, e as me transmetime. Kuptimin e tij e di vetëm Allahu (xh. sh), siç është dita e kiametit dhe “El-Huruf el-Mukatta’a” (shkronjat e ndërprera) në fillim të sureve.⁵³

Thotë Dr. Fadl Abas pasi i trajton këto mendime dhe të tjera: “Këto mendime janë të

48. Kurtubi, *el-Xhemiu Li’ebkemi’l-Kur’an*, 4, 10.

49. Sujuti, *el-Itkan*, 2, 299.

50. Zerkani, *Menehilu’l-Irfan*, 2, 292.

51. Sujuti, *el-Itkan*, 2, 299.

52. Zerkani, *Menehilu’l-Irfan*, 2, 292.

53. Po aty, 291.

ndërthurura me njëra-tjetrën, kështu që mund të zgjedhim dy mendime kryesore prej tyre:

I pari: “Muhkem” e ka kuptimin të qartë, ndërsa “muteshabih” qartësohet vetëm pasi kemi kërkuar dhe hulumtuar rreth tij.

I dyti: “Muhkem” është ai që i dihet kuptimi dhe është brenda sferës së mundësisë, ndërsa kuptimin e “muteshabih” e di vetëm Allahu.⁵⁴

2.2 Qasjet rreth kuptimit të “El-Huruf el-Mukatta’a”

Një grup tjetër dijetarësh, ku shumica e tyre janë nga gjeneratat e mëvonshme, kanë thënë se është e nevojshme që të studiohet kuptimi i ajeteve “muteshabih”. Për rrjedhojë, kanë thënë që është e rëndësishme të studiohet dhe të komentohet kuptimi i “El-Huruf el-Mukatta’a” shkronjave të ndërprera. Ebu Hajen, edhe pse nuk e përkrah këtë mendim, e pranon që shumica e dijetarëve janë të këtij mendimi.⁵⁵

Dijetarët që janë të mendimit që shkronjat e ndërprera kanë kuptim, kanë qasje të ndryshme rreth kuptimit të këtyre shkronjave. Madje në libra të ndryshëm përmenden deri në 20 mendime të ndryshme. Madje disa komentues Kur’ani i kanë trajtuar me detaje këto mendime.⁵⁶

54. Fadl Abas, *Itkanul-Burban fi Ulumi'l Kur'an*, Amman: Furkan viti 1997, 1, 489-490.

55. Ebu Hajen, *el-Bahrul-Mubit*, 1, 60.

56. Razi, *Mefetihu'l-Gajb*, 1, 250-252; Ibn Ashur, *et-Tehriru ue't-Tenuiru*, 1, 207-218.

Sipas Ibn Tejmijes fjala “muteshabih” në ajetin e 7-të të sure Ali Imran tregon që jo kuptimi dhe komenti nuk mund të dihet vetëm se nga Allahu, por ajo që nënkuptohet, që është e fshehtë nuk mund të dihet vetëm se nga Allahu. Urdhri për hulumtim që kalon në ajete të ndryshëm përfshin edhe “muhkem” (ajetet me kuptim të qartë) edhe “muteshabih” (ajetet me kuptim jo plotësisht të qartë). Sepse nuk mund të mendosh apo hulumtosh rreth diçkaje pa kuptim apo që është e vështirë të kuptohet.⁵⁷

Ibni Atije el-Endelusi, i cili thotë se përdorimi shkronjave të ndërprera në vend të fjalëve është diçka që ekzistonte në traditën arabe, pohon se “El-Huruf el-Mukatta’a” duhet të komentohen.⁵⁸ Elmalili thotë se me shkronjat e ndërprera nuk synohet kuptimi i fshehtë i tyre në ajetet Kur’anore, por synohen kuptime të ndryshme në atë masë që mund të kuptojë mendja njerëzore. Për rrjedhojë, “El-Huruf el-Mukatta’a” kanë disa kuptime të ndryshme.⁵⁹

Sipas Meududit, këto shkronja ekzistojnë në kulturën arabe. Këto shkronja zënë një vend të gjerë në letërsi, ato janë përdorur në shkrime dhe poezi të ndryshme. Duke u bazuar tek përdorimi i këtyre shkronjave në kulturën e tyre, arabët nuk e kundërshtuan

57. Ibni Tejmije, *Mexhmu'ul Fete'ue*, 8, 275.

58. Ibni Atije, *Muhararu'l-Uexbiż*, 1, 73.

59. Yazir, *Kur'an Dili*, 1, 159.

përdorimin e këtyre shkronjave në Kur'an, por me uljen e përdorimit të këtyre shkronjave me kalimin e kohës, dijetarët e tefsirit kanë hasur vështirësi në komentimin e tyre.⁶⁰

Sipas disa dijetarëve, të mendosh që këto shkronja kanë zbritur kot dhe pa kuptim, është një gabim i madh.⁶¹ Sipas tyre, ideja që mund të ketë fjalë pa kuptim më Kur'an, nuk përputhet me veçorinë e Kur'anit, i cili “ka zbritur në gjuhën e qartë arabe”,⁶² që i fton njerëzit që të meditojnë rreth tij,⁶³ dhe që **“është udhërrëfyes për njerëzit”** (Bekare, 2/185). Në të kundërt, shumë cilësi të Kur'anin si i qartë, i mjaftueshëm, dritë, argument dhe shumë cilësi të tjera do të mbeteshim pa kuptim. Për më tepër, kur shumë ajete na urdhërojnë që të hulumtojmë Kur'anin për të nxjerr argumente prej tij, dhe dihet që argumentet nxirren vetëm prej gjërave të kuptueshme. Të pretendosh që shkronjat e ndërprera nuk kanë kuptim, është shpifje e madhe për Kur'anin.⁶⁴ Mospasja e transmetimeve nga Profeti (a.s.) rreth kuptimit të shkronjave të ndërprera tregon qartë që kuptimi i tyre dihej dhe nuk kishte nevojë për koment.

Pas këtyre shprehjeve dhe vlerësimeve të përgjithshme, do të

shtjelloj mendimet e ndryshme të dijetarëve të tefsirit rreth kuptimit të “El-Huruf el-Mukatta'a”.

2.2.1 Sqaruese për mrekuillinë e Kur'anit

Disa dijetarë janë të mendimit se shkronjat e ndërprera janë përmendur në fillim të disa sureve (kapitujve) të Kur'anit për të sqaruar mrekuillinë e paarritshme të Kur'anit, gjegjësisht për të treguar se njerëzit janë të paafhtë të sjellin diçka të ngjashme si ai edhe pse këto janë shkronja që ata i njohin dhe i përdorin në gjuhën e tyre të përditshme.

Dijetarët klasik që kanë këtë mendim janë: Bekalani⁶⁵, Zemahsheri⁶⁶, Razi⁶⁷ dhe Ibni Kethir⁶⁸.

Thotë Zemahsheri: “Këto shkronja, nuk janë përmendur të gjitha së bashku në fillim të Kur'anit, por janë përsëritur në disa vende që të jenë më bindëse në të sfiduar, ashtu siç është rasti edhe me përsëritjen e shumë rrëfimeve, ndërkaq në disa vende, të sfiduarit është bërë me fjalë të qarta. Këto janë përmendur për t'i tërhequr vëmendjen kundërshtarëve që sfidojnë Kur'anin fisnik, edhe pse këto janë shkronja që ata i njohin dhe i përdorin në të folurën e tyre, por sërish nuk mundën të sjellin diçka të ngjashme së Kur'ani. Sepse Kur'ani nuk është e folur

60. Meududi, *Tefhim*, 1, 48.

61. Ibni Kethir, *Kur'ani'l-Adhim*, 1, 160.

62. Surja Shuara, 26/195.

63. Surja Nisa, 4/82; Surja Muhamed, 47/24.

64. Razi, *Mefetihu'l-Gajb*, 1, 250-252.

65. Bekalani, *I'axbezu'l-Kur'an*, fq 68-69.

66. Zemahsheri, *el-Keshef*, 1, 95-97.

67. Razi, *el-Tefsiru'l-Kebir*, 2, 8.

68. Ibni Kethir, *Tefsiru'l Kur'an*, 1, 37-38.

njerëzore, por është fjalë e Krijuesit të gjithëpushtetshëm.⁶⁹

Thotë Ibn Kethiri: “Për çdo sure, e cila fillon me këto shkronja të ndara, patjetër që përmendet në të ngadhënjimi i Kur’anit dhe sqarohet paarritshmëria dhe madhështia e tij. Nga analiza e Kur’anit, ky konstatim vërehet qartë dhe haset në njëzet e nëntë sure. Prandaj, Allahu i Lartë thotë: “Elif, Lam, Mim. Ky është libri që nuk ka dyshim në të...”⁷⁰”⁷¹

Në radhët e dijetarëve modern të komentimit të Kur’anit, mendimi që shkronjat e ndërprera janë vendosur për treguar mrekullinë e paarritshme të Kur’anit dhe për të sfiduar mohuesit, zë një vend të gjerë. Midis tyre mund të përmendim Reshit Riza, Sheltut, Ibni Ashur dhe Aishe Abdurrahman.⁷² Gjithashtu edhe Muhamed Tantaui mendon në këtë mënyrë.⁷³ Muhamed Ebu Zehra thotë se fakti që menjëherë pas këtyre shkronjave vijnë ajete që flasin rreth Kur’anit, tregon që këto shkronja janë për të treguar mrekullinë e paarritshme të Kur’anit, për të sfiduar mohuesit, janë edhe si argument që kanë zbritur nga Allahu.⁷⁴

Sejid Kutub thotë: “Këto shkronja janë tregues që ky libër

është i përbërë nga shkronja të cilat arabët i njohin. Megjithatë ata janë të paaftë që të sjellin një Kur’an të tillë. Kur’ani, është libri që i sfidon ata që të sjellin një tillë si ai, një herë tjetër i sfidon që të sjellin dhjetë sure si ai apo edhe një sure të vetme si ai, por ata nuk kishin ndonjë përgjigje për këtë sfidë.”⁷⁵

Said Nursi në komentim që i bën “El-Huruf El-Mukatta’a”, tregon që edhe ai ka një qasje të tillë. Sipas tij: “Shkronjat e ndërprera që gjenden në fillim të njëzet e nëntë shkronjave reflektojnë mrekullinë në paarritshmërinë e Kur’anit. Mrekullia është e bukur si diamanti, është dritë që formohet nga reflektimi i shkallës së lartë të elokuençës.”⁷⁶

Në komentimin e sures Bekare, Fethullah Gylen thotë për shkronjat e ndërprera: “Këto shkronja, janë si elementët që formojnë atomin dhe si qelizat që përbejnë trupin e njeriut. Mrekullia e vërtetë është në këtë pikë: Edhe pse elementët që përbejnë një krijesë dihen, askush nuk ka fuqi ta krijojë atë veç Allahut. Po ashtu, edhe Kur’anin, edhe pse dihen shkronjat e tij që janë (elif be te...) apo siç janë këtu (elif lam mim), sërish askush nuk mund të shkruaj një Kur’an si ky. Sepse, ashtu siç është i paarritshëm Allahu në të krijuar (askush nuk mund të krijoj si

69. Zemahsheri, *el-Keshef*, 1, 95-97.

70. Kur’an, *Bekare*: 1-2.

71. Ibni Kethir, *Tefsiru’l-Kur’an*, 1, 37-38.

72. Xhafer, *Eneilu’s -Seuer*, f. 57.

73. Muhamed Tantaui, *Tefsiru’l-Uesit*, Kairo: Daru Nehde, 1997-1998, 1, 39.

74. Muhamed Ebu Zehra, *Zebratu Tefesir*, Kairo: Daru’l-Fikr, 1, 96-97.

75. Sejid Kutub, *Fi Dhileli’l-Kur’an*, Kairo: Daru Shuruk 1980, 1, 38.

76. Said Nursi, *Isberratul Icaz*, Stamboll: Envar Nesriyat, 2004, f. 31.

Ai), ashtu është i paarritshëm në të folur. Pra, ashtu siç është mrekulli urdhri i Allahut në univers që është fushëveprimi i “Fuqisë” dhe “Vullnetit”, mrekulli është edhe libri i ardhur nga cilësia e Allahut “Fjala”. Allahu, duke e nisur suren Bekare me (elif lam mim) fjalë që cilësohen si fjalë çelës, sikur u thotë njerëzve duke i sfiduar “Hajde urdhëroni, duke përdorur këto shkronja që i përdorni në të folur e në të shkruar dhe duke formuar fjali me këto, shkruani një Kur’an tjetër si ky”. Ajetet në vijim tregojnë këtë të vërtetë: “Nëse ju dyshoni në atë që ia kemi zbritur robët tonë (Muhamedit a.s.), atëherë hartoni një sure të ngjashme me atë që ia kemi shpallur atij! Thirrni në ndihmë edhe dëshmitarët tuaj (që i adhuroni) në vend të Allahut, nëse jeni të sigurtë. Nëse nuk mundeni, dhe kurrsesi nuk do të mundeni, atëherë ruajuni zjarrin, lëndë djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët dhe që është përgatitur për të ndëshkuar mohuesit”. (Surja Bekare, 23-24)⁷⁷

Një nga dijetarët e njohur të tefsirit, Tantaui Xheuheri, e ka trajtuar nga një aspekt tjetër mrekullinë e paarritshme të Kur’anit, ai e ka trajtuar çështjen duke u nisur nga numri i shkronjave. Sipas tij: “Shkronjat në gjuhën arabe janë 28. 14 nga këto shkronja janë me pika dhe 14 të tjerat pa pika. Gjithashtu “El-Huruf el-Mukatta’a” janë 14

shkronja, të cilat janë përdorur në grup-shkronjash të ndryshme. Muaj ka 28 faza, 14 në jug dhe 14 në veri. Si ka mundësi që Muhamedi (s.a.s) apo ndonjë njeri tjetër të ndërtoj një sistem kaq perfekt, t’i përshtasë këto numra me numrat e tjerë në univers dhe këto ligje t’i përshtasë me principet e tjera?! Për këtë arsye, Allahu duke vendosur këto shkronja në fillim të sureve, thotë që Kur’ani është Libri Im.”⁷⁸

2.2.2 Argument për profetësinë e Muhamedit (a.s.)

Disa dijetarë mendojnë se këto shkronja janë treguese të profetësisë së Muhamedit (a.s.), parë nga aspekti që Ai nuk dinte shkrim e këndim dhe fliste me emrat e shkronjave që janë “El-Huruf el-Mukatta’a” (shkronjat e ndërprera). Dihet që e folura me emrat e shkronjave është punë e leximtarëve dhe jo e atyre që nuk dinë shkrim e këndim. Përdorimi i shkronjave të ndërprera në fillim të sureve ishte argument i preکشëm që Profeti Muhamed (s.a.s) nuk fliste nga vetja e Tij, por i vinte shpallja nga i Gjithëdituri i Urtë.

Dijetarët klasikë të cilët kanë mendim janë Zemahsheri⁷⁹, Nesefi⁸⁰ dhe Bejdau⁸¹.

Thotë Zemahsheri: “Fillimi i sures në këtë formë, në mënyrë

78. Tantaui, *el-Xhe’uebir fi Tefsiri’l-Kur’ani’l-Kerim*, Bejrut: Daru’l-Kutub viti 2004, 2, 5-7.

79. Zemahsheri, *el-Keshef*, 1, 99-100.

80. Nesefi, *Tefsiru Nesefi*, 1:40.

81. Bejdau, *Tefsiru Bejdau*, 1, 86.

77. Fethullah Gylen, *Bir P’caz Hecelemesi*, Stamboll: Botimet Nil 2014, f. 72.

që gjëja e parë që të dëgjoj veshi të jetë diçka e tillë, e cila është nga argumentet e mrekullisë së paarritshme të Kur'anit. Sepse e folura e zakonshme me shkronja ishte një nivel i te folurit normal e atyre që ishin analfabet dhe e ithtarëve të librit. Në kundërshtim me të folurën me emrat e shkronjave, e cila ishte diçka e veçantë e atyre që shkruanin, lexonin, shoqëroheshin me ithtarët e librit dhe mësonin prej tyre. Ishte diçka e habitshme që dikush, i cili nuk ishte marrë me shkrim e me këndim të fliste me shkronja të ndërprera, siç thotë Allahu i Lartë: “ti (Muhamed) nuk kishe lexuar kurrfarë libri e as që kishe shkruar gjë me dorën tënde; përndryshe, ndjekësit e së pavërtetës do të dyshonin”⁸². Pra e folura në këtë formë ishte argument që Profeti (s.a.s) nuk i kishte mësuar këto nga të afërmit e Tij apo nga ngjarjet që tregonte Kur'ani për popujt e mëparshëm që nuk i dinin Kurejshët, por kjo ishte e gjitha shpallje që i vinte nga Allahu.”⁸³

Sipas Said Nursit, rruga e ndjekur në mësimin me shkronja të tilla ishte diçka e re, dhe që nuk imiton asnjë lloj stili letrar të mëparshëm. Kjo lloj metode që ndjek Kur'ani, e sjellë nga një person që nuk di shkrim e këndim, tregon për vërtetësinë e personit dhe tregon që burimi i këtij libri është hyjnor.”⁸⁴

82. Kur'an, *Ankebut* 48.

83. Zemahsheri, *el-Keshef*, 1, 99-100.

84. Said Nursi, *Isheratul Icaz*, f. 35-36.

Ka edhe prej atyre që e kundërshtojnë këtë mendim, duke thënë se edhe njerëzit që nuk dinë shkrim e këndim mund të thonë fjalë të tilla, siç ka ndodhur më herët në poezinë arabe.⁸⁵

2.2.3 Emra të sureve

Disa dijetarë mendojnë se këto shkronja janë emër i secilës sure që ato fillojnë. Ashtu siç janë vendosur emra për të bërë dallimin e sureve nga njëra-tjetra, ashtu janë vendosur edhe këto shkronja për të dalluar suret nga të tjerat.

Dijetarë klasikë të cilët mbështesin këtë mendim janë Zemahsheri⁸⁶, Razi⁸⁷ dhe Sibeuejhi⁸⁸. Gjithashtu Hasan Basriu thotë se nuk e di kuptimin e këtyre shkronjave, por një grup nga myslimanët i cilësojnë këto shkronja si emra të sureve dhe çelësa të tyre.⁸⁹

Argumentet që këto shkronja janë emrat e sureve:

Ata të cilët kanë këtë qasje në lidhje me hurruful el-Mukatta'a (shkronjave të ndërprera) kanë këto argumente:

I pari: Transmetimi nga Ebu Hurejra që Profeti (a.s.) lexonte në namazin e sabahut ditën e premtë “Elif lam mim Sexhde” (suren sexhde) dhe “Vallë, a nuk ka kaluar

85. Ibni Ashur, *et-Tehruru ue'r-Tenuiru*, 1, 215.

86. Zemahsheri, *el-Keshef*, 1, 83.

87. Razi, *et-Tefsiru el-Kebir*, 2:7.

88. Sibeuejhi, Ebu Beshir Amru b. Uthmen, *el-Kiteb*, 2, 34-3.

89. Duman, *Hurufi Mukattaa*, DIA, 18, f. 401-408.

një periudhë kohore, kur njeriu...” (suren Insan).⁹⁰

I dyti: Është fakt që këto shkronja në fillim të sureve janë bërë si shenja dalluese për emrat e tyre. Si për shembull kur përmend një shkronjë dhe kuptohet një objekt i caktuar.⁹¹

Reshit Riza e prezanton idenë që këto shkronja janë emra të sureve si bindje të Muhamed Abduh.⁹² Ndërsa Ferid Uexhdi, thotë që shumica i pranon këto shkronja si emra të sureve ku gjenden.⁹³ Por, Alusi e kundërshton këtë mendim. Sepse, ka disa sure që fillojnë me të njëjtat shkronja. Emër i cilës sure do të jenë këto shkronja dhe kush do vendos për këtë. Sikur të ishin këto shkronja emra të sureve, duhet të kishte ardhur transmetimi tek ne, që të mos përdorej emër tjetër për këto sure që përmbajnë shkronja të ndërprera.⁹⁴

2.2.4 Betime të Allahut

Disa dijetarë thonë që Allahu është betuar me këto shkronja për të treguar vlerën e tyre. Dijetarët të cilët kanë këtë qasje janë Ibn Abasi⁹⁵,

90. Sahihu Buhari, *Kitebu Xhum'uat*, 891; Sahihu Muslim, 879.

91. Ibn Ashur, *et-Tehruru ue'l-Tenuiru*, 1, 210.

92. Reshit Riza, *Menar*, 1, 103.

93. Ferid Uexhdi, *el-Mus'hafu'l-Mufeser*, Bejrut: Darul Marife, 1971, f. 201.

94. Alusi, *Ruhul-Meani*, 1, 100.

95. Nesefi, *Tefsiru Nesefi*, 1, 39. Ibn Abasi është Abdullah b. Abas b. Abdulmutalib, djali i xhaxhait të Profetit Muhamed (s.a.s.). Lindi tre vjet para hixhretit dhe ndërroi jetë në viti 68 hixhrij. Shih Ibn Haxher, *Isabetu fi Temjizi Sahabetu*, 5, 130-140.

Ikrime⁹⁶, Ehfesh⁹⁷ dhe Zerrkeshi⁹⁸.

Thotë Zerrkeshi: “Allahu është betuar me këto shkronja se ky libër që lexon Muhamedi (a.s.) është libër i shpallur nga Allahu pa asnjë mëdyshje. Kjo tregon lartësinë e këtyre shkronjave, siç është betuar në “agim”, në “paradite” apo edhe në gjëra të tjera.”⁹⁹

Një argument tjetër që mbështeten ndjekësit e këtij mendimi është transmetimi i Bejhakiut rreth Emrave dhe Cilësive të Allahut nga Ibni Abasi: “Ajetet si (Kef he je ajn sad), (Ta he), (Ta sin mim), (Je sin), (Sad), (Ha mim ajn sin kaf), (kaf) e të tjera janë betime që është betuar Allahu, dhe janë nga emrat e Allahut (xh.sh).¹⁰⁰

Sipas Ehfesh dhe Ibni Kajim'it, në Kur'an ashtu siç betohet për lapsin (kalem), agimin (fexhr), fikun (tin) dhe ullirin (zejtun), është betuar edhe për shkronjat e ndërprera. Sepse shkronjat përbëjnë bazën e librave që Allahu ka dërguar dhe përbëjnë thelbin e Emrave të Allahut. Allahu me këto shkronja sikur betohet që Kur'ani është libri dhe fjala e Tij.¹⁰¹

96. Sujuti, *Deru Menthur*, 1, 54. Ai është Ikrime b. Ebi Xhehl Amru b. Hishem. U bë mysliman pas çlirimit të Mekës. Mori pjesë në shumë beteja dhe ra dëshmor në betejën e Jermukut në vitin 13 hixhrij në moshën 62 vjeçe. Shih Zerrkeli, *E'alem*, 4, 244.

97. Ehfesh Eusat, Ebu Hasen Seid b. Mis'adetu, *Me'ani'l-Kur'an*, 1, 20.

98. Zerkeshi, *el-Burben*, 1, 173.

99. Po aty.

100. Ebu Hajen, *el-Bahrul-Muhit*, 1, 58.

101. Razi, *Mefetihul-Gajb*, 2, 254; Ibn Kajim el-Xheuzije, *et-Tibjan fi Aksemi'l-Kur'an*,

2.2.5 Tërheqje vëmendje

Disa dijetarë mendojnë se shkronjat e ndërprera kanë zbritur për të tërhequr vëmendjen politeistëve duke qenë se këto shkronja do tu tingëllonin çuditshëm, dhe kështu do të dëgjojnë Kur'anin dhe do tu shkojë argumenti. Pra, sipas tyre funksioni i këtyre shkronjave është vetëm si thirrëse. Dijetarët klasikë që kanë këtë qasje janë Razi¹⁰² dhe Zerkani¹⁰³.

Thotë Zerkani: “Dihet që armiqtë e Islamit në fillimet e ftesës Islame i thoshin njëri-tjetrit: “Mos e dëgjoni Kur'anin, mbyllini veshët se mos ndoshta ju mund”. Kur zbriste ndonjë sure që fillonte me shkronja të ndërprera, ata fillonin ta dëgjonin dhe u tërhiqej vëmendja kah e vërteta. Kështu ata ishin para argumenteve të qarta që jua qetësonte zemrën dhe jua vinte trurin në punë. Për rrjedhojë, ata që donte Allahu të udhëzohen, udhëzoheshin. Mohuesit dhe kryeneçët vendoseshin përballë argumenteve të pakontestueshme, dhe kështu nuk kishin justifikim për mohimin e tyre në këtë botë e as në tjetrën.”¹⁰⁴

Thotë Fahrudin Razi në tefsirin (komentin) e sures Ankebut: “I Urti kur i drejtohet dikujt që është i hutuar apo i pavëmendshëm, para

se të thotë atë që dëshiron të shpreh, i drejtohet atij me diçka tjetër për t'i tërhequr vëmendjen. Ky para fjalim mund të jetë diçka kuptimplotë, si p.sh ti thuash dikujt “dëgjo këtu”. Por, gjithashtu ky para fjalim mund të jetë diçka pa kuptim, siç është fërshëllima mbrapa dikujt për t'i tërhequr vëmendjen. Kjo mund të jetë edhe diçka pa përdorur gojën siç është përplasja e duarve që dëgjuesi të drejtohet nga personi. Zgjedhja e disa shkronjave nga i Urti si paralajmëruese para se të shpreh atë që dëshiron, ia arrijnë më shumë qëllimit të dëshiruar sesa përdorimi i fjalëve me kuptim. Sepse vendosja para e këtyre shkronja paralajmëruese për të tërhequr vëmendjen e dëgjuesit për të dëgjuar atë që vjen më pas, bën që dëgjuesi mos ta shkëpusë vëmendjen nga ajo që do të vij më pas. Për rrjedhojë, vendosja e shkronjave të pakuptimita para fjalimit të synuar ka një urtësi të madhe.”¹⁰⁵

Një mendim i tillë ka zënë vend edhe tek dijetarët modern si Reshit Riza dhe Meragi.¹⁰⁶ Reshit Riza thekson se me këto shkronja duke ju tërhequr vëmendjen politeistëve mekas, janë ftuar në Islam dhe kështu u është bërë e njohur profetësia e Muhamedit (s.a.s). Më pas, e njëjta mënyrë ftese iu drejtua ithtarëve të

Bejrut: Darul Ihja viti 1982, f. 126-127.

102. Razi, *Tefsiru'l-Kebir*, 2, 8.

103. Zerkani, *Menahilu'l-Irfan*, 1, 230.

104. Po aty 230-231.

105. Razi, *Tefsiru'l-Kebir*, 13:27.

106. Riza, *Menar*, 8, 296; Ahmed Mustafa Meragi, *Tefsiru Meragi*, Bejrut: Daru'l-Kutub, 1984, 22, 145.

librit në Medine.¹⁰⁷ Edhe Subhi Salih e mbështet këtë mendim.¹⁰⁸

2.2.6 Llogaritja Xhumel dhe Ebxhed

Përpara se të përmendim përdorimin e shkronjave të ndërprera në këtë formë, do të trajtoj shkurtimisht llogaritjet xhumel dhe ebxhed.

2.2.6.1 Përkuftizimi i llogaritjes Xhumel ose Ebxhed

Renditja e shkronjave dhe fjalëve arabe sipas alfabetit të vjetër Sami duke përftuar kështu vlera numerike, apo sistemi i përlllogaritjes numerike që përftohet nga vlerat numerike që simbolizon secila shkronjë quhet llogaritje Ebxhed ose Xhumel. Gjithashtu Ebxhed janë shkronjat e para të alfabetit arab dhe emri i parë që i është vënë atij.¹⁰⁹

2.2.6.2 Shkenca Xhifr

Duke u bazuar në të fshehtat e shkronjave, numrat dhe format gjeometrike, të japësh njoftime për të ardhmen quhet shkenca xhifr. Shkenca xhifr i ka rrënjët që në lashtësi. Por, me ardhjen e Islam, duke u bazuar tek kuptimet e brendshme të shkronjave dhe të disa ajeteve të Kur'anit, Xhaferri Sadik ka dhënë disa njoftime rreth të ardhmes.¹¹⁰

107. Riza, *Menar*, 8, 302.

108. Subhi Salih, *Mebabith*, f. 243-246.

109. Ibni Mandhur, *Lisani'l-Arab*, 9, 128; Mustafa Uzun, *Ebced*, DIA, 10, Stamboll: Botimet e Dijanetit turk 1994, f. 68-70.

110. Metin Yurdagur, *Cefr*, DIA, 7, Stamboll: Botimet e Dijanetit turk 1993, f. 215-218.

2.2.6.3 Llogaritja Ebxhed e shkronjave të ndërprera

I pari që ka përdorur llogaritje ebxhed të shkronjave të ndërprera është Mukatil b. Sulejman. Duke mbledhur shkronjat e përsëritura, ka arritur në shumën 744 dhe ka thënë që ky numër tregon për moshën e popullit mysliman.¹¹¹ Alusi në një transmetim nga Iz b. Sulejman nga shkronjat (ha mim ajn sin kaf) ka arritur të nxjerr ngjarjen mes Aliut dhe Muauijes.¹¹²

Ebul Hakem b. Berexhan, i cili mbron tezën se mund të nxirren disa njoftime rreth së ardhmes nga Libri Allahut, nga ajetet e para të sures Rum ka nxjerrë vitin 583 kur Jerusalemi do të merrej nga të krishterët. Ibni Berexhan vdiq në vitin 536 dhe në të vërtetë në vitin 583 Jerusalemi merret nga kryqtarët.¹¹³

Pavarësisht faktit që në disa raste janë bërë disa llogaritje që kanë rezultuar të sakta, në Kur'an nuk gjendet asnjë ajet që të flasë për emrat "ebxhed" dhe "xhifr" apo për këtë lloj llogaritjeje. Dijetarët klasikë duke përdorur këtë lloj metode nuk kanë treguar dot asnjë informacion që mund të jenë të gjithë dakord. Në Kur'an nuk gjendet asgjë që ta bëjë të lejuar këtë lloj tefsiri (komentimi) duke u bazuar në "Ebxhed".¹¹⁴

111. Tahir, *Eucilu Su'ner*, f. 17.

112. Po aty.

113. Ebu Hajen, *el-Babru'l-Mubit*, 7, 374-375.

114. Yazçiçek, *Cefr ve Ebced*, f. 86-88.

Duke u bazuar në vlerat numerike të këtyre shkronjave nuk mund të arrihet në një përfundim të saktë dhe të bësh parashikime rreth të ardhmes në këtë formë nuk është diçka e saktë. Sipas shumë dijetarëve myslimanë, parashikimi që bëhet me këtë lloj llogaritjeje nuk mund të ketë ndonjë të vërtetë fetare. Sepse, sipas tyre, e ardhmja e Islamit nuk mund të jetë e lidhur me parashikimi të pabaza.¹¹⁵

2.2.7 Mësim, shkrim dhe këndim

Disa dijetarë mendojnë që këto shkronja janë për t'i mësuar shkronjat e ndërprera, në mënyrë që kur të përmenden më pas në formë të rregullt, t'i kenë mësuar që më herët. I mësuat ato siç mësojnë fëmijët, i mësojnë shkronjat të ndara pastaj i mësojnë të bashkuara.

Dijetari që ka këtë qasje është Aziz b. Jahja¹¹⁶, që thotë: “Allahu i ka përmendur këto shkronja dhe Ai sikur ka dashur të thotë: ‘Dëgjojeni ato të ndara në mënyrë që kur t’i dëgjoni të bashkuara, t’i keni njohur ato që më herët. Ashtu si fëmija, në fillim i mëson shkronjat e ndara pastaj i mëson ato të bashkuara.’”¹¹⁷

Suat Yildirim shprehet kështu në lidhje me këtë temë: “Me

përmendjen e këtyre shkronjave, kuptohet që Kur’ani po mëson një popull analfabet dhe fillestar. Ashtu siç zbulimi i shkrimit solli fillimin e një epoke më të avancuar për njerëzimin, ashtu edhe udhëzimi që solli ky Libër, hapi rrugën e zhvillimit të qytetërimit dhe i nxori nga errësira në dritë. Ai ishte një Libër që filloi me “Lexo” dhe që në shpalljen e parë foli që Allahu “ia mësoi njeriut shkrimin (me laps)” (Surja Alak, 96/1-5). Allahu na nxit që të mësojmë shkrim e këndim. Sepse t’i lexosh shkronjat me emrat e tyre, është punë e fillestarëve në mësim. Këto shkronja duke ardhur ndonjëherë një, ndonjëherë dy, ndonjëherë tre, ndonjëherë katër dhe ndonjëherë pesë, përbëjnë një ushtrim shkallë shkallë.”¹¹⁸

2.2.8 Simbole

Disa dijetarë të tefsirit nga sahabët (shokët e Profetit (a.s.), nga tabi’inët (pasuesit e sahabëve) dhe nga pasuesit e tyre, janë të mendimit se këto shkronja të ndërprera në fillim të sureve janë simbole të emrave dhe cilësive të Allahut (xh. sh).

Këtë qasje nga sahabët e ka Ibn Abasi¹¹⁹ dhe Ibni Mes’ud¹²⁰, ndërsa

118. Yildirim, *Kur’an Ilimlerine Giriş*, f. 113.

119. Kurtubi, *Xbemin’l-Abkamul-Kur’an*, 1, 156.

120. Nesefi, *Tefsiru Nesefi*, 1, 39. Ibn Mes’udi është Abdullah b. Mes’ud b. Gafil. Është nga myslimanët e parë dhe ka ndërruar jetë në Medine në vitin 32. Shih Abdullberr, *Istiaab fi Marifeti’l-Es’hab*, 3,110-116.

115. Akpınar, *Kur’anda Hece Harfleri*, f. 60.

116. Abdulaziz b. Jahja nga Meka. Ka qenë nga nxënësit e Imam Shafut. Ka ndërruar jetë në vitin 240 hixhri. Shih Zerrkelij, *E’alem*, (3:93).

117. Razi, *Tefsiru Razi*, 2, 8.

nga tabi'inët Selim b. Abdullah¹²¹ dhe Sheabij¹²².

Argumenti që mbështeten këta është transmetimi i Bejhakiut rreth Emrave dhe Cilësive të Allahut nga Ibni Abasi: “Ajetet si (Kef he je ajn sad), (Ta he), (Ta sin mim), (Je sin), (Sad), (Ha mim ajn sin kaf), (kaf) e të tjera janë betime që është betuar Allahu, dhe janë nga emrat e Allahut (xh.sh).¹²³ Si shembull i kësaj qasjeje mund të përmendim: “Me “elif” synohet Allah, me “mim” synohet Muhamedi (a.s.) dhe me “lam” synohet Xhebraili (a.s.).¹²⁴

2.2.9 Fillimi i një kapitulli dhe fillimi i një tjetri

Disa dijetarë mendojnë se këto shkronja tregojnë mbylljen dhe përfundimin e një sureje (kapitulli) dhe fillimin e një tjetri. Këtë qasje e kanë dijetarët si Muxhahid¹²⁵, Ebu Ubejde¹²⁶ dhe Ehfesh¹²⁷.

121. Ibni Kethir, *Tefsiru'l-Kur'ani'l-Adhim*, 1,36. Selim është Selim b. Abdullah b. Umrr b. Hatab, nga të parët e tabi'inëve dhe nga dijetarët e tyre. Ndërroi jetë në vitin 106 hixhrij. Shih Zerrkelij, *E'alem*, (3:71).

122. Taberi, *Xhemiu'l-Bejen*, 1,67.

123. Ebu Hajen, *el-Babru'l-Muhit*, 1,58.

124. Maturidi, *Te'uilet*, 1, 370; Meki b. Ebi Tâlib, *Tefsiru'l-Mushkil min Garibi'l-Kur'ani'l-Adhim*, Bejrut: Daru Nuri'l-Islami viti 1988, f. 85.

125. Taberi, *Xhemiu'l-Bejen*, 1, 67. Muxhehid b. Xhubejr Ebu Haxhaxh, ka qenë mufesir (komentues Kur'ani) nga tabi'inët. E ka mësuar tefsirin nga Ibni Abasi (r.a). Lindi në vitin 21 hixhrij dhe vdiq në vitin 104 hixhri. Shih Zerkelij, *E'alem*, 5,278.

126. Ebu Ubejde, Muemer b. Muthene et-Timij, *Mexhez'u'l-Kur'an*, 1,28.

127. Ekhfesh, *Meani'l-Kur'an*, 1,21.

2.2.10 Përmbajtja e disa kodeve

Sipas Bejdauit, këto shkronja që gjenden në fillim të 29 sureve, secila prej tyre është një kod që nënkupton një emër të Allahut, mirësi apo ndonjë fatkeqësi me të cilat sprovohet njeriu. Për shembull: “elif” është kod i emrit Allahu, “lam” është kod i emrit Latif (i Butë), ndërsa “mim” është kod i emrit Mexhid (Bujar).¹²⁸

Said Nursi thotë: “El-Huruf el-Mukatta'a në fillim të sureve janë kode hyjnore. Allahu me anë të tyre i ka dhënë disa mesazhe të fshehta robit të tij të veçantë, Muhamedit (s.a.s). Çelësi i atij kodi gjendet në duart e robërve të Tij të veçantë dhe pasardhësve të tyre. Përdorimi i këtyre shkronjave të koduara tregon për zgjuarsinë e pashoqe të Muhamedit (a.s), saqë edhe kodet më të fshehta i kupton si gjërat më të thjeshta. Vlera e këtyre shkronjave të ndërprera nuk është vetëm tek kuptimi i tyre, por siç është shprehur në shkencën e “të fshehtat e shkronjave”, ashtu siç është në tabelat numerike, tregon që ka një lidhje natyrore mes shkronjave.”¹²⁹ Ndërsa në një vend tjetër thotë: “Fakti që Kur'ani i drejtohet çdo epoke, do të thotë që ai përmban kuptime që u drejtohet njerëzve të çdo lloj epoke dhe sipas nivele të tyre. Pjesa më mirë, u ka rënë të parëve tanë të mirë. Miqtë e Allahut, në udhëtimet e tyre shpirtërore, kanë

128. Bejdau, *En'uenu Tenzil*, 1, 35-36.

129. Nursi, *Isberratu'l Ixhaz*, f. 35.

gjetur shumë tregues të së fshehtës nga këto kode.”¹³⁰

Fethullah Gyleni shprehet që këto shkronja janë kode që përdoren nga Allahu (xh.sh). Dijetarët e mëdhenj si Muhjidin b. Arabi, Imam Rrabani dhe Bediuzaman, të cilët kanë ndikuar tek popujt me mendimet tyre, i kanë zgjidhur këto kode. Ai thotë: “Njohja e kodeve që përfaqësojnë këto shkronja, bëhet vetëm me frymëzim. Allahu i frymëzon zemrat që dëshiron t’jua tregojë këto kode. Pastaj ata, i zbulojnë të fshehtat e Kur’anit në periudhën e tyre me anë të këtyre kodeve dhe ua përcjellin njerëzve përreth këto të fshehta hyjnore. Këto sekrete nuk kanë të bëjnë me gjërat për të cilat jemi përgjegjës karshi Allahut. Këto sekret janë sofra Kur’anore dhe mirësi hyjnore ekstra.”¹³¹

Koment tjetër interesant rreth kësaj qasjeje gjendet edhe në tefsirin e Xheuherit. Ai thotë që shkronjat e ndërprera mund të jenë kode të elementeve minerale. Kush i njeh mirë këto kode, mund të bëj shpikje të reja kimike. Për shembull sipas tij “ha” simbolizon hadid (hekurin), “nun” nuhas (bakër), “elif” oksigjen dhe “je” hidrogjenin. Hulumtimet moderne, duke u bazuar tek shkronjat

e ndërprera, do të ndihmojnë në zbulimet e reja kimike.¹³²

2.2.11 Qasja e orientalistëve rreth shkronjave të ndërprera

Një vlerësim i shkurtër rreth qasjeve të orientalistëve mendoj se do të ishte me vend, edhe pse nuk ka lidhje të drejtpërdrejte me temën tonë. Në përgjithësi orientalistët i kanë vlerësuar “El-Huruf el-Mukatta’a” si shkurtime, duke ndjekur kështu metodën e disa dijetarëve myslimanë. Për rrjedhojë, edhe ata janë në mosmarrëveshje me njëri-tjetrit se çfarë tregojnë këto shkurtime. Por, shumë orientalistë, duke u bazuar në qasjet që ekzistojnë rreth shkronjave të ndërprera, janë përpjekur të vërtetojnë që Kur’ani është libër i shkruar nga Muhamedi (a.s.) apo që Kur’ani është një vepër e sajuar.¹³³ Ndër orientalistët më të njohur është Noldeke, i cili ka ndikuar edhe tek të tjerët pas tij. Ai pretendon se këto shkronja nuk janë pjesë e Kur’anit, por janë shkronja e parë e emrave të sahabeve që kanë mbledhur Kur’anin. Sipas tij, shkronja “mim” simbolizon Mugirren, “he” Ebu Hurejre, “sad” Sad b. Ebi Uakas dhe “nun” Uthman b. Afen.¹³⁴

2.2.12 Kuptime të ndryshme:

Disa dijetarë mendojnë se këto shkronja të ndërprera janë marrë nga emrat dhe foljet. Çdo shkronjë

130. Nursi, *Mektubat*, Stamboll: Nesil viti 2012, f. 365.

131. Fethullah Gylen, *Kur’anin Altin İkliminde*, Stamboll: Botimet Nil viti 2010, f. 74.

132. Xheuheri, *Xhe’nebir*, 2, 12-19.

133. Duman, *Huruf-i Mukattaa*, DIA, 18, f. 405.

134. Po aty, f. 406.

tregon kuptim të ndryshëm nga shkronja tjetër. Disa nga këto tregojnë për Emrat e Allahut, disa të tjera tregojnë për emra të tjerë veç Allahut. Pra, këto shkronja tregojnë për emra që u është marrë vetëm një shkronjë dhe pjesa tjetër është fshirë.

Dijetarët që kanë këtë qasje janë Ibnî Abasi¹³⁵, Ibnî Mes'udi¹³⁶, Seid b. Xhubejr¹³⁷ dhe Zuxhexh¹³⁸.

Argumenti që mbështeten këta dijetarë qasje është transmetimi i Bejhakiut rreth Emrave dhe Cilësive të Allahut nga Said b. Xhubejr, nga Ibnî Abasi: “(Kef he je ajn sad كهيعص), kef vjen nga “Kerim” me kuptimin Bujar, he vjen nga “Hedij” me kuptimin Udhëzues, je vjen nga “Hakim” me kuptimin i Urtë, ajn vjen “Alim” me kuptimin i Ditur dhe sad vjen nga “Sadik” me kuptimin Besnik.”¹³⁹

Thotë Taberi: “Është e përhapur në të folurën e arabëve që folësi të fshijë shkronja nga fjala nëse shkronjat e mbetura tregojnë që në atë fjalë janë fshirë shkronja.

135. Zerkani, *Menebilu'l-Irfan*, 1, 233.

136. Razi, *Tefsiru'l-Kebir*, 7, 2.

137. Ibn Kethir, *Tefsiru'l Kur'an*, 1, 36. Said b. Xhubejr el-Esedij, nga tabi'inët, ka mësuar dije fetare nga Abdullah b. Abas dhe Ibn Umr. Është vrarë në vitin 95 hixhri nga Haxhaxhi, guvernatori Umejad. Shih Zerrkelij, *E'alem*, 3, 93.

138. Zuxhexh, *Meani'l-Kur'an*, 1, 62.

139. Sujuti, *ed-Duru Mentbur*, 4, 465. Ndërsa transmetimin e ka shënuar Bejhakiu në *Esmâ' ue Sifet*, 1, 230. E ka shënuar Hakimi në Mustedrek me numër 3405.

Dhe në disa raste shtojnë shkronja të tepërta nëse nuk priset kuptimi i fjalës.”¹⁴⁰

Konkluzione

Të gjitha qasjet rreth “El-Huruf el-Mukatta'a” (shkronjave të ndërprera) janë hulumtime të dijetarëve, parë nga këndvështrimi i tyre. Në Kur'an dhe në sunet (në traditën profetike) nuk ka argumente që tregojnë për kuptimin e tyre. Për rrjedhojë, kanë dalë në pah shume qasje të ndryshme rreth shkronjave të ndërprera dhe kuptimit që ato mbartin. “El-Huruf El-Mukatta'a” shkronjat e ndërprera janë versete të Kur'anit fisnik me të cilat Allahu ka sfiduar dëgjuesit e Kur'anit. Këto shkronja kanë kuptim dhe nuk janë vendosur rastësisht siç mendojnë orientalistët, por janë vendosur me shpallje hyjnore.

“El-Huruf El-Mukatta'a” edhe pse quhen shkronja, ato janë emra sepse lexohen me emrat e shkronjave dhe jo thjesht si shkronja.

Dijetarët klasikë deri tek Taberiu, përveç disa prej tyre, nuk i kanë dhënë ndonjë kuptim të veçantë shkronjave të ndërprera. Qasjet e tyre kanë qenë vlerësime të përgjithshme. Dijetarët klasikë të interpretimit të Kur'anit më tepër mbështesin mendimin që kuptimin e “El-Huruf mukatta'at” e di vetëm Allahu dhe ne nuk mund t'i kuptojmë apo komentojmë dot këto shkronja. Ndërsa dijetarët modern,

140. Taberi, *Xhamiu'l-Bejan*, 1, 70.

më tepër mbështesin mendimin që këto shkronja mbartin kuptim dhe mund të komentohen. Këtë qasje e ka edhe një pjesë e dijetarëve klasikë.

Qasja më e përhapur dijetarëve rreth shkronjave të ndërprera është që këto shkronja kanë ardhur si mrekulli për të treguar paarritshmërinë e Kur'anit dhe që këto shkronja janë treguese të vërtetësisë së profetësisë së Muhamedit (a.s.). Ndërsa, për sa i përket kuptimit të tyre nuk mund të bëjmë një përzgjedhje për një kuptim të caktuar, sepse kjo mund të përcaktohet vetëm me orientim hyjnor.

Edhe pse janë bërë llogaritje të shumta dhe ka pasur rezultate

të sakta, nuk ka lidhje të saktë midis shkronjave të ndërprera dhe llogaritjes “ebxhed”.

Duke qenë se Kur’ani përbëhet nga shkronja dhe fjalë, duhet treguar një kujdes i veçantë për shkronjat. Sepse këto shkronja dhe fjalë kanë formuar tekstin dhe librin hyjnor. Fakti që këto shkronja të ndërprera gjenden në Kur’an, edhe komentet që bëhen rreth tyre nuk duhet të bien ndesh me Kur’anin dhe frymën e tij të përgjithshme.

Gjithashtu, këto shkronja të zgjerojnë horizontin për hulumtime të reja rreth kuptimit të verseteve Kur’anore.

Referencat

- Abas, Fadl, *Itkanu'l-Burban fi Ulumi'l Kur'an*, Amman: Furkan viti 1997.
- Ahfesh, Ebul Hasen, *Meani'l-Kur'an li Ahfesh*, Abdul Emir Muhamed Emin, vëll. II, Daru'l-Beshir 1981.
- Alusi, Ebu Fadl Shihebudin Mahmud Sejid Mahmud, *Rubu'l-Meani fi Tefsirul-Kur'ani'l-Adhim ue Seba' Metheni*, vëll. I, Bejrut: Daru Ihjeu Turathi'l-Arabi 1985.
- Ayduz, Davud, *Huruf-I Mukattaa*, revista "Yeni Umit", Stamboll, nr. 76, 2006.
- Begau, Ferra, *Tefsiru'l-Begau (Mealimut-Tenzil)*, Rijad: Daru Tajbe, 1997.
- Bekalani, Ebu Bekr Muhamed b. Tajjib, *P'axhezul Kurr'an*, vëll. I, Bejrut: Muesetu'l-Kutubu Thekafije.
- Bejdau, Nasrudin Ebu Said Abdullah Ebu Umr b. Muhamed, *En'neru Tenzil ue Esrraru Te'nil*, Bejrut: Daru'l-Fikr viti 1996.
- Duman, Zeki, Mustafa Altundag, *El-Huruf Mukata'*, DIA, 18, Stamboll, Botim i Fondacionit të Dijanetit Turk, 1998.
- Ebu Hajen, Muhamed b. Jusuf, *el-Bahrul Muhit fi Tefsir*, Deru'l-Kutubu'l-Ilmije 2006.
- Ebu Su'ud, Mehmed, *Irshadul Akli Seli mile Mezejel Kitebil Kerim*, Bejrut: Daru'l-Ihja pa vit botimi.
- Ebu Zehra, Muhamed, Zehrratu Tefesir, Kairo: Derrul Fikr pa vit botimi.
- El-Ensarij, Ebu Jahja Zekerija, *Fet'bu Rrahman Bikeshfi me Jeltebisu fi'l Kur'an*, pa vit botimi.
- Ferra, Ebu Zekerije Jahja b. Zijed, *Meani'l Kur'an*, Bejrut: Alemu'l-Kutub, 1980.
- Gylen, Fethullah, *Kur'anin Altin Ikliminde*, Stamboll: Botimet Nil viti 2010.
- Gylen, Fethullah, *Bir P'caz Hecelemesi*, Stamboll: Botimet Nil 2014.
- Ibn Ashur, Muhamed Tahir, *et-Tebriru ue't-Tenuiru*, Tunus: Daru Sahnun, 1997.
- Ibni Atije, Muhamed Abdulkhak, *Mubararu'l-Uexhiz fi Tefsiri'l-Kitebi'l-Aziz*, Bejrut: Daru'l-Kutub, 1993.
- Ibn Kajim el-Xhezije, *et-Tibjan fi Aksemi'l-Kur'an*, Bejrut: el-Mektebetu Islami viti 1982.
- Ibn Kethir, Ebul Fide Ismail, *Tefsiru'l-Kur'ani'l-Adhim*, Rijad: Daru Tajbe, 1999.
- Ibni Mendhur, Ebul Fadl Muhamed, *Lisenu'l-Arab*, Bejrut: Daru Sadir, viti 1994.
- Ibni Tejmije, Takijudin Ahmed, *Mexhmu'u'l-Fetene*, Bejrut: Daru'l-Kutub, 2004.
- Kurtubi, Muhamed b. Ahmed, *el-Xhemiu Li'ehkemi'l-Kur'an*, Kairo: Daru Sheab.
- Kutub, Sejid, *Fi Dhileli'l-Kur'an*, Kairo: Daru Shuruk, 1980.
- Mekij, Ebu Muhamed b. Ebi Tâlib el-Kisij, *el-Umdetu fi Garribi'l Kur'an*, Bejrut: Daru Nuri'l-Islam viti 1988.
- Merragi, Ahmed Mustafa, *Tefsiru Meragi*, Kairo: Mustafa'l-Bebi'l-Halebi 1974.
- Muhamed Ebu Zehra, *Zehrratu'l-Tefesir*, Kairo: Darrul Fikr pa vit botimi.
- Nesefi, Ebul Berraket Hafidhudin Abdullah b. Ahmed, *Mederiku'l-Tenzil ue Hakaiku Te'nil*, Kairo: Daru Ihjai Turrafil Arabi.
- Razi, Ebu Abdullah Fahrudin, *Mefetihu'l-Gajb*, Bejrut: Daru'l-Kutubu'l-Ilmije viti 2000.
- Riza, Reshid, *Tefsiru'l-Menar*, Kairo: Hej'etu'l-Masrije li'l-Kuteb, 1990.
- Said Nursi, *Isherratul Ixhaz*, Stamboll: Botimet Ensar 2004.
- Said Nursi, *Mektubat*, Stamboll: Botimet Nesil, 2012.
- Sibeuejhi, Ebu Beshar Amru b. Uthmen, *el-Kiteb*, Bejrut: Daru'l-Xhelil 1967.
- Sujuti, Abdurahman b. Kemal Xhelaludin, *el-Itkan fi Ulumi'l-Kur'an*, Bejrut: Daru'l-Fikr viti 1999.
- Sharau, *Tefsiru Sharani*, Kairo: Ehbarul Jeum pa vit botimi.

Studime

- Sheukeni, Muhamed b. Ali b. Muhamed, *Fet'hu'l-Kadir*, vëll. I, Bejrut: Daru'l-Fikr viti 1993.
- Taberi, Ebu Xhaferr Muhamaed b. Xherir, *Xhemiu'l-Bejen Fi Tefsiri'l-Kur'an*, Bejrut: Daru'l-Marife 1978.
- Tantau, Muhamed, *Tefsiru'l-Uesit*, Kairo: Daru Nehde, 1997-1998.
- Tahir, Ali Nasuh, *Eneilu Su'uer fi'l-Kur'ani'l-Kerim*, Kairo 1986.
- Tusi, Ebu Xhaferr, *et-Tibjannu el-Xhami' li Ulumi'l Kur'an*, Bejrut: Daru Fikr.
- Xheuheri, Tantau, *El-Xhevuehir fi Tefsirril Kur'anil Kerim*, Bejrut, 2004.
- Yazir, Elmalili Hamdi, *Kur'an Dili*, Stamboll: Eser 1970.
- Yildirim, *Kur'an Ilimlerine Giris*, Stamboll: Ensar 1989.
- Yurdagur, Metin, Xhefr, DIA, 7, Stamboll: Botimet e Dijanetit turk 1993.
- Zemahsheri, *El-Keshaf an Hakaiki Tenzil ue Ujunnul-Ekavil fi Uxhubi Te'uul*, Bejrut: Daru'l Fikr 1983.
- Zerkeshi, Bedru Din Muhamed b. Abdullah, *el-Burrhan fi Ulumi'l-Kur'an*, Bejrut: Darul Marife 1972.
- Zerkani, Muhamed Abdul Adhim, *Menebilu'l-Irfan fi Ulumi'l Kur'an*, Bejrut: Deru'l-Kutubi'l-Ilmije 1988.

Krijimi i Ademit dhe Havasë sipas Imam Maturidiut

Dr. Osman Nuri Demir

Abstrakt

Ky artikull trajton krijimin e Ademit dhe Havasë sipas Imam Maturidiut, një nga mendimtarët më të rëndësishëm të teologjisë islame, duke u mbështetur në analizat e tij mbi ajetet kur'anore dhe konceptet e krijimit. Për Imam Maturidiun, Ademi është njeriu dhe profeti i parë, i krijuar nga një tokë e pastër dhe e përzgjedhur që ka kaluar nëpër fazat e ndryshme të përgatitjes. Ai e thekson faktin se substanca thelbësore e krijimit njerëzor është unike dhe e përshtatshme për natyrën njerëzore, duke kundërshtuar idenë se ajo mund të jetë e papastër apo e padenjë.

Maturidiu argumenton gjithashtu se krijimi i Ademit dhe Havasë bazohet në një origjinë të përbashkët, të cilën ai e quan “nefs-i vahide” (një shpirt/vetë i vetëm). Sipas tij, të gjithë njerëzit burojnë nga kjo origjinë dhe nuk ka epërsi ndërmjet burrit dhe gruas në aspektin e krijimit. Megjithatë Havaja konsiderohet gruaja e parë, Maturidiu nuk mbështet narrativat spekulative mbi krijimin e saj nga brinja e Ademit, duke u mbështetur vetëm në tekste kur'anore dhe hadithet autentike.

Artikulli ndriçon qasjen racionale të Maturidiut, i cili interpreton fazat e krijimit njerëzor, si ato materiale ashtu edhe shpirtërore, në mënyrë metaforike dhe simbolike. Ai thekson se epërsia mes njerëzve nuk buron nga krijimi i tyre, por nga veprimet dhe morali i tyre. Në përfundim, analiza e Imam Maturidiut pasqyron një këndvështrim gjithëpërfshirës dhe unik mbi natyrën njerëzore, duke hedhur poshtë dallimet gjinore si burim epërsie dhe duke përqendruar rëndësinë të barazisë dhe përgjegjësisë individuale.

Fjalë kyçe: *Imam Maturidiu, krijimi i Ademit, krijimi i Havës, nefsi vahide, teologjia islame, barazia gjinore, Kur'an, tefsir.*

KRIJIMI I ADEMIT

Ne i mësojmë mendimet e Maturidiut për krijimin e Ademit, me fjalë të tjera, qenies së parë njerëzore, falë komenteve të tij mbi ajetet përkatëse në Kur'an.¹ Në disa prej ajeteve për krijimin e njeriut² përmenden vetëm cilësitë e Ademit, ndërsa në disa të tjera emrat dhe atributet e tij. Sidoqoftë, nuk ka dallim në kuptim dhe natyrë midis këtyre emrave dhe cilësive. Përveç kësaj, është e mundur të gjesh informacion të plotë për krijimin dhe krijimin e qenies së parë njerëzore në shumë ajete të tjera.³ Kjo na jep mundësinë për t'iu

1. Në fakt, Kur'ani përmban informacion të gjerë për njerëzit dhe krijimin e tyre. Në këtë kontekst, për shembull, fjala Adem përmendet në 25 vende në Kur'an. Shih el-Bekare 31/2, 33, 34, 35, 37; Al-i Imran 33/3, 59; el-Maide 27/5; el-Araf 11/7, 19, 26, 27, 31, 35, 172; el-Isra 61/17, 70; el-Kehf 50/18; Merjem 67/19; Taha 115/20, 116, 117, 120, 121; Jasin 60/36.

2. Për shembull, ndërsa emrat dhe atributet janë përfshirë në suret Bekare, Araf, Isra, Kehf dhe Taha; Vetëm atributet e tij përmenden në suret Hixhr dhe Sa'd. Shiko el-Hixhr 33, 26/15; Sa'd 76, 71/38.

3. Shih. Al-i Imran 36, 59; en-Nisa 4/1; el-En'am 6/2, 98; el-Araf 7/11, 189; Junus 10/4; el-Hixhr 15/26-27; en-Nakhl 16/70; el-Kehf 18/37, 51; el-Enbija 21/37; el-Haxh 22/5; esh-Shu'ara 26/75-78; er-Rum 30/20, 40; Lukman 31/28; Jasin 36/20-22, 77-79; es-Saffat 37/11; ez-Zumer 39/6; el-Mu'min 40/57, 64; Fussilet 41/21, 47; esh-Shura 42/11; ez-Zukhruf 43/87; el-Xhathije 45/3-4; el-Huxhurat 49/13; el-

qasur pikëpamjeve të Maturidiut në detaje, bazuar në interpretimet e tij të ajeteve.

Çështja nëse Ademi ishte njeriu i parë është debatuar gjatë historisë. Për këtë temë janë paraqitur ide të ndryshme para dhe pas Islamit.⁴ Megjithatë, sipas Maturidiut, Ademi, i cili është "asli i insanit dhe *ebu'l-besber*"⁵, është njeriu i parë dhe profeti i parë. Me sa mund të konstatojmë, ai nuk shpreh mendim të kundërt dhe as nuk përcjell mendim të ndryshëm për këtë çështje.⁶ Në fakt, kjo situatë mund të jetë dëshmi se

Alak 96/1-2.

4. Në të kaluarën dhe sot, ka pasur nga ata që kanë mbrojtur pikëpamjen se ka pasur të tjerë Adem para Ademit. Ndoshta, shfaqja e këtyre pikëpamjeve - të cilat janë paraqitur në kundërshtim me pranimin e përgjithshëm - është ndikuar nga përdorimi i zakonshëm i fjalës "Adam" në hebraisht për "Njeriun dhe speciet njerëzore" dhe nga disa transmetime (rivajete) me autenticitet të dyshimtë. Kjo fjalë, e cila është përdorur 500 herë në Ahd-i Atik për të nënkuptuar "Llojet e Njeriut", është përdorur rrallë për të nënkuptuar njeriun ose qenien e parë njerëzore. Përveç kësaj, përdorimi i termit "khalif" për qeniet njerëzore në kontekstin e krijimit në Kur'an dhe përmendja e shprehjes "*A do të krijoni dikë në tokë që do të shkaktojë korrupsion dhe derdhje gjaku*" në lidhje me engjëjt, dhe kërkimi i pasardhësve që kanë jetuar në tokë para Ademit, bazuar në këto shprehje, mund të konsiderohen si faktorë të tjerë. Për informacion të detajuar, shihni Erdem, Hz. Âdem, fq. 118; Süleyman Hayri Bolay, "Âdem", *Türkiye Diyanet Vakfı İslâm Ansiklopedisi*, İstanbul 1988, I, 358.

5. Mâtürîdî, *Tev'îlâtü'l-Kur'ân*, V, 8; IX, 70.

6. Mâtürîdî, *Tev'îlâtü'l-Kur'ân*, I, 85, 87.

Maturidiu e shihte Ademin si njeriun e parë, dhe gjithashtu tregon se të paktën asnjë ide e kundërt nuk ishte e përhapur në atë kohë. Ndoshta, në shekullin në të cilin jetoi Maturidiu, pikëpamjet se Ademi nuk ishte njeriu i parë ose nuk ekzistonin fare, ose të paktën ato nuk ishin të një rëndësie që Maturidiu do t'i merrte në konsideratë. Për këtë arsye, tani e tutje, ne do të përdorim herë pas here termin njeriu i parë ose thjeshtë njeri (*insan*) në vend të Ademit.

Ashtu si Zoti i krijoi të gjitha qeniet në mënyrën më të bukur sipas tipit dhe llojit të tyre, po ashtu, Ai krijoi njerëzit mbi të gjitha qeniet e tjera dhe në mënyrën më të bukur si qenie njerëzore.⁷ Substanca e parë, *asÁ*, thelbi themelues i njeriut është dheu. Zoti e krijoi origjinën e njeriut, paraardhësit e tij dhe thelbin e tij nga toka ndërsa njerëzit më pas i krijoi nga sperma.⁸ Nga thënie të Imam Maturidiut, i cili shqyrtoi shprehjet në ajetet përkatëse⁹, kuptojmë se kjo substancë thelbësore e njeriut të parë nuk ishte një tokë e rastësishme, e zakonshme, e papërpunuar.¹⁰ Fakti që

shprehje të ndryshme si *turab*¹¹, *tin*¹², *tin lazib*¹³, *sulaletin min tin*¹⁴, *salsal*¹⁵, *salsalin kel fehkhar*¹⁶, *hamei mesnun*¹⁷ u zgjodhën për të shprehur dheun e përdorur si substancë thelbësore e njeriut, gjithashtu e mbështet këtë pikëpamje dhe tregon se është një tokë e veçantë.¹⁸ Kjo tokë e veçantë, e cila u zgjodh për të krijuar njerëzit, u bë e përshtatshme për t'u bërë maja për njerëzit pasi kishte kaluar nëpër faza të ndryshme.¹⁹ Sipas Maturidiut, këta emra të ndryshëm që i janë dhënë esencës njerëzore tregojnë se kjo esencë ka kaluar nëpër faza të ndryshme dhe se Allahu i drejtohet asaj në kohë të ndryshme (me emra të ndryshëm përkatës).²⁰

nuk mori papritur formën njerëzore. Pasi u krijua esenca njerëzore nga balta, ajo u nivelua për një kohë për të marrë formën njerëzore dhe për të arritur nivelin njerëzor, kaloi nëpër shumë faza të vazhdimësisë, ndryshoi nga forma në formë dhe më pas mori formën njerëzore, dhe shpirti njerëzor (*ruh'u insan*) u fry në të. Kjo është arsyeja pse ajete të ndryshme u referohen shkallëve të ndryshme të krijimit (*meratib-i bilka*).²¹ Shih Izmirli Ismail Hakki, *Yeni İlm-i Kelâm*, İstanbul: pa shtëpi botuese. 1341, I, 284 e tutje.

11. er-Rum 30/20; el-Kehf 18/37.

12. el-Isra 17/61; es-Sexhde 33/7.

13. es-Saffat 37/11.

14. el-Mu'minin 23/12.

15. el-Hixhr 15/26, 33.

16. er-Rahman 55/14.

17. el-Mu'minin 23/12.

18. Mâtürîdî, *Te'vîlâtü'l-Kur'ân*, IX, 56-57.

19. Mâtürîdî, *Te'vîlâtü'l-Kur'ân*, VIII, 24-25-26; IX, 278-279, 311-312; XII, 270.

20. Mâtürîdî, *Te'vîlâtü'l-Kur'ân*, VIII, 24-25-26, 312; X, 11; XIV, 262-263.

7. Mâtürîdî, *Te'vîlâtü'l-Kur'ân*, XI, 270.

8. Mâtürîdî, *Te'vîlâtü'l-Kur'ân*, IX, 57.

9. Shih el-Araf 7/11; el-Hixhr 15/26, 33; Sa'd 38/71, 76.

10. Mâtürîdî, *Te'vîlâtü'l-Kur'ân*, IX, 57-58. Në lidhje me këtë temë, Izmirli Ismail Hakki - një nga dijetarët e mëdhenj të kelamit të periudhës së fundit - ka pikëpamje të ngjashme me Maturidiu: "Nga ajetet në suret Araf, Hixhr dhe Sa'd kuptohet se balta, e cila është substanca e parë e njeriut,

Kjo tokë, e cila është burimi i krijimit të njeriut, është përzgjedhur dhe filtruar (pastruar) dhe është toka më e mirë për nga cilësia e saj. Është një tokë e pastër që përmban të gjitha substancat e nevojshme dhe të dobishme për natyrën njerëzore.²¹ Këtë tokë, karakteristikat e së cilës i vuri në dukje Maturidiu, mund ta quajmë në termat e sotëm “tokë organike”.²² Sipas të dhënave bashkëkohore bujqësore, struktura e tokës është tipari fizik i saj më dallues, i përhershëm dhe i pandryshueshëm.²³ Kjo veçori mund të ndryshojë dhe të përkeqësohet vetëm për një periudhë të gjatë kohore me ekspozimin e tepërt ndaj ndikimeve të jashtme dhe ndërhyrjen e kimikateve të huaja.²⁴ Ekziston një proporcion i drejtpërdrejtë midis rritjes së lëndës organike në tokë dhe rritjes së produktivitetit bujqësor.²⁵ Me fjalë të tjera, për sa kohë që ruhen vetitë thelbësore të tokës, vazhdon të arrihet efikasiteti i lartë i pritur. Në të kundërtën, efikasiteti dhe cilësia ulen.²⁶ Sipas mendimit tonë, Maturidiu vendos një lidhje midis vetive të tokës organike dhe natyrës njerëzore. Në fakt, këtë marrëdhënie do ta diskutojmë në detaje më vonë kur të diskutojmë temën e natyrës

njerëzore (*fitriah*). Sido që të jetë, duket qartë se për këtë qenie të veçantë të quajtur “insan” nuk u zgjodh asnjë esencë e zakonshme apo tokë e rastësishme. Kjo esencë, e cila u zgjodh, që prej saj të vinte njeriu, u përftua mbi të gjitha nga një tokë e pastër²⁷ dhe pjellore.²⁸ Një veçori tjetër e rëndësishme e këtij dheu, e cila thuhet në disa hadithe se është marr nga të gjitha pjesët e tokës²⁹, është se ka cilësinë e pastrimit. Në fakt, Imam Maturidiu thotë se nëse kjo tokë, të cilën ai e përshkruan si “*et-tin-i tajjib/dheu i pastër/i mirë*”, është e keqe, nuk mund të arrihet rezultati i këtyre cilësive të përsosura të quajtura njeri. Sipas tij, si dheu (*tin*) që buron nga Ademi ashtu edhe sperma (*nutfë*) që buron nga bijtë e Ademit kanë karakter pastërtie. Pretendimet e atyre që pretendojnë se esencat njerëzore të përmendura janë të pista dhe të neveritshme janë gjithashtu të pabaza.³⁰

Maturidiu pohon gjithashtu se krijimi i njeriut me materie, pra disponueshmëria e materies thelbësore, nuk mund të krijojë domosdoshmërisht njeriun.³¹ Sepse, sipas tij, Zoti mund të krijojë njerëzit ose çdo qenie tjetër me ose pa

21. Mâtürîdî, *Te'vîlâtü'l-Kur'an*, X, 11.

22. Necmettin Çepel, *Toprak İlmi*, İstanbul: İ.Ü. Orman Fak. Yay. 1988, f. 147.

23. Necmettin Çepel, *Toprak İlmi*, f. 11.

24. Necmettin Çepel, *Toprak İlmi*, f. 11.

25. Necmettin Çepel, *Toprak İlmi*, f. 149.

26. Necmettin Çepel, *Toprak İlmi*, f. 151.

27. Maturidiu me këmbëngulje thekson se toka dhe sperma nga të cilat janë krijuar njerëzit janë *tajjib*/të pastra. Shih *Te'vîlâtü'l-Kur'an*, VIII, 25.

28. Mâtürîdî, *Te'vîlâtü'l-Kur'an*, VIII, 25.

29. Ebu Davud, *Sunnet*, 16.

30. Mâtürîdî, *Te'vîlâtü'l-Kur'an*, VIII, 25.

31. Mâtürîdî, *Te'vîlâtü'l-Kur'an*, VIII, 25.

materie ashtu siç dëshiron. Në fakt, të gjitha këto shprehje në kontekstin e krijimit njerëzor mund të jenë edhe simbolike (*temthil*). Megjithatë, Zoti e përshkruan çështjen në një mënyrë që njerëzit mund ta kuptojnë për të treguar se si Ai krijoi.³²

Pohimi i Maturidiut se shprehjet për krijimin e njeriut mund të jenë simbolike është një qasje shumë origjinale. Madje, me këtë qëndrim ai vë në dukje edhe pavlefshmërinë e disa debateve të panevojshme të bëra për problemin e krijimit të njeriut. Sepse pika kryesore që duhet theksuar këtu është se qeniet njerëzore dhe të gjitha qeniet janë krijuar nga hiçi, domethënë nga asgjëja, nga një Zot që është i aftë të krijojë gjëra me ose pa lëndë. Çështjet e tjera përveç kësaj janë detaje dhe mund të dihen vetëm me njoftimin (*kehaber*) e Zotit.³³

Në botë, tokat që janë joefikase dhe nuk kanë veçoritë e nevojshme nuk mund të përdoren për qëllime të caktuara. Nëse materiali kryesor i përdorur si tokë nuk ka vetitë e kërkuara, ai nuk mund të përdoret në asnjë mënyrë. Kultura e prituri nuk mund të korret duke mbjellë farat e dëshiruara në të dhe nuk mund të ndërtohen shtëpi dhe ndërtesa të sigurta me të. Po kështu, ajo tokë nuk mund të kultivojë as të mbjella dhe as të bëjë vegla prej saj për nevojat e njerëzve. Situata nuk do të

kishte ndryshuar edhe nëse ajo tokë do të lihej të fermentohej për një kohë të gjatë. Për shkak se cilësitë e saj nuk ishin të përshtatshme, ajo nuk mund të arrinte në këtë fazë dhe nuk mund të arrihej rezultati i dëshiruar.³⁴ Siç e kemi thënë edhe më parë, me këto pohime, Imam Maturidiu nuk i lë asnjë derë të hapur idesë së vetëformimit dhe shfaqjes së ekzistencës domosdoshmërisht me formimin e kushteve.

Siç e përmendëm më lart; Maturidiu shpreh mundësinë që fazat e krijimit të njeriut të përshkruara në Kur'an të jenë metaforike (*mexbaz*).³⁵ Megjithatë, ai në pjesë të ndryshme të tefsirit të tij *Te'vilat* diskuton në detaje se si këto faza duhet të kuptohen nëse janë të vërteta.³⁶ Tani e tutje, ne do të ndjekim kuptimet e

34. Mâtürîdî, *Te'vilâtü'l-Kur'an*, VIII, 25.

35. Për aq sa mund të përcaktojmë, Imam Maturidiu nuk bën ndonjë zgjedhje nëse transmetimet në fjalë janë të vërteta apo metaforike, dhe ajetet në fjalë i interpreton duke marrë parasysh të dyja mundësitë. Natyrisht, këtu bëhet e nevojshme të theksohen të dyja qëndrimet. Pa dyshim, mungesa e zgjedhjes së Maturidiut nëse ato janë *bakika* apo *mexbaz* mund të shihet si një kontradiktë. Por duhet theksuar gjithashtu se, si kërkesë e sistemit që ndjek, ai përgjithësisht nuk lidhet pas një shprehje të caktuar për çështje që nuk kanë një tekst përfundimtar ose nuk janë racionalisht të qëndrueshme.

36. Mâtürîdî, *Te'vilâtü'l-Kur'an*, VIII, 24-25-26; *Te'vilâtü'l-Kur'an*, IX, 278-279, 311-312; Mâtürîdî, *Te'vilâtü'l-Kur'an*, X, 11; *Te'vilâtü'l-Kur'an*, XII, 270; *Te'vilâtü'l-Kur'an*, XIV, 262-263.

32. Mâtürîdî, *Te'vilâtü'l-Kur'an*, VIII, 25.

33. Mâtürîdî, *Te'vilâtü'l-Kur'an*, I, 103-104.

dhëna nga Maturidiu për shprehjet e përmendura për të përshkruar fazat e njeriut duke u bërë njeri, nëpërmjet veprës së tij *Te'vilat*.³⁷

Zoti flet për gjendje të ndryshme në krijimin e njeriut. Për shembull, Ai deklaroi se Ai e krijoi njeriun nga “turab”, që do të thotë tokë e thatë në të cilën nuk është derdhur ujë. Pastaj përmend se e ka krijuar nga “tin”, pra nga dheu që është kthyer në brumë duke derdhur ujë mbi të. Në rastin e “tin lazib”³⁸, që konsiderohet ndër fazat e krijimit të njeriut, ky brumë u bë ngjitës dhe mund të ngjitej me dorë. Sipas një shprehjeje tjetër të Imam Maturidiut, tani ishte bërë një gëlqere e pastër. Më pas ky “tin” u kthye në “sulale min tin”. Me fjalë të tjera, ishte bërë toka më cilësore e filtruar dhe e pastruar nga të gjitha dherat.³⁹ Kjo maja, e cila mund të formohej dhe ngjitej, u errësua si pasojë e pritjes së gjatë⁴⁰ dhe mori një formë tjetër,

37. Përzgjedhjes së Maturidiut do t'i kushtojmë vëmendje sipas renditjes së fazave. Sepse, sipas tij, ka mundësi që këta emra të përbëhen nga faza të njëpasnjëshme nëpër të cilat kalon dheu. Shih *Te'vilâtü'l-Kur'an*, XIV, 262.

38. Sepse është toka më cilësore dhe më e ngrohtë. Shih *Te'vilâtü'l-Kur'an*, XIV, 262.

39. Mâtürîdî, *Te'vilâtü'l-Kur'an*, VIII, 27.

40. Gjatë interpretimit të ajetit të parë të sures Insan, Maturidiu pohon se një nga kuptimet e periudhës së gjatë kohore që thuhet se ka kaluar para qenieve njerëzore mund t'i referohet kësaj periudhe pritjeje para krijimit. Shih *Te'vilâtü'l-Kur'an*, XVI, 314-315.

duke u bërë “hamei mesnun”⁴¹. Më pas u bë “salsal”⁴², i cili lëshon një tingull kur lëviz dhe i ngjan “fehkharr”⁴³ (që pëlçet kur thahet).⁴⁴ Arsyeja pse quhet “fehkharr” është se është kthyer në këtë gjendje për arsye të tilla si tharja, çarja, ngurtësia në thelb apo pritja e gjatë.⁴⁵

Thelbi që do të përbëjë bazën e strukturës materiale të njeriut është tashmë gati. Por thelbi njerëzor nuk përbëhet vetëm nga materia. Me fjalë të tjera, ajo që i bën njerëzit njerëzor nuk është vetëm substanca e tyre. Në fakt, sipas Imam Maturidiut, asnjë nga këto faza nuk nënkupton një qenie plotësisht njerëzore dhe ato ende nuk janë të përshtatshme për t'u quajtur plotësisht insan. Nuk ka asnjë gjurmë të qenies apo racës njerëzore në to. Në fakt, në këto faza, fuqia e Zotit bëhet

41. Tani ishte bërë e zezë dhe – sipas disave – filloi të merrte erë. Shiko *Te'vilâtü'l-Kur'an*, XIV, 262. Përveç kësaj, Maturidiu thotë se të qenit *mesnun* do të thotë gjithashtu se qeniet njerëzore që do të vijnë pas kësaj origjine do të krijohen në të njëjtin rend dhe karakteristika. Shiko *Te'vilâtü'l-Kur'an*, VIII, 27.

42. Mâtürîdî, *Te'vilâtü'l-Kur'an*, XIV, 262.

43. Kishte filluar të bënte zhurmë për shkak të zbutjes së tepërt dhe cilësisë së përbërjes. Shiko *Te'vilâtü'l-Kur'an*, XIV, 262. Në fakt, kjo situatë mund të jetë një pararojë e kësaj karakteristike të njeriut, i cili ka veçorinë e të qenit një krijesë që flet - siç do ta shpjegojmë më vonë.

44. Mâtürîdî, *Te'vilâtü'l-Kur'an*, VIII, 24-25-26; IX, 278-279, 311-312; X, 11; XII, 270; XIV, 262-263.

45. Mâtürîdî, *Te'vilâtü'l-Kur'an*, XIV, 262.

më e dukshme.⁴⁶ Sepse Ai kështu deklaroi se Ai është Krijuesi, me ose pa materie, dhe tregon se edhe nëse kushtet materiale janë gati, asgjë nuk mund të vijë në ekzistencë (*vuxhud*) ose të vijë në jetë nga mosekzistenca pa krijimin e Tij. Megjithëse Zoti ia atribuoi njerëzimin dheut ose spermës, Ai nuk na krijoi nga dheu ose sperma, as nga ndryshimet që ndodhin me to.⁴⁷ Atribuimi i qenieve njerëzore atyre, vetëm tregon se Zoti i ka zgjedhur këto esenca si origjinën, thelbin ose formën e tyre. Në fakt, paskajorja e krijimit⁴⁸ në etimologji do të thotë: të vlerësosh⁴⁹, që tregon se Zoti i ka vlerësuar këto origjina si një formë, trup fizik⁵⁰ për qeniet njerëzore.⁵¹

Kur përbërja për krijimin e njeriut u bë gati, ishte koha që ato të rregullohen⁵², domethënë të përsosen.⁵³ Nivelimin e njeriut, Maturidiu e shpjegon si sigurimin

e kërkesave të urtësisë dhe dobive të të qenit njeri. Me fjalë të tjera, shkallëzimi i tij është dizajni i ekzistencës së tij në një mënyrë që tregon njohjen e Krijuesit të tij. Po kështu, formimi i duarve, këmbëve, veshëve, syve dhe gjymtyrëve të tij, të cilat janë dimensionet e dukshme të ekzistencës së tij fizike, është e barabartë me shprehjen e nivelit të dimensionit të dukshëm të qenies njerëzore, domethënë të trupit të tij.⁵⁴ Në këtë dimension të dukshëm të tij, rëndësi i kushtohej rendit, disiplinës dhe estetikës dhe në këtë kuadër u krye edhe procesi i nivelimit të pamjes së jashtme të tij.⁵⁵ Kështu njeriu më në fund ishte gati të pranonte “jetën/hajat”.

Për aq sa mund të përcaktojmë, pikëpamjet e Maturidit për “nivelimin” janë gjithashtu origjinale. Sepse në përgjithësi, koncepti i “nivelimit” kuptohet vetëm në mënyrën e formësimit të trupit material. Për shembull, Taberiu, i cili mund të konsiderohet si bashkëkohës i Maturidit, dhe Zemahsheri (vd. 538/1144) në veprën *el-Keshshaf*, që ishte burimi i komenteve të shkruara pas tij, e shpjegoi “nivelimin” si rregullim të materialit trupor.⁵⁶ Edhe në veprat që trajtojnë këtë temë në kohët

46. Mâtürîdî, *Te'vîlâtü'l-Kur'ân*, VIII, 25.

47. Mâtürîdî, *Te'vîlâtü'l-Kur'ân*, XI, 168-169.

48. “التخليق”

49. “التقدير”

50. E kemi thënë më parë se Maturidiu herë pas here e përdorte këtë koncept në kuptimin e substancës thelbësore të ekzistencës. Në kuptimin e substancës thelbësore të njeriut, ai përdor termin “tijnet” së bashku me konceptin “asl”. Për konceptet e *tijneht* dhe *asht*, shih. Mâtürîdî, *Kitâbü'l-Tevhîd*, f. 51, 52, 96, 97, 98, 99, 103, 135, 174, 184, 185, 187, 224.

51. Mâtürîdî, *Te'vîlâtü'l-Kur'ân*, XI, 169.

52. el-Hixhr 15/29; el-Infitar 82/7.

53. Mâtürîdî, *Te'vîlâtü'l-Kur'ân*, VIII, 28; XVII, 90-91.

54. Mâtürîdî, *Te'vîlâtü'l-Kur'ân*, XVII, 91.

55. Mâtürîdî, *Te'vîlâtü'l-Kur'ân*, XVII, 91.

56. Taberi, *Xhemi'u'l-Bejan*, IV, 478, V, 102; Zemahsheri, *Tefsiru'l-Keshshaf*, Beirut: Daru'l-Marife 1430/2009, f. 560, 620.

moderne, qasja e Maturidiut në shpjegimin e “nivelimit” nuk është dominuese.⁵⁷ Siç mund të kuptohet nga thëniet që kemi cituar më lart, Maturidiu e përkufizoi konceptin e “nivelimit” si përgatitje e një njeriu për të realizuar humanitetin e tij dhe për t’u bërë njeri.⁵⁸ Allahu e ka niveluar, rregulluar dhe kompletuar krijimin e njeriut, materialin e të cilit e ka përgatitur, si trupin e tij, që është dimensionin e dukshëm, ashtu edhe botën e tij të brendshme, në atë mënyrë që ai të mund të njohë veten dhe Krijuesin e tij; të mësojë atë që ai nuk e njeh, dhe që e kupton njerëzillëkun dhe qëllimin e krijimit të tij. Njeriu tani ka arritur karakteristikat që i lejojnë të perceptojë ekzistencën dhe krijuesin e tij në botën e tij të brendshme, dhe ai ka mjetet për të fituar informacionin që do të jetë burimi i njohjes, mësimin dhe realizimin me organet e tij të niveluara në dimensionin e dukshëm të trupit të tij, gjymtyrët dhe organet shqisore të trupit të tij. Kështu, ai, është gati për

frymën e asaj që do ta sjellë në jetë, domethënë shpirtin (*ruh*).

Më në fund, ka filluar faza e fryrjes në këtë qenie madhështore gjënë (*shej*) me anë të së cilës marrin jetë format dhe trupat, pra shpirti. Allahu, i cili e rregulloi njeriun dhe e përfundoi krijimin e tij në atë mënyrë që e bëri atë të aftë për të qenë njeri, i fryu shpirtin trupit⁵⁹ që e krijoi për t’i dhënë gjallëri, ose thënë me fjalët e Imam Maturidiut: ai u dha jetë njerëzve.⁶⁰ Me krijimin e gjësë në trupin e tij që i jep jetë, njeriu tani ka fituar vitalitetin dhe trupi dhe të gjitha organet e tij kanë arritur qëndrueshmëri dhe funksionalitet. Shpirti që përfshihet në trup, siç shpjegon Maturidiu, filloi të përhapet në të po aq shpejt sa era dhe i bëri të gjitha pjesët e tij të gatshëm për veprim dhe të disponueshëm për të kryer funksionet e tyre.⁶¹ Sipas fjalëve të Maturidiut, “me plotësimin e shpirtit, kuptimi i njerëzimit është kompletuar gjithashtu”, pra, qeniet njerëzore, veçanërisht paraardhësit e njerëzimit, janë pajisur me ekzistencë dhe jetë⁶² dhe janë bërë një qenie që ia vlen të përmendet.

KRIJIMI I HAVASË

Nga e kaluara në të tashmen, diskutimet për krijimin e Havasë

57. A. Cressy Morrison, *İnsan Evren ve Ötesi* (prkth. Bekir Topaloğlu), İstanbul: Ensar Neşriyat 2010, fq. 50; İbrahim Sarı, *Yaratılış*, Antalya: Nokta Kitap 2016, f. 27. Elmalılı Hamdi Yazır, një nga komentuesit e rëndësishëm të periudhës së fundit, e interpreton konceptin e nivelimit me fjalinë e shkurtër vijuese: “Nivelizim, duke e kthyer atë baltë në një krijim të plotë njerëzor, një konsistencë të rregullt njerëzore”. shih. Elmalılı, *Tefsir*, V, 3062.

58. Mâtürîdî, *Te’vîlâtü’l-Kur’ân*, XVII, 91.

59. el-Hixhr 15/29.

60. Mâtürîdî, *Te’vîlâtü’l-Kur’ân*, VIII, 28; XVII, 90-91.

61. Mâtürîdî, *Te’vîlâtü’l-Kur’ân*, XV, 280.

62. Mâtürîdî, *Te’vîlâtü’l-Kur’ân*, VI, 105.

dhe për rrjedhojë të grave kanë arritur në një nivel që e tejkalon diskutimin mbi krijimin e njeriut. Në fakt, pikëpamja e Islamit për gratë shpesh është përpjekur të bazohet në këtë fenomen të parë. Vlerësimet e gabuara të bëra këtu kanë çuar në keqkuptime të ndryshme për njerëzit në përgjithësi dhe gratë në veçanti.⁶³ Në këtë pikë, idetë e Imam Maturidiut për krijimin e gruas marrin më shumë rëndësi. Sepse ai ofron një këndvështrim origjinal duke i konsideruar qeniet njerëzore jo mbi gjininë, por mbi bazën e krijimit, edhe në një kohë kur një debat i tillë ndoshta nuk ka ekzistuar. Kuptohet se ai e ka mbajtur këtë perspektiv edhe gjatë interpretimit të ajeteve⁶⁴ për krijimin e gruas.

Pikëpamjet e Imam Maturidiut padyshim që do të gjenden në shpjegimet e tij për ajetet në këtë temë. Megjithatë, përkundër ekzistencës

63. Për më shumë shih. Cemal Ağırman, *Kadının Yaratılışı İlgili Rivayetler Bağlamında Yeni Bir Yaklaşım*, İstanbul: Rağbet Yayınları 2001, f. 204-205; Talip Özdeş, “Mâtürîdî'nin Yorumlarında İnsan Olgusuna Yaklaşımı”, *Uluğ Bir Çınar Uluslararası İmam Mâtürîdî Sempozyum Tebliğler Kitabı* (prg. Ahmet Kartal), İstanbul: Ofis Yayın Matbaacılık 2014, f. 683; Hatice Kelpetin Arpaguş, “Kur’ân Perspektifinden Yaratılış İtibarıyla Kadına Bakış”, *Tarihden Günümüze Kur’ân’a Yaklaşımlar* (ed. Bilal Gökür e të tjerë), İstanbul: Özkan Matbaacılık 2010, f. 590 e tutje.

64. en-Nisa 4/1; el-Araf 7/189; ez-Zumer 39/6; el-En’am 6/98; en-Nakhl 16/72; er-Rum 30/21; es-Shura 42/11.

së një tregimi të detajuar të krijimit të Ademit, qenies së parë njerëzore dhe profetit⁶⁵ të parë, në Kur’anin e Shenjtë, nuk është e njëjta gjë për krijimin e Havasë. Stili i detajuar i rrëfimit të zgjedhur në krijimin e njeriut të parë zëvendësohet në këtë rast me shprehje shumë të shkurtra, madje edhe me përemra.⁶⁶ Kjo mund të jetë për arsye të tilla si mungesa e dallimeve në fazat e krijimit të burrit dhe gruas së parë si dhe për faktin se në shumë ajete që lidhen me krijimin, veçanërisht në rastin e Ademit, fjala “adem” i referohet “qenieve njerëzore”⁶⁷ në përgjithësi.

Emri i Havasë, e cila fitoi famë si gruaja e parë e krijuar, nuk përmendet në mënyrë të qartë në Kur’an.⁶⁸ Megjithatë, thuhet në tekstet e shenjta hebraike dhe të krishtera dhe në literaturën islame, përveç Kur’anit, se emri i gruas së parë të krijuar dhe gruas së qenies së parë njerëzore ishte “Havva”.⁶⁹ Imam Maturidiu gjithashtu bëri shpjegime për Havanë dhe krijimin e saj në pjesë të ndryshme të *Te’vilat-it* dhe pohoi se emri i gruas së parë

65. Mâtürîdî, *Te’vilâtü'l-Kur’ân*, IX, 244.

66. en-Nisa 4/1; el-Araf 7/189; ez-Zumer 39/6; el-En’am 6/98; en-Nakhl 16/72; er-Rum 30/21; es-Shura 42/11.

67. Mâtürîdî, *Te’vilâtü'l-Kur’ân*, IV, 119; VII, 185, 326.

68. Ömer Faruk Harman, “Havvâ”, *Türkiye Diyanet Vakfı İslâm Ansiklopedisi*, İstanbul 1997, XVI, 542-545.

69. Harman, “Havvâ”, f. 543-544.

të krijuar ishte “Havva”.⁷⁰ Maturidiu nuk ka shprehur mendim të kundërt dhe as nuk ka përfshirë ndonjë diskutim për emrin e gruas së parë të krijuar. Kjo tregon se ka mbështetje të gjerë (*tevatür*) për emrin “Havva”. Për këtë arsye, e pamë të udhës të përmendim gruan e parë me këtë emër në tekst dhe titujt përkatës. Në fakt, Maturidiu, në teorinë e krijimit, ose më saktë në problemin e krijimit të njeriut; e bën Havanë, njëren nga dy shtyllat e çështjes, po aq të dukshme sa edhe shtyllën tjetër, Ademin. Ndërsa e bën këtë, të vetmet elemente që ai referon janë ajetet përkatëse.

Në fakt, referimi i Maturidiut në tekste (*nas*) për këtë çështje është një rezultat i natyrshëm i këndvështrimit të tij epistemik. Sepse, sipas tij, njohja e çështjes thelbësore (*ash*) të gjithçkaje të krijuar është e mundur vetëm përmes transmetimit (*nakl*). Sepse nuk është e mundur të merret njohuri për një temë të bazuar në lajme (*khabër*) duke mos përdorur as të dhëna shqisore dhe as arsyen (*akl*).⁷¹ Prandaj, tekstet përkatëse duhet të merren si bazë për të formuar opinione në këtë fushë. Kjo qasje themelore e Maturidiut shihet edhe në komentet e tij për krijimin

e Ademit dhe Havasë dhe përbërjen thelbësore të tyre që ishte objekt i krijimit të tyre. Sepse, kur bën një vlerësim, ai vepron vetëm në kuadër të mundësive që i japin tekstet dhe rregullat gjuhësore përkatëse. Prandaj, për njeriun, krijimi i të cilit përfundoi, një bashkëshort i të njëjtit lloj u krijua nga e njëjta origjinë, pra nga thelbi i parë nga i cili u krijua.⁷² Si të gjithë njerëzit e tjerë të quajtur bijë të Ademit, Hava lindi po në atë thelb të parë, *nefsul-vahide*, nga i cili u krijua burri i saj, domethënë Ademi. Me fjalë të tjera, i atribuohet thelbit të njerëzimit.⁷³ Maturidiu përmend tre forma në krijimin e njeriut. Kështu, njerëzit erdhën në jetë ose drejtpërdrejt nga ajo origjinë⁷⁴ nga e cila u krijuan burri i parë dhe gruaja e tij, ose sipas sistemit të krijimit në botë nëpërmjet pasardhësve (sojit) të tyre, ose nëpërmjet një forme të ndryshme krijimi, përveç dy krijimeve të para, si p.sh. krijimi i Isait (a.s).⁷⁵ Zoti e krijoi Ademin nga toka, më pas Ai i dha jetë gruas së tij nga kjo origjinë nga e cila e krijoi atë. Pastaj, Ai dërgoi Ademin dhe gruan e tij në botë për të qenë burimi i brezit njerëzor që do të krijonte.⁷⁶

72. Mâtürîdî, *Te'vilâtu'l-Kur'an*, VI, 136; XII, 300-301.

73. Mâtürîdî, *Te'vilâtu'l-Kur'an*, IV, 198; IX, 206; XI, 168; XII, 300-301.

74. Mâtürîdî, *Te'vilâtu'l-Kur'an*, VI, 136 e tutje.

75. Mâtürîdî, *Te'vilâtu'l-Kur'an*, V, 8.

76. Mâtürîdî, *Te'vilâtu'l-Kur'an*, III, 7 e tutje.; IV, 198-199.

70. Për më tepër shih. Mâtürîdî, *Te'vilâtu'l-Kur'an*, I, 89, 90, 91, 104; IV, 119, 121, 123; V, 309, 317; VI, 136-139; VII, 120, 302, 508; XI, 170, 351; XII, 16; XIII, 171; XIV, 76; XV, 45.

71. Mâtürîdî, *Te'vilâtu'l-Kur'an*, I, 103-104.

Duke thënë se Imam Maturidiu bëri komente bazuar në tekste kur'anore dhe hadithe nuk do të thotë se ai nuk ishte i vetëdijshëm për diskutimet dhe idetë e parashtruara në periudhën e tij ose në periudhat para tij në kontekstin e krijimit të gruas. Përkundrazi, vlerësimet dhe citimet e tij gjatë shpjegimit të temës tregojnë qartë se ai është i vetëdijshëm për informacionet e transmetuara, qofshin ato Israilijate apo ato që nuk kishin të bënin me Kur'anin. Megjithatë, për shkak të parimit të interpretimit racional të përqendruar në transmetimin që përmendëm më lart, dhe me një zgjedhje të vetëdijshme, ndryshe nga shumë studiues që ishin bashkëkohës apo pasardhës të tij, ai zgjodhi të mos shkonte përtej teksteve dhe të mos përdorte Israilijate kur komentonte këtë subjekt.

Me sa kuptojmë, shprehjen “nefs-i vahide”⁷⁷ në ajetet për krijimin, Maturidiu e interpreton në dy mënyra. Në të parën, *nefs vahide* është vetë Ademi, domethënë *nefs-i vetja* i tij⁷⁸, dhe i dyti është origjina e parë, thelbi i parë nga i cili u krijuan Ademi, Havaja dhe të gjithë njerëzit.⁷⁹

77. Për më shumë të dhëna rreth shprehjes *nefs-i vahide* shih. Züleyha Birinci, “Nefs-i Vâhîde İfadesinden Hareketle Kadının Yarattığı Hakkında Bir Değerlendirme”, *MÜİF Dergisi*, XXXXVII, (2014), fq. 151-164.

78. Mâturîdî, *Te'vîlâtü'l-Kur'ân*, VI, 137.

79. Mâturîdî, *Te'vîlâtü'l-Kur'ân*, III, 8; V, 298;

VI, 136-139; IX, 57; XI, 169; XII, 127 vd.;

Po kështu, ajo që nënkuptohet me “nefs”, që përmendet duke përdorur përemrin femëror në ajete, është ose Ademi, pra vetja/shpirti i tij, ose origjina e parë, pra thelbi njerëzor nga i cili është krijuar.⁸⁰ Përveç kësaj, bazuar në pohimet e Maturidiut, është e mundur të përfundohet se këto raporte mund të jenë përdorur në një kuptim metaforik. Me fjalë të tjera, të gjitha këto shprehje në kontekstin e krijimit njerëzor mund të jenë edhe simbolike. Duke qenë kështu, do të jetë e nevojshme të shikohen çështjet e përfshira në Kur'an në kontekstin e krijimit të Ademit dhe Havasë si pjesë e një narrative metaforike. Me këtë përcaktim origjinal, Maturidiu thekson se Allahu nuk ka nevojë për materien, thelbin dhe fazat për të krijuar diçka. Prandaj, Zoti nuk ka nevojë për ndonjë material ose kohë për të krijuar Ademin, Havanë ose ndonjë qenie tjetër. Megjithatë, me një shpjegim të tillë, Zoti ndoshta i tregon njerëzimit se si e krijoi atë duke e përshkruar atë në një mënyrë që qeniet njerëzore mund ta kuptojnë.⁸¹ Po kështu, ai shpjegon në këtë mënyrë lidhjen e qenieve njerëzore ndaj Ademit ose tokës dhe thotë:

“Vetëm për shkak se i atribuohemi Ademit nuk do të thotë

XIII, 171.

80. Mâturîdî, *Te'vîlâtü'l-Kur'ân*, III, 8; V, 298; VII, 195; IX, 57; XI, 169; XII, 127 vd.; XIII, 171.

81. Mâturîdî, *Te'vîlâtü'l-Kur'ân*, VIII, 25.

nga një esencë e vetme njerëzore, nga e cila burrat dhe gratë do të krijohen nga lloji i tyre. Mendojmë se edhe përdorimet e konceptit të origjinës (*asl*) nga Imam Maturidiu, të cilin do ta përfshijmë më poshtë, e mbështesin këtë pikëpamje.

Imam Maturidiu ajetin “*Ai (Allahu) është Ai që ju krijoi prej një vete [min nefsin], e prej saj Ai krijoi bashkëshortën e tij për t’u qetësuar pranë saj.*”⁸⁹ e shpjegon⁹⁰ duke cituar ajetin “*Një nga argumentet e ekzistencës së Tij është se Ai krijon bashkëshortë nga lloji juaj [min enfusekum].*”⁹¹. Prandaj, *nefs-i vahide* është *nefsi* i Ademit. Allahu krijoi edhe Havanë, edhe të gjitha çiftet që do të vijnë në jetë nga ky *nefs*, pra nga esenca e parë. Ademi u krijua nga *nefs-i vahide* dhe Hava u krijua nga lloji dhe forma e këtij *nefsi*. Kuptohet se *nefs* këtu do të thotë gjini, specie, formë.⁹² Në një vend tjetër, Maturidiu e përshkruan Ademin dhe Havanë si esencën burimore, nga e cila u krijuan njerëzit.⁹³ Pohimet e Maturidiut

89. el-A’raf 7/189.

90. er-Rum 30/21.

91. Mâtürîdî, *Te’vîlâtul’-Kur’an*, VI, 136 e tutje.

92. “خلق لكم من أنفسكم أزواجا أي من أجناسكم و أشكالكم [kbalaka lekum min ‘enfusikum ezveçben ej min ‘exhnesikum ve ‘eshkelikum]” shih. Mâtürîdî, *Te’vîlâtul’-Kur’an*, XI, 170.

93. Mâtürîdî, *Te’vîlâtul’-Kur’an*, XIII, 171. Me shprehjen “لأنهما الأصل/‘li’ennehume’l-‘asl”, Maturidiu i përshkruan Ademin dhe Havën si “asl/originë”, domethënë thelbin. Ai e mbështet këtë ide duke thënë se të gjithë

këtu mund t’i interpretojmë si vijon: Allahu krijoi Ademin dhe Havanë si dy origjina dhe ia atribuoi të gjitha çiftet meshkuj dhe femra këtyre dy origjinave. Përsëri, me fjalët e tij: “Të gjithë burrat mund të jenë krijuar nga origjina e tyre, Ademi, dhe të gjitha gratë mund të jenë krijuar nga origjina e tyre, Hava.”⁹⁴ Në këtë pikë, do të ishte e përshtatshme të shohim se çfarë kuptimi i jepet termit “asl/originë” në terminologjinë Maturidiut. Sepse fjala “asl” është një term i veçantë që ai përdor në lidhje me krijimin e njeriut. Shohim se Maturidiu ndonjëherë përdor termin “tijnet”, të cilin në përgjithësi e përdor për të nënkuptuar thelbin e gjithësisë, për të nënkuptuar thelbin e njeriut.⁹⁵ Megjithatë, ai preferon që fjala “asl” të nënkuptojë në mënyrë specifike “thelbin” nga i cili u krijuan qeniet njerëzore.⁹⁶ Për këtë arsye, përdorimi i konceptit të “aslit” për Havanë nga ana e tij ngjall idenë se ajo, ashtu si Ademi, mund të jetë një esencë e krijuar për gratë nga toka. Mund të themi

jemi krijuar nga kjo origjinë. Shih. Mâtürîdî, *Te’vîlâtul’-Kur’an*, VI, 137. Përveç kësaj, Maturidiu përmend se në ajetin 36 të sures Al-i Imran, ku përmenden pasardhësit e Merjemes, ka një tregues se edhe burrat kanë prejardhje nga gratë, pra nga i njëjti soj. Shih. Mâtürîdî, *Te’vîlâtul’-Kur’an*, II, 293.

94. Mâtürîdî, *Te’vîlâtul’-Kur’an*, VI, 136 e tutje.

95. Mâtürîdî, *Te’vîlâtul’-Kur’an*, XI, 169.

96. Mâtürîdî, *Te’vîlâtul’-Kur’an*, III, 8; V, 298; VI, 136-139; IX, 57; XI, 169; XII, 127 vd.; XIII, 171.

se pikëpamja e Maturidiut për këtë çështje është pjesërisht në përputhje me idetë e bashkëkohësit të tij Ebu Muslim Isfahani (vd. 322/934).⁹⁷ Sipas Isfahanit, Allahu i krijoi të gjithë njerëzit nga esenca me të cilën krijoi Ademin. Në fakt, nuk ka asnjë arsye që Zoti, i cili krijoi Ademin nga asgjëja, nuk duhet ta krijojë Havanë në të njëjtën mënyrë.⁹⁸ Mund të thuhet se këto ide të shprehura qartë nga Isfahani dhe gjërat që thotë Maturidiu mes rreshtave - edhe pse jo me të njëjtën qartësi - tregojnë të njëjtin kuptim.

Si përfundim, mund të themi se sipas Maturidiut, marrëdhënia e Havasë me Ademin është si marrëdhënia e çdo personi tjetër me Ademin. Edhe pse *nefs-i vahide* është *nefsi* i Ademit, ai në fakt tregon thelbin nga i cili është krijuar njeriu.⁹⁹ Prandaj, Havaja duhet të jetë krijuar nga ai thelbi i parë nga i cili u krijua Ademi. Në thelb, Maturidiu thekson se të gjithë njerëzit bazohen në Ademin dhe Havanë, dhe në këtë kuptim ata janë thelbi ose origjina për njerëzit e tjerë, por çështjen e krijimit

97. Fakhreddin er-Razi, *Mefatihu'l-Gajb*, Bejrut: Dsru Fikr 1981, IX, 167; Arpaguş, *Kadına Bakış*, fq. 592.

98. Fakhreddin er-Razi, *Mefatihu'l-Gajb*, IX, 167.

99. Mâturîdî, *Te'vîlâtul-Kur'ân*, XIV, 76.

të Havasë e lë paksa të paqartë. Ndoshta paqartësia në Kur'anin Famëlartë është pasqyruar edhe në gjuhën e Maturidiut. Mirëpo, ajo që është e rëndësishme këtu, është se Maturidiu nuk vendos asnjë raport epërsie ndërmjet krijimit të Ademit dhe Havasë. Sepse në sistemin e tij epërsia nuk zbulohet nga krijimi, por nga veprimet. Pohimet e mëposhtme të Maturidiut gjithashtu mbështesin pikëpamjen tonë:

“Krijimi i njerëzve nga një shpirt/vete (*nefs*) i vetëm tregon se asnjë qenie njerëzore nuk ka epërsi ndaj një tjetri për sa i përket krijimit dhe thelbit me të cilin ata lidhen. Ata janë të gjithë vëllezër dhe motra të krijuar nga një *nefs* i vetëm. Nëse do të jetë një mjet për epërsi ndaj njëri-tjetrit, kjo do të ndodhë vetëm nëpërmjet veprave që do të bëjnë, moralit të lavdëruar dhe bukurive që ata zgjedhin. Megjithatë, askush nuk ka epërsi ndaj askujt tjetër në aspektin e krijimit.”¹⁰⁰

Burimi: Dr. Osman Nuri Demir, *Mâturîdî'de İnsan Tasavvuru*, Ankara: Diyanet Vakfı Yayınları, 2020.

Nga turqishtja: Haki Sahitaj

100. Mâturîdî, *Te'vîlâtul-Kur'ân*, VI, 140.

ARABËT PARA ISLAMIT

Prof. Dr. Qazim Qazimi

Abstrakt

Ky shkrim trajton jetën dhe zhvillimet e arabëve para Islamit, duke përfshirë pozicionin gjeografik, jetën fetare, kulturore, arsimore dhe shoqërore të tyre. Gadishulli Arabik, një territor kryesisht shkretnor, me pozicion strategjik tregtar, ishte vendbanimi i një popullsie nomade dhe të paorganizuar politikisht, e ndarë në fise dhe klane patriarkale. Shoqëria arabe karakterizohet nga ndarje të theksuara sociale, ku dominonin fisnikët, ndërsa sklllevërit përbënin shtresën më të ulët. Jetesa mbështetej kryesisht në blegtori dhe tregti, ndërsa kultura e tyre përfshinte poezi të lartë artistike, por një nivel të ulët arsimit dhe organizimi politik.

Fetarizmi i arabëve kaloi nga monoteizmi i Ibrahimit (a.s.) në politeizëm, me idhujtari të përhapur gjerësisht në Mekë dhe zona të tjera. Në gadishull kishte gjithashtu hebrej dhe të krishterë, por besimi dominues mbeti idhujtaria. Traditat shoqërore përfshinin mikpritjen dhe besën, por edhe praktika mizore si varrosja për së gjalli e foshnjave vajza. Ekonomikisht, tregtia e karvaneve ndihmonte në lidhjen e Arabisë me kulturat e zhvilluara si Bizanti, Persi dhe India.

Gjithashtu përfshiheshin edhe principatat e vogla arabe, si Jemeni, Tedmuri dhe Petra, që kishin ndikim të kufizuar. Këto principata shpesh ndodheshin nën ndikimin e perandorive më të mëdha, si Bizanti dhe Persia. Shkrimi konkludon se ndonëse arabët para Islamit jetonin në kushte primitive dhe të paorganizuara, shpallja e Islamit dhe ardhja e Kur'anit shënuan fillimin e transformimit të këtij populli në një qytetërim të madh dhe të përparuar.

1. POZITA GJEOGRAFIKE E GADISHULLIT ARABIK

Kalimi i një shoqërie në fazën e qytetërimit realizohet me një

shtytje të një ideje themelore që atë e fut nën analet e historisë. Faza e qytetërimit fillon me daljen në skenë të relevantes ose të mitit. Fillet e qytetërimit qëndrojnë në tre faktorë botërorë: njeriu, toka dhe koha. Kjo është tërësia e kapitalit që një popull e investon kur bën hapat e parë në histori.

Gadishulli Arabik- (جَزِيرَةُ الْعَرَبِ), që gjendet në kontinentin e Azisë, nga ku nis qytetërimi Islam, ka formën e një siujdhese, duke qenë se vetëm në anën veriore lidhet me tokë. Në lindje, këtë siujdhese nga Irani e ndan Gjiri Arabiko-Persian, ndërsa në juglindje, në jug dhe në jug-perëndim ky gadishull është i rrethuar nga Oqeani Indian. Në perëndim nga Afrika e ndan Deti i Kuq, nga veriu kufizohet me Jordaninë, Sirinë dhe një pjesë të Irakut, kurse nga veri-perëndimi me Gadishullin e Sinait dhe ka një kufi të shkurtër me Palestinën, ndërsa nga lindja me një pjesë të madhe toke të Irakut. Gjatësia e Gadishullit Arabik është rreth 1.200 km. dhe gjerësia rreth 1.000 km.¹ Ka një sipërfaqe prej 2.250.000 deri në 2.300.000 kilometra katrorë dhe llogaritet ndër gadishujt më të mëdhenj në botë.² Nga bregdeti

lindor, shtrihen vargmalet e njohura me emrin el-Hixhaz, ndërsa në jug, në Jemen gjendet bjeshka që njihet me emërtimin “Bjeshka e profetit Shuajb”, me lartësinë mbi detare 314 m.

Gjeografët arabë, Gadishullin arabik e kanë ndarë në pesë pjesë:

1. Hixhazi,
2. Tihameja,
3. Nexhdi,
4. Arudi,
5. Jemeni.

Hixhazi ishte pjesa më rëndësishme e Arabisë. Ai ka qenë vendkalim për në qendrën fetare botërore në Qabe, Mekë. Andaj Hixhazin arabët e konsideronin si krahinë të shenjtë. Meka, për arabët ka qenë kryeqendër, ku funksiononte edhe pushteti fetar edhe pushteti profan.³

Relievi i gadishullit është shkretinor, një shkretëtirë e mbuluar me rërë dhe e papërshtatshme për bujqësi, me përjashtim të disa oazave ku kultivohen disa bimë mesdhetare, siç janë; portokajtë, limonët, ullinjët, sidomos hurmat, dhe disa nga drithërat.

Klima e Gadishullit është shkretinore, me vera tepër të nxehta dhe me dimra të ftohtë, me pak reshje atmosferike. Në veri, ku reshjet atmosferike janë stinorë, janë të zhvilluara deri diku bujqësia blegtoria, si në Medinë, Jemen, Nexhd, Taif etj.

3. El-Mubarekfuri, Safijurrahman, vepra e cituar, f. 32.

1. Naxhi Ma'rufi, Dr. Salih Ahmed El-Alij, Abdullah El-Fejjad, “Terihu El-Arabi”, f. 8, Bagdad, 1966 /1386 h..

2. Gavoci, Vehbi Sulejmani, “ Muhammedi a.s. Jeta dhe Vepra”, f. 11., “Drita e Jetës”, Gjilan, 1997.

Prania më e hershme e popullsisë arabe përmendet nga shkrimet asiriane dhe babilonase. Në shekullin IX para erës sonë, ata përmendeshin me emrat Aribi, Arubu sipas gjuhës akadiane (gjuhë e vdekur me shkrim kuneiform prej së cilës e kanë origjinën gjuha babilonase dhe gjuha asirase) dhe arab sipas gjuhës hebraike. Origjina e emrit nuk dihet me saktësi. Disa dijetarë kanë menduar se ky emër vjen nga emri *arabab* që në gjuhën hebraike nënkupton shkretëtirën në jug të Detit të Vdekur.

Para shpalljes së Islamit (viti 600 i erës sonë) arabët ishin një popullsi nomade, jetonin me blegtori, me rritjen e deveve, bënin tregti me karvane, të grupuar në fise e klane patriarkale me nivel qytetërimi shumë të ulët. Gadishulli Arabik ku banonte popullsia ishte një vend i shkretë vullkanik ku nuk kishte kushte për zhvillimin e bujqësisë e cila ishte e zhvilluar vetëm në zonat e oazeve.

Pjesa dërmuese e popullatës merrej me blegtori; deve, kuaj, dhen, dhi, dhe prej tyre shfrytëzohej mishi, lëkura, leshi, qumështi etj. Popullsia fshatare përveç prodhimeve bujqësore dhe blegtorale, merrej edhe me disa punë manufakturale.

Kishte prej arabëve të asaj kohe që merreshin me prodhimin e kripës, por edhe me përpunimin e hekurit. Sipas Ibni Mendhurit, El-Halik b. Esad Huzejmeja ishte i pari i cili

filloi të merrej me farkimin e hekurit në gadishullin arabik. Të njohura u bënë shigjetat jethribase (medinase). Në mesin e tyre ushtroheshin dhe u bënë të njohura edhe disa zeje si: rrobaqepës, lëkurëpunues, verëprodhues, farkëtar, artar, zdrukthëtar, prodhues të tullave, vorbëtar etj. Gratë arabe tjerrnin lesh dhe thurnin veshmbathje për nevoja familjare dhe të luftëtarëve, por edhe pëlhura për ngritjen e tendave-çadrave. Një pjesë e elitës merrej me tregti. Tregjet më të njohura ishin: Suki- (Tregu), Ukkadhi, Dhu'l Mexhazi, Maxhne, dhe shumë të tjera.⁴

Populli i Gadishullit Arabik që në kohët e lashta është marrë me tregti, ngase pozita gjeografike i ka diktuar një gjë të tillë. Karvanët e tyre tregtare udhëtonin dhe qarkullonin prej pjesëve më jugore e deri në atë veriore, Sham dhe anasjelltas. Ata tregonin në të gjitha stinët e vitit. Janë të njohura udhëtimet e dimrit dhe të verës, të cila i ka potencuar edhe Kur'ani i madhërueshëm.⁵ Tregtarët arabë shkonin deri në perandorinë Bizantine e Persiane. Madje deri edhe në Kinë nëpërmjet detit. Udhëtimet tregtare të arabëve të vjetër në viset e ndryshme të botës me kulturë të lashtë, kanë bërë ndikime të dukshme në individët e shoqërisë së atëhershme arabe.

4. El-Mubarekfuri, Safijurrahman, vepra e cituar, f. 44.

5. Shih, suren 106, "Kurejsh".

2. JETA FETARE E TRADICIONALE E ARABËVE PARA ISLAMIT

Njeriu, që kur u krijua, i vetëdijshëm për dobësitë dhe të metat e veta si krijesë jo e përkryer, jo e përsosur, e ka ndier të domosdoshme e të detyrueshme që t'i drejtohet për ndihmë Krijuesit për ta adhuruar, duke falënderuar e duke e lartësuar për atë që i ka dhuruar.

Që feja është e nevojshme për njeriun, flet edhe fakti se ajo është e vjetër sa edhe vetë gjinia njerëzore. Që nga paraqitja e njeriut të parë, Ademit a.s. e gjatë tërë historisë nuk ka pasur asnjë popull dhe shoqëri që nuk ka besuar. Nisur nga këtu, nuk mund të anashkalohet fakti se, njeriut nuk i nevojitet vetëm ushqimi trupor, por gjithashtu ai ka nevojë edhe për ushqim shpirtëror, për fe, pasi ai nuk është vetëm qenie fizike por edhe shpirtërore.

Njeriu, që me ardhjen e tij në këtë botë, e kishte për detyrë që t'i shprehte Krijuesit të gjithësisë mirënjohjen duke e adhuruar Atë, mirëpo një gjë e tillë, pra adhurimi në mënyrë të drejtë, nuk do të arrihej kurrë po të mos ishte mëshira e Allahut, i Cili dërgoi profetë, që t'i mësojnë e t'i udhëzojnë njerëzit se si duhet ta adhurojnë Allahun; e sa herë që njerëzit shmangeshin nga këto mësimë, Zoti do të dërgonte një profet tjetër për ta ripërtërirë të mëparshmen dhe për t'i rikthyer njerëzit në besim të drejtë.

Një kohë të gjatë arabët kanë predikuar fenë e gjyshit të tyre- Ibrahimit a.s. **Ed-dinu'1 Hanif** - الدين الحنيف, ku besonin Zotin Një, të vetmin dhe predikonin fenë e Tij. Ata, vazhduan të besojnë në një Zot, përderisa Amër bin Lihjai, kryetar i fisit Huza'ah, pas një vizite që i kishte bërë Shamit, me vete kishte sjellë edhe një idhull që quhej **Hubel** dhe e vendosi atë në Qabe. Amri ishte njeri me autoritet, i besueshëm dhe respektohej në mesin e mekasve. Siç kishin mekasit besim tek Amri, po ashtu të gjithë arabët, kishin besim tek mekasit, pasi ata ishin banorë dhe fqinj të shtëpisë së shenjtë, andaj edhe i ndoqën në çështjen fetare. Ky qe shkaku që politeizmi të depërtojë anekënd Arabisë. Pas kësaj u ngritën idhujt nëpër vendbanime e qytete të Arabisë siç ishin: **Lati** në Taif, **Menati** në Medinë, dhe **Uza** në një vend rreth 60 milje larg mes Mekes dhe Taifit, i quajtur Vadi Nehle.⁶ **Uza** ishte një ndër idhujt më të adhuruar në mesin e idhujtarëve.⁷ Pas çlirimit të Mekës, Profeti Muhamed a.s. dërgoi Halid bin Velidin dhe e theu. Nga Kur'ani mësojmë se këta ishin më të njohurit:

أَفْرَأَيْتُمُ اللَّاتَ وَالْعُزَّىٰ * وَمَنَاةَ الثَّالِثَةَ
الْأُخْرَىٰ * (النجم-۱۹-۲۰)

6. Aliu, Bashkim "Muhamedi a.s. Pishtari ndriçues" SH.B, Furkan ISM.

7. Naxhi Ma'rufi, Dr. Salih Ahmed El-Alij, Abdullah El-Fejad, "Terihu El-Arabi", f. 32, Bagdad, 1966 (1386 h.)

“A i keni parë Latin e Uzan dhe Menatin, të tretin të fundit?”⁸

Idhullin **Lat** arabët e kishin sjellë nga Taifi, kurse **Uzan** e kishin blerë në Vadi Nahl, ndërsa **Menatin** e kishin sjellur nga bregu i Detit të Kuq.⁹ Që nga atëherë u fut idhujtaria në mesin e arabëve.

Merret vesh se arabët, në prag të profetësisë së Muhamedit a.s., qenë ata që ishin shmangur nga besimi dhe adhurimi i drejtë. Më tepër i përmbaheshin traditës dhe zakoneve të tyre sesa ishin fetarë. U besonin miteve, falltarëve, por edhe horoskopit. Ata i adhuronin portretet (El-Euthan) por edhe idhujt (El-Asnam) që i bënë nga hurmat, drunjtë e gurët e ndryshëm. Disa fise ndërtonin zota nga hurmat e shtypura, e kur personit që ishte nisur në rrugë dhe kishte marrë me vete zotin e tij i mbaronte teprica e ushqimit gjatë udhëtimit dhe e kaplonte uria, mendohej ç’të bënte, dhe, pasi lukthi nuk ka mëshirë, udhëtari në këto raste nuk gjente diçka tjetër për të ngrënë përveç zotit të tij të bërë nga hurmat e shtypura, prandaj më në fund e merrte atë dhe e hante.

Kështu për shembull, në Qabe, e cila ishte ndërtuar për monoteizëm (besim në një Zot), brenda dhe përreth saj gjendeshin shumë idhuj! Gati çdo fis kishte idhullin e vet.

8. Kur’ani, sureja En-Nexhëm, ajeti 19-20.

9. El-Mubarekfuri, Safijurrahman, vepra e cituar, f. 33.

Bazuar në këtë gjë, mendohet se numri i idhujve rreth Qabes kishte arritur mbi 300. Është evidente se në kohën e çlirimit të Mekës, Muhamedi (a.s.) kishte hasur në 360 idhuj në Qabe dhe rreth saj.¹⁰ Arabët për idhujt e tyre sakrifikonin, bënë fljime nga më të ndryshmet dhe mishin ua shpërndanin nevojtarëve dhe shërbyeseve të idhujve. Për qëllime të caktuara ata falnin për idhujt edhe dhurata të ndryshme me vlerë, por edhe gjërat më elementare gjer në ushqim.

Edhe pse arabët, në numër të madh ishin idhujtarë, megjithatë, idhujtikonsideronin sindërmjetësues te Allahu i madhërisëm dhe nuk i besonin si zota të vërtetë. Përveç kësaj, në mesin e tyre ka pasur edhe hebrenj si në Jemen, Jethrib (Medine), Hajber dhe Tejma, që kishin migruar pas terrorit që ushtroi Buhatanaseri persian. Ai pati ushtruar dhunë gjenocidiale mbi hebrenjtë në Palestinë-Jerusalem, në vitin 589 p. e. r. Në arabi kishin ardhur edhe të krishterë nga viset rreth e përqark gadishullit arabik. Krishterimin e kishin pranuar fiset Gassasin, Taglib, Tajj, dhe disa fise të tjera që jetonin në Jemen, Irakun e sotëm, Sirinë, Palestinën e në veçanti ato fise që kufizoheshin me Bizantin.¹¹ Krahas pushtimit

10. El-Mubarekfuri, Safijurrahman, “Nektari i Vulosur i Xhennetit”, f. 34. përkthim nga gjuha boshnjake, Urtësia-Shkup, 1997.

11. El-Mubarekfuri, Safijurrahman, vepra e

të tokave arabe nga bizantinët dhe abisinasi (etiopasi e sotëm), bëhej edhe përhapja e krishterimit.

Siç u tha edhe më herët, një numër i vogël njerëzish predikonin fenë e gjyshit të tyre, Ibrahimit (a. s.) **Eddinu'l -Hanif** (الدينُ - الحنيف) (fenë e pastër – besimin në një Zot. Me një fjalë, lirisht mund të themi se arabët para Islamit, nuk i bashkonte as rregullimi shtetëror-shoqëror e as feja, por ishin popull i paqytetëruar, të shpartalluar, thuajse në çdo pikëpamje, pa një sistemim të mirëfilltë, që në njëfarë mënyre do t'i organizonte për një jetë të bazuar në ligje.

Përpos kësaj, kishin edhe disa tradita dhe vese të këqija, jonjerëzore, ndër të tjera duhen përmendur pirja e alkoolit, bixhozi, plaçkitja, prostitucioni, shitja e skllëvërve, dhe, mbi të gjitha, dukuria më e tmerrshme ishte varrosja e foshnjave vajza për së gjalli. Këtë krim tragjik e ka theksuar edhe Kur'ani:

وَإِذَا الْمَوْءُودَةُ سُئِلَتْ بِأَيِّ ذَنْبٍ قُتِلَتْ * (التكوير / ٨-٩)

“Dhe kur të pyetet e varrosura (foshnja femër e varrosur për së gjalli). Për çfarë mëkati është mbytur?”¹²

Sipas logjikës së idhujtarëve ishte turp për burrin që t'i lindte vajzë, prandaj ata më patriarkalët i varrosnin ato për së gjalli. Ishte ky tmerr e terr që mbretëronte në mesin e arabëve idhujtarë, injorantë e të egërsuar.

cituar, f. 38.

12. Kur'ani, Surja Et-Tekvirë, ajeti 8-9.

Ishin këto doke e tradita që errësonin e shuanin jetën e të pafajshmëve.

Përpos traditave dhe veseve e shprehive të këqija, ndër arabët ka pasur edhe disa virtyte dhe vlera. Ndër ato mund të veçohen;¹³

Bujaria- Nëse arabit të shkretëtirës i shkonte ndonjë mik apo mysafir i rastit, ai priste më shumë gëzim dhe nderime, duke i ofruar ushqim, pije, fjetje dhe përkujdes të madh ndaj tij. Arabi i paraislamit ishte në gjendje që familja e tij të heqë keq, të mos i ketë dhe të vuan ndoshta edhe për gjëra elementare, por mysafiri të dalë i kënaqur nga konaku i tij.

Besa- Fjala e dhënë dhe siguria-mbrojtja e dorëzonit i cili i ka hyrë në shtëpi arabit, ka qenë punë e shenjtë. Ai ishte i detyruar moralisht ta mbrojtë, po qoftë edhe më jetë të vetë apo të familjes, personin që ka kërkuar mbrojtje apo strehim.

Krenaria- Arabët nuk e kanë pasur adet në traditën e tyre që t'i përulën askujt dhe, ky gjest ka ushqyer një trimëri, që mund ta quajmë të egër, si dhe ata kanë sakrifikuar për ruajtjen e dinjitetit.

Modestia- Thjeshtësia e tyre në jetë, pa ndonjë luks të tepruar. Ata që kishin vendstrehim jetonin në kasolle të thjeshta, ndërsa ata që bënë jetë nomade banonin në tenda të punuara nga leshi i devesë apo i deles, duke u shpërngulur prej një vendi në tjetrin.¹⁴

13. Shih: Gavoçi, Vehbi Sulejmani, vepra e cituar, f. 18-19.

14. El-Mubarekfuri, Shih edhe:

E tërë ajo që u tha më sipër përshkruan dhe pasqyron jetën e arabëve para islame, para profetësisë së Muhamedit (a.s.), por është pikërisht shpallja që i erdhi e Muhamedit (a.s.); Kur'ani dhe Islami, faktorët e rëndësishëm që e shndërruan këtë popull kaq kontrovers në një popull me kulturë tepër të madhe dhe shumë të qytetëruar.

3. JETA KULTURORE E ARSIMORE E ARABËVE PARA ISLAMIT

Kur u bë fjalë për jetën politike e shoqërore të arabëve para Islamit, u theksua se ata asnjëherë nuk kishin pasur një jetë të organizuar, një shtet autoritet politik, që shquan një shoqëri të pavarur në një shkallë të caktuar qytetërimi e kulture të mirëfilltë. Prandaj, jeta nomade e tyre, arabëve të paraislamit nuk u dha mundësi të krijonin një kulturë vendore që do të vlente të përmendej. Udhëtimet tregtare të arabëve të vjetër në viset e ndryshme të botës me kulturë të lashtë, kanë bërë ndikime të dukshme në individët e shoqërisë së atëhershme arabe. Prej Kulturave Lindore kanë huazuar në veçanti astrologjinë dhe magjinë, kurse prej të parëve të vet kanë trashëguar një traditë fascinonte poetike.

Safijurrahman “Nektari i Vulosur i Xhennetit”, f. 44-45, përkthim nga gjuha boshnjake, “Urtësia” - Shkup, 1997.

E tërë ajo që është zbuluar nga periudha para Islamit sa i përket kulturës dhe qytetërimit të arabëve, janë një numër i konsiderueshëm i poezive të poetëve të shquar me vlerë artistike dhe historike por edhe disa mbishkrime a gdhendje të ndryshme që kanë lënë gjatë udhëtimeve të tyre për tregti prej jugut në veri dhe anasjelltas. Pastaj disa proverba të ndryshme, fjalë të urta, anekdota, rrëfime të ngjarjeve historike, që të gjitha këto të përcjella gojarisht nga një brez në tjetrin po jo në ndonjë mënyrë të organizuar.¹⁵

Një mbishkrim i vjetër është gjetur i gdhendur mbi varrin- epitaf të Kajdes, bijës së Abdi Menatit, të cilin e kishte punuar Kab bin Harithi në vitin 368, pas lindjes së Isait (a.s.) e ku thuhet: *ذین للقيض بنت عبد منات* (ku pas deshifrimit del *هذا القبر*) (*Ky varr është i Kajdes, bijës së Abdi Menatit*).¹⁶

Nga gdhendjet më të vjetra të gjurmara deri më sot, llogaritet edhe mbishkrimi mbi varrin-mauzoleum të Imri El-Kajsit, të një princi Arab, e që daton vitin 228.¹⁷

Nga dituritë e arabëve para islamë mund të theksohet ajo në fushë të astronomisë, ngase ata dinin dhe njihnin një numër yjesh, me të

15. Dr. Shevki Dajf, Terih El-Edebi El-Arabij, El-Asru El-Xhahili, “Daru El-Mearif”, Kajro, f. 84.

16. Dr. Subhi Es-Salih, Dirasatë fi Fik’hi El-Lugati, Bejrut, 1968, f. 57.

17. Dr. Subhi Es-Salih, vepra e cituar, f. 57.

cilat orientoheshin në udhëtimet e tyre natën, për shkak se vapa e madhe i pengonte të udhëtonin me karvanët e tyre tregtare gjatë ditës. Kështu ata gjatë udhëtimeve të tyre nëpër detin e thatë–Saharën, gjatë natës, dinin se cilat nga yjet do t’ua ndriçojnë rrugën e tyre të gjatë, dinin me cilin të orientoheshin.¹⁸

Arabët paraislamë mjekonin disa sëmundje me mjekim popullor. Kishte prej tyre që merreshin edhe me arte, e posaçërisht me muzikë, por gjithë kjo që u tha deri më tani, nuk ka ndonjë rëndësi të posaçme, është poezia ajo që i veçon ata.

Arabët si oratorë janë të njohur që nga kohët më të hershme, por edhe si mjeshtra të fjalës artistike. Ata që asokohe organizonin mitingje poezish, sidomos në kohën e haxhit. Ndër mitingjet më i njohuri është ai që organizohej në tregun Ukadhë. Ai ishte njëri prej panairove më të mëdha të Arabisë, i cili organizohej në Nexhdin e epërm, afër Arafatit. Poetët në këto mitingje përfaqësonin klanet-fiset e tyre. Ata në këso rastesh i këndonin fisit, heronjve dhe trimave të tyre, vendbanimeve të lëshuara, të dashurës, devesë, shkretëtirës e mjedisit të tyre. Poezia e tyre kishte arritur një shkallë të lartë, si nga ana artistike, ashtu edhe nga forma, përmbajtja e nga ana stilistike. Në këto mitingje,

18. Dr. Dajf, Shevki, Terih El-Edebi El-Arabij, El-Asru El-Xhahili, “Daru El-Mearif”, Kajro, f. 87.

kritikoheshin, vlerësoheshin e shpesh edhe shpërbleheshin poezitë-këngët më të mira. Si dëshmi se poezia vlerësohej e çmohej në periudhën e para Islamit, janë edhe shtatë poezitë e shtatë poetëve, të cilat u shkruan me shkronja të arta dhe u varën në muret e Qabes për vlerën që kishin. Janë këto shtatë poezitë e njohura *المُعَلَّقَاتُ السَّبْعَةُ*-(Shtatë të varurata).¹⁹

Këto janë arritjet që mund të përmenden në fushën e kulturës së arabëve paraislamë, kurse sa i përket arsimit mund të themi lirisht se para Islamit nuk ekzistonte fare. Madje arsimit, ose thënë më saktë, mësimi i alfabetit si dhe të gjitha artizanetat e tjera ishin të nënçmuara. Nxënia e shkrim-leximit dhe e zejeve ishte thyerje e traditës, prandaj urrehej. Megjithatë, para Islamit në Mekë e Jethrib, kishte njerëz që dinin shkrim e lexim. Alfabeti arab, ky i sotmi, ka të dhëna se është si rrjedhojë e shkrimit “demotik” të egjiptianëve të vjetër e shkrimit fenikas dhe atij aramit. Shkencëtarët arabë pohojnë se arabët shkrimin e tyre e kanë marrë nga banorët e Hirës, qytet në Irak (Nexhefi i sotem). Për evoluimin dhe zhvillimin e shkrimit arab, shkencërisht dëshmohet se ai është rrjedhim i shkrimit Nebtij-*الخط-النَّبْطِيُّ*. Sipas historianëve arabë, alfabetin në Mekë e solli Hareb bin Umejete bin Abdi’sh-Shems. Ai gjatë udhëtimeve të tij e kishte mësuar alfabetin prej disa njerëzve dhe,

19. Dajf, Dr. Shevki, vepra e cituar, f. 140.

njëri ndër ta ishte Beshër bin Abdi'l-Melik, i cili kishte ardhur në Mekë dhe gjatë qëndrimit të tij aty, u mësoi shkrim e leximin disa prej mekasve.²⁰ Ka të dhëna se Zejd Ibni Thabiti, (sekretar i parë i Pejgamberit (a.s.) dhe shkruer i trefishtë i Kur'anit), më kërkesë të Muhamedit (a.s.) kishte mësuar shkrim e këndim për gjysmë muaji.²¹

Kësodore mund të dëshmohet se një numër mekasish edhe para Islamit dinin shkrim e lexim, por edhe në Jethrib, kur arritën myslimanët emigrantë, gjetën një hebre që u mësonte njerëzve shkrim e lexim. Pra, në këto dy qendra, që nga kohët e lashta, para islame, kishte njerëz që dinin shkrim-lexim, por arsimimi nuk kishte marrë përmasa të gjera.

Në bazë të kësaj që u tha, mund të përfundohet se arabët para Islamit nuk ishin kryekëmbë analfabetë edhe pse arsimimi nuk kishte marrë përmasa të gjera. Dëshira për arsimim do të rritet pas profetësisë së Muhamedit (a.s.), kur njerëzit fillojnë të interesohen për shkrimin e Kur'anit, por përmasa më të gjera arsimimi do të marrë me kalimin e myslimanëve në Jethrib (Medine), sidomos pas ngadhënjimit të tyre në betejën e Bedrit, ku zunë rob 70 kundërshtarë. Muhamedi (a.s.) për lirimin e çdo robi që dinte shkrim

e këndim, kishte vënë si kusht që t'ua mësonte dhjetë fëmijëve të myslimanëve shkrim e këndim. Më vonë, xhamia e Profetit (a.s.) në Medinë, do të bëhet vatër e arsimit për të gjitha dituritë, dhe sidomos për mësimin e Kur'anit.

4. JETA POLITIKE-SHOQËRORE E ARABËVE PARA ISLAMIT

Tashmë është e mirëditur se arabët, po ashtu edhe hebrejtë janë popull semitë. Emërtimi si popull "Semit" (Samit), nuk është i rastësishëm, ngase gjenealogjia e tyre rrjedh nga Sami i biri i Nuhit (a.s.). Besohet se atdheu i semitëve është vetë Gadishulli Arabik që dikur kishte qenë tokë shumë pjellore.²² Që të dy këto popuj (arabët dhe hebrejtë) janë pasardhës të profetit Ibrahim (a.s.). Nga dy djemtë e Ibrahimit (a.s.), Ismailit dhe Is'hakut, rrjedhin arabët dhe hebrejtë: arabët nga Ismaili, ndërsa hebrejtë nga Is'haku. Arabët i kanë ruajtur në masë të madhe tiparet dhe karakteristikat e popujve semitë. Kjo, përveç të tjerash vërehet edhe të gjuha e tyre, ku më tepër se çdo gjuhë tjetër semite, përfshirë edhe hebraishten, arabishtja ka ruajtur veçoritë themelore të gjuhëve semite.²³

20. Ez-Zinxhanij, Ebu Abdil-lah, "Terihu El-Kurani", f. 25, Bejrut, 1969 (1388 h.).

21. Ez-Zinxhanij, Ebu Abdil-lah, vepra e cituar, f. 25.

22. Naxhi Ma'rufi, Dr. Salih Ahmed El-Alij, Abdullah El-Fejad, "Terihu El-Arabi", f. 7, Bagdad, 1966 /1386 h.

23. Flip Hiti, "Istoria arapa" f. 25-27, bot. i dytë, Sarajevë, 1988.

Pasardhësit e Ismailit (a.s.), arabët e mëvonshëm e popullojnë Gadishullin Arabik dhe, periudha mes Ismailit (a.s.) dhe Muhamedit (a.s.) paraqet epokën e luhatjes shpirtërore dhe fetare të shoqërisë arabe. Atë e kapluan lloj-lloj epidemish morale dhe traditash të këqija.

- Shtresat shoqërore dhe pozita e tyre juridike

Edhe tek arabët si edhe shumë popuj tjerë të Lindjes së lashtë, popullata përgjithësisht ndahej në të lirë (**hur-r**) dhe jo të lirë (**abdun**).

Shoqëria arabe paraislame ishte e kategorizuar në tri shtesa:

1. Shtresën e parë e përbënin **fisnikët** dhe prijësit e familjeve, (skllavopronarët) dhe këta ishin faktorë vendimtarë dhe kreativ në shoqëri.

2. Shtresën e dytë e përbënin **qytetarët e thjeshtë**, njerëz të rëndomtë të cilët nuk kishin skllavë, të cilët nuk kishin ndonjë ndikim më rëndësor në shoqëri, por ishin të lirë dhe kishin të drejtë në qeverisjen me pasurinë e tyre, dhe në aspektin juridik të gjithë njerëzit e lirë i takonin klasës skllavopronare.

3. Shtresa më e ulët në shoqëri, ishin **robërit**, (skllavë) të cilët i përkisnin klasës së nënshtruar dhe të përbuzur, të cilët nuk kishin asnjë ingjencë në jetën e tyre. Ata ishin thjeshtë pronë e zotërinjve të tyre, andaj mund të shiteshin dhe të bliheshin në treg si çdo mall tjetër.

Sipas vullnetit të atij që i zotëronte, ata mund të mbeteshin tërë jetën rob, mund të shiteshin, mund të kompensohej vlera e tyre e pastaj të lroheshin, po edhe mund të lroheshin pa kompensim, varësisht prej pronarit të tyre. Skllavi ishte objekt i së drejtës e subjekt. Atij i mungonte zotësia juridike, andaj nuk kishte të drejtë në pronësi, të pasurisë së paluajtshme, nuk kishte as të drejtë martesë pa pëlqimin e padronit të tij.

Arabët e hershëm ishin popull jo i qytetëruar. Ishin popull i cili nuk posedonte urtësinë indiane, as prodhimin kinez, as filozofinë greke, as ligjin romak, e as civilizimin persian. Ishin popull i ndarë në fise, të cilat luftonin dhe grindeshin mes njëri-tjetrit, popull të cilin e kishte përçarë armiqësia verbuese, ku secili ndihmonte fisin e vet, qoftë në të drejtë apo në të shtrembër.

Arabët në të shumtën janë të njohur si popull endacak, që gjatë historisë bënë jetë nomadësh, duke kërkuar ato pak kullota që gjendeshin nëpër shkretëtirë për bagëtinë e tyre. Në Arabi jetonin fise beduinë, të cilat kishin origjinë të përbashkët semite të cilët kishin gjuhë, zakon, traditë, dhe kulturë të përbashkët. Beduinët arabë nuk vendoseshin në një vend të caktuar ndoshta për shkak të kushteve në të cilat jetonin. Meka, si vend i shenjtë, mu për faktin se në të ndodhet Qabja që e ndërtoi Ibrahim (a.s.) me djalin e tij, Ismailin,

është vendi i parë në Gadishullin Arabik, në të cilin nisi të zhvillohej një jetë e organizuar e të qytetëruar, duke qenë se vendet rreth e përqark synonin Mekën për ta kryer haxhin. Edhe Jethribi (Medina e sotme) ishte qendër e njohur e udhëkryq i madh tregtar, por faktikisht në Gadishullin Arabik nuk kishte një jetë të organizuar të tillë, që do të bënte të mundshme arritjen e shkallës së një shteti krejt të pavarur, nuk ekzistonte një shtet autoritet politik mbi tërë gadishullin.

Arabët nuk patën ndonjë mbretëri me mbretër të kurorëzuar e të pavarur e as ndonjë federatë të përbashkët politike e as shtet administrativ me ushtri dhe lider i cili do të i udhëhiqte fiset arabe, sepse, një numër i madh nga ata jetonin jetë nomade, por kishin disa principata jo krejt të pavarura dhe kryetarët e fiseve të cilët i kanë udhëhequr ata.²⁴

Në shekullin V-VI-të, arabët e paraislamit, në periudhën e injorancës, jetonin në një shoqëri primitive, me një organizim **klano-fisnor**. Njësia më e madhe ka qenë **fisi (kabilja)**. Fisi ndahej në **klane**, (**xhinse**). Klanet ndaheshin në **vëllazëri**, ndërsa njësia më e vogël ka qenë me kryefamiljarin në krye. Mashkulli posa martohej kalonte në tendën e tij dhe bëhej zot shtëpie (udhëheqës i familjes).

24. El-Mubarekfuri Safijurrahman, vepra e cituar, f. 20.

Sistemi i organizimit fisnor në shoqërinë arabe paraislame përbëhej nga tri shtresa kryesore:

-**Fisnorët**-vendedorët, që ishin bërthama e organizimit fisnor dhe përbënin boshhtin kryesor të fisit.

-**Aleatët**, arabë të ardhur të cilët u bashkoheshin vendorëve dhe ishin nën mbrojtjen e tyre.

- **Robërit**, që ishin të kapur gjatë luftërave, të blerë ose të robëruar për shkak të borxheve. Këta jetonin brenda organizimit fisnor, duke u marrë me punët e krahut në bujqësi, blegtori ose ndonjë zanat tjetër.

Organizimi fisnor i ngjasonte një mini-shteti që i kishte bashkuar lidhja fisnore, gjaku apo interesi i përbashkët. Fisi kishte kryetarin e quajtur **Shejh**. Çdo fis kishte kuvendin por edhe këshillin e fisit që përbëhej nga kryetarët e klaneve. Ky organizim shoqëror bazohej në afërsi të gjakut. Anëtarët e fisit merrnin detyra dhe përgjegjësi ndaj bashkësisë fisnore. Ata mund të shtronin problemet e tyre të brendshme, por edhe marrëdhëniet e tyre me fiset tjera në fqinjësi, dhe zakonisht këto tubime bëheshin natën. Shumë aktivitete, pra edhe udhëtimet arabët i zhvillonin natën për shkak të vapës së madhe ditën. Fisin e printe dhe e udhëhiqte kryetari i tij, i cili duhej të ishte njëri me autoritet dhe trimëri të veçantë.

Arabët beduinë respektonin fuqishëm traditën zakonore. Për shkelje të ndryshme aplikonin

sistemin e reciprocitetit, ose hakmarrjes: “gjak për gjak, sy për sy, dhëmb për dhëmb”.

Megjithatë, dënimet e hakmarrjes shpesh kompensoheshin me të mira materiale, varësisht nga rëndësia e fisit. Për shembull, një vrasje e rëndësishme kompensohej deri në **1,000 deve**, ndërsa raste të zakonshme me **100 deve**.²⁵

Në këtë periudhë, aristokracia fisnore merrej kryesisht me tregti të brendshme dhe ndërkombëtare, që nga India deri në Abisini dhe nga Jemeni deri në Siri. Kryesisht tregtonin me erëza të shumëllojshme, me mëndafsh, e prodhime të tjera. Aristokracia fisnore, e pasuruar nga tregtia, merrej edhe me fajdexhillek, ku shumë njerëz të lirë, të varfër, për shkak se nuk mund ta kthenin borxhin, humbnin lirinë dhe shndërroheshin në skllëvër. Në këtë mënyrë rriteshin diferencat sociale. Si rezultat i këtij zhvillimi u themeluan disa qytet-shtete të rëndësishme në formë të principatave.

a. Meka

Meka, një nga vendet më të shenjta dhe më të rëndësishme botërore, është qyteti ku lindi Muhammedi (a.s.) dhe ku kaloi pjesën më të madhe të jetës së tij (40 vjet para shpalljes dhe 12 vjet

pas shpalljes së profetësisë). Meka si vend i shenjët mbahet në mend që nga ndërtimi i Qabes (Faltore së parë në rruzullin tokësor). Kjo faltore e shenjët u ndërtua e rindërtua pesë herë. Për herë të parë e ndërtoi Shiti, i biri Ademit (a.s.) pastaj profetët Ibrahimimi dhe Ismaili (a.s.), pastaj e rindërtuan kurejshët dhe gurin (Haxheri-Esvedin) këtë herë e shtroi Muhamedi (a.s.), pastaj, pas djegies, u rindërtua në kohën e Ibni Zubejrit. Meqë nuk i kishte pëlqyer forma e Qabes, pas rindërtimit të fundit, Abdulmelik bin Mervanit, kalifit Emevij që sundoi në mes viteve (685-705), ai e rindërtoi dhe e ktheu në formën fillestare që kishte pasur Qabja.²⁶

Në Mekë ka banuar Ibrahimimi dhe Ismailin (a.s.) dhe, për një kohë edhe Is’haku ishte me ta, dhe e gjitha kjo ndodhi pasi që ishin depërtuar nga Iraku. Dikur herët në lashtësi në Mekë ka udhëhequr fisi Xhurhum e pas tyre fisi Huza’atu deri me ardhjen e Kusaj b. Kilabit nga fisi Kurejsh, (njëri nga gjyshat e hershëm të Profetit Muhamed (a.s.), i cili me forcë i largoi të tjerët nga aty dhe shtriu pushtetin e tij në Mekë.

Meka, një vend i thatë, e papërshtatshme për bujqësi, pa lumenj, me pak burime e puse ujërash, me reshje atmosferike të

25. Naxhi Ma’rufi, Dr. Salih Ahmed El-Alij, Abdulllah El-Fejad, “Terihu El-Arabi”, f. 30, Bagdad, 1966 /1386 h.

26. Grup autorësh, “Es-Siretu En-Nebevijetu Li-Ibni Hisham”, pjesa e parë, bot. i tretë, f. 204, fusnota 5, Bejrut, 1391 h. (1971).

rralla, detyrimisht u shndërrua në një qendër tregtare e dalluar, duke qenë se aty frekuentonin shumë tregtarë dhe haxhinjë edhe para islamit. Aty ndalonin karvanët tregtare nga të gjitha anët, aty gjenin strehim dhe siguri për vetë faktin se në haremet e Mekës ishte e ndaluar gjakderdhja, lufta edhe para islamit. Vija tregtare që kalonte nëpër Mekë lidhte Lindjen me perëndimin e jugun me Veriun. Karvanët tregtare, me kapitalin e tyre tregtonin me Jemenin, Shamin, Irakun, Etiopinë, Indinë etj. Tregtinë e mekasëve e ka përshkruar edhe Kur'ani.²⁷ Sa i përket zhvillimit të ekonomisë në tokat arabe, asaj, në një masë i ndihmonte shenjtëria e Mekës dhe vizitat që i bëheshin Qabes e në veçanti gjatë sezonit të haxhit. Gjatë muajve të haxhit në Mekë dhe në vendet përreth organizoheshin tregje të mëdha tregtare në të cilat tregtoheshin prodhimet e importuara nga jashtë por edhe të gjitha llojet e prodhimeve vendore. Në gadishullin arabik, si në Mekë, panaire të shumta organizoheshin edhe në qendra tjera në sezon të ndryshme. Aty, krahas tregtisë, poetët deklamnin edhe poezitë e tyre, me ndihmën e të cilave afirmonin vlerat materiale dhe shpirtërore të tyre dhe të fiseve nga ku vinin ata. Para vitit 640, ata kishin shumë kohë që banonin në trekëndëshin pjellor Babiloni (Iraku i sotshëm), Siri-Palestinë dhe Egjipt.

Nga sa u tha deri më tani në 27. Kur'ani, shih suren "El-Kurejsh".

lidhje me jetën politike e shoqërore dhe ekonomike të arabëve para Islamit, mund të përfundohet se arabët para islamit nuk patën ndonjë jetë politiko-shoqërore të organizuar e të pavarur në shkallë perandorie, sado që rreth e përçark kanë qenë të rrethuar nga kultura dhe perandori të formuara që nga kohët e hershme, siç janë: fenikasit, babilonasit, egjiptianët, asirasit (asirianët), aramitët e më vonë persianët dhe bizantinët, nga të cilët këta dy të fundit, do të shpartallohen e do të zhduken nga trysnia e kulturës dhe e qytetërimit islam.

Ksenofoni, historiani, filozofi i Greqisë së Lashtë dhe ish-nxënës i Sokratit e përshkruan Arabinë si një vend që ndodhet në jug-perëndim të Mesopotamisë ndërmjet lumit Nil dhe detit të Kuq. Në këtë kohë u themeluan shtete të vogla arabe të cilat ishin nën ndikimin helen pas shkatërrimit të perandorisë seleucide si Nabatena, Iturija, Osroena (Edesa), Palmira. Në këtë kohë, dy ishin qytetet kryesore të Arabisë: Meka ku ishte e zhvilluar financa dhe Medina ku ishte e zhvilluar bujqësia. Për shkak të zhvillimit të madh ekonomik dhe qytetërimit që u zhvillua në Arabi, (në Jemenin e sotshëm) romakët filluan ta quanin Arabia felix (ose Arabia e lumtur).

Principata e Jemenit, që u themelua në pjesën jugore të gadishullit Arabik. Jemeni, vend strategjik, me begati natyrore, me

ujë dhe toka bujqësore të pëlleshme, me nëntokë të pasur me xehe, ari e argjend dhe gur të çmueshëm, me një pozitë gjeografike shumë të përshtatshme për tregti detare dhe tokësore nëpër Afrikë, Azi të mesme dhe të largët (Indi e Kinë). Këtë principatë e sunduan:

Meinasit, që u themeluan në anën jug-lindore të Jemenit, diku rreth 1,000 vjet para lindjes së Isait (a.s.) me qendër në Mein, qytet i cili ndodhej në jug-lindje të Jemenit. Këta sunduan rreth 200 vjet dhe përfunduan me shpartallimin e shtetit të tyre i cili u copëtua në disa principata të vogla, por më e dalluara ishte ajo e sebeistëve.²⁸

28. Naxhi Ma'rufi, Dr. Salih Ahmed El-Alij,

Sebeinët, në rrënojat e Meinasëve, u ngritën sebeinët të cilët sunduan aty kah shek. VIII-të para lindje së Isait. Këta u shquan me ndërtimin e pendëve (digave) akumuluese të ujit, hidrosisteme, por edhe me infrastrukturë tjetër, pallate e idhuj nga më të ndryshmit. Ndër digat më të shquara është ajo e Meëribit në gjatësi prej 800 kuti. Diga e Meëribit, rrënojat e së cilës janë edhe sot shih fotografinë, ishte njëri prej projekteve të rëndësishme të sebeinëve.²⁹

Abdull-llah El-Fejad, "Terihu El-Arabi", f. 10, Bagdad, 1966 /1386 h.

29. Jahja, Harun, "Popujt e zhdukur", f. 126 dhe 131, "Dielli I. C.", Istanbul, Mars, 2002.



Me ndihmën e Digës së Maribit, e cila ishte ndërtuar nëpërmjet teknologjisë së avancuar, populli i Sebeit arriti një nivel të lartë zhvillimi dhe mirëqenieje. Tokat e tyre pjellore dhe kontrollimi i rrugëve tregtare ishin faktorët kryesorë që ndikuan në përparimin e tyre. Megjithatë, ata i kthyen shpinën Allahut në vend që t'i ishin mirënjohës për gjithë këto të mira, ndaj diga u shkatërrua dhe vërshimi i Arimit shkatërroi gjithçka.

Kjo digë u shkatërrua për shkak të vërshimit të Arimit, i cili përmendet në Kur'an. Për shkak të kësaj katastrofe, sebeinët humbën forcën e tyre ekonomike dhe për një kohë shumë të shkurtër u asimiluan.

Ndërtimin e digave të tyre i ka cekur edhe Kur'ani.³⁰ Sebeinët patën shtrirë pushtetin e tyre gati në tërë Jemenin. Sistemi sundimit të tyre ishte mbretëri me trashëgimi.³¹ Dokumentet historike flasin edhe mbi takimin e profetit Sulejman me mbretëreshën e Sebeit. Janë këto të dokumente materiale të cilat dolën në pah nëpërmjet hulumtimeve të bëra në gërmadhat e lashta të Sebeit, në Jemenin Jugor. Kërkimet e bëra mbi këto gërmadha zbulojnë se një mbretesha (mendohet të ketë qenë Belkisa) jetoi në këtë vend midis viteve 1000 dhe 950 para lindjes së Isait dhe udhëtoi drejt veriut (në Jerusalem).

Hamjerinët - u paraqiten dhe sunduan në pjesën jugore të Jemenit. Kryeqyteti i tyre ishte Zafari. Tentuan zgjerimin e kufijve të pushtetit të tyre edhe jashtë Jemenit. Sulmuan Etiopinë e krishterë dhe Jethribin (Medinën), dhe futën nën sundimin e tyre gati gjithë Gadishullin Arabik. Më vonë Hamjerinët u sulmuan ushtarakisht nga etiopasit (Ebreheja), dhe i detyroi ata, vendorët që të konvertoheshin në

krishterim. Për këtë qëllim Ebreheja (komandant ushtarak i krishterë nga Etiopia), ndërtoi një kishë të madhe dhe emërtoi El-Kul'lejs. Ky komandant, për ta ngritur imazhin e kishës së tij dhe për të formuar një kredibilitet për vetën e tij, përgatiti një ushtri të madhe, në të cilën kishte edhe elefantë dhe u nis për ta rrënuar Qaben. Synimet dhe objektiva e tij nuk u realizuan kurrë. Ebreheja së bashku me forcat e tij ushtarake u shkatërrua tërësisht në shkretinë, pak para se të mbërrinte në Mekë. Këtë katastrofë ushtarake qëllimkeqë e ka përshkruar Kur'ani në suren "El-Fil".³²

b. Principata e Tedmurit

Tedmuri shtrihej në fushat e Shamit në mes lumit Euftrat në lindje dhe qyteteve Humus e Damask në perëndim. Ishte qendër ku ndalonin dhe ku kalonin karvanët tregtare në drejtim të Irakut, Shamit dhe anasjelltas. Vetë këta, lidhje të mira tregtare kishin me bizantinët, grekët dhe romakët. Ajo që mund të veçohet nga kjo principatë është princesha Zenubja. Një vejushë që mori pushtetin nga biri i saj, trashëgimtari i fronit, për shkak moshës së vogël të tij. Ishte kjo një femër intelektuale e madhe që kishte studiuar filozofinë greke dhe njëhte gjuhët e huaja aramishten, greqishten dhe latinishten. Kishte ambicie të mëdha për pushtet, prandaj sulmoi

32. Kur'ani, sureja "El-Fil".

30. Kur'ani, sureja Es-Sebeë, ajeti i 15.

31. Naxhi Ma'rufi, Dr. Salih Ahmed El-Alij, Abdull-llah El-Fejad, libri cituar, f. 11.

dhe pushtoi Sirinë, Azinë e vogël, synoi Egjiptin, por ia prenë hovin romakët, të cilët ju kundërvënë dhe e pushtuan Tedmurin, ndërsa princeshën-Zejnuben e robëruan, e çuan në Romë si rob lufte, ku atje edhe vdiq.³³ Principata e Tedmurit përbëhej prej disa fiseve arabe që kryesoheshin nga kryetarët në Kuvendin e Përgjithshëm. Tedmuri kishte sistemin e organizimit ushtarak, gjyqësor por edhe policor. Për sa i përket çështjes së besimit, ata ishin idhujtarë dhe adhuronin idhujt që i vendosnin në vende të larta.

c. Principata e Petrës (El-Enbati)

Petra ndodhet në një vend shkretinor në jug të Jordanisë. Që nga kohët e lashta në Petra banonin disa fise arabe të quajtura El-Enbat. Ishte një vend, qendër tregtare, me burime të shumta uji, nga kalonin karvanët tregtare që qarkullonin në drejtime të ndryshme. Këtë vend të vogël tentuan ta pushtojnë ashurijinët, betalisët e bile edhe Aleksandri i madh i Maqedonisë, por populli i Petrës qëndroi stoik i palëkundshëm nga trevat e veta.

Pas trazirave që ndodhen në Siri e Egjipt në shek. e II-të para e.r.s, (para lindjes së Isait) petrasit e shfrytëzuan këtë periudhë trazirash, duke i zgjeruar kufijtë e pushtetit të tyre, nënshtruan Sirinë dhe shumicën e

tokave të Palestinës. Në vitin 109 sipas e.r.s romakët e pushtuan Petrën dhe ia bashkëngjitën perandorisë së tyre të madhe. Petrasit kanë përdorur gjuhën arabe, ndërsa për shkrimin e kësaj gjuhe kanë përdorur alfabetin aramitë nga i cili, më vonë, ka dalë edhe shkrimi arab kufias. Petrasit rëndësi të madhe i kanë kushtuar edhe infrastrukturës, ku edhe sot e kësaj dite, pallatet e tyre, disa nga ato, të gdhendura në kodra guri, tani në Jordaninë e sotme, janë mahnitëse dhe vlera kulturore që dëshmojnë për madhështinë e këtij populli. Për sa i përket çështjes së besimit, petrasit ishin idhujtarë. Krahas të tjerëve ata adhuronin edhe Hebelin, Latin e Uzan, idhujt që tani veç janë të njohur për ne, madje edhe të cekur në Kur'an.³⁴

Po në veri të gadishullit arabik, në kufijtë me Sirinë dhe Palestinën, ekzistonte një principatë arabe, e njohur me emrin Gasanët, të cilët ishin në aleancë me bizantinët e që predikonin, si fe të tyre, krishterimin. Gasanët ishin të vendosur në pjesën lindore të Sirisë. Me origjinë ishin nga Jemeni, por të shpërngulur nga atje, u vendosen në Siri, në fqinjësi me bizantinët. Bizantinët një kohë i lanë të qetë Gasanët dhe njohën një lloj sovraniteti të tyre. Meqë ishin në aleancë me bizantinët, Gasanët disa herë i kishin ndihmuar të parët bizantinët në luftërat e tyre, kundra menadhirëve dhe sasanitëve, që ishin

33. Naxhi Ma'rufi, Dr. Salih Ahmed El-Alij, Abdullah El-Fejad, "Terihu El-Arabi", f. 14, Bagdad, 1966 /1386 h..

34. Naxhi Ma'rufi, Dr. Salih Ahmed El-Alij, Abdull-llah El-Fejad, libri cituar, f. 18.

të vendosur në trojet e Irakut të sotëm. Pushteti i gasasinëve ishte i shtrirë në disa fise arabe në pjesën e Shamit. Qendër e tyre ishte El-Xhanibije. Disa nga princat e kësaj principate i kishin vizituar poet arabë të praislamit si Nabigatu Edhibjaniu dhe Hassan bin

Thabit të cilët në poezitë e tyre patën përshkruar jetën në pallatet e princave gasasinë. Në prag të Islamit, gasasinët u pushtuan dhe u nënshtruan nga Sasanitët, ndërsa principata e tyre u shpartallua.³⁵

35. Naxhi Ma'rufi, e të tjerë, libri cituar, f.



Nebateanët, një prej fiseve arabe, themeluan mbretërinë e tyre në Luginën e Rumit, në Jordani. Në këtë vend, i cili njihet dhe si Lugina e Petrës, mund të shihen shembujt më të mirë të mjeshtrisë së skalitjes së gurit. Edhe Themudi përmendet në Kuran për mjeshtërinë e punimit dhe skalitjes së gurit. Sidoqoftë, sot nuk ka mbetur gjë tjetër nga këta dy popuj veçse disa rrënoja që na japin një ide të qartë të nivelit të artit të asaj kohe. Në këtë foto ju mund të shihni disa shembuj të punimit të gurit, në Luginën e Petras.

ç. Menadhirët

Në kufijtë me Persinë ndodhej një principatë tjetër arabe, ajo e Menadhirëve, por nën ndikimin e Perandorisë Persiane që predikonin adhurimin e zjarrit. Menadhirët për kryeqytet të tyre kishin zgjedhur qytetin El-Hirete, në afërsi të Kufes së sotme. Këta patën shtrirë pushtetin e tyre edhe në disa fise arabe në anën veriore të Gadishullit Arabik. Ndër më të shquarit prej princave të kësaj principate ishte Ebu Kabus En-Nua'man bin El-Mundhir, për të cilin kishin shkruar dhe lavdëruar disa poetë të kohës e ndër ta edhe Nabigatu Edh-Dibjanu. Menadhirët patën një ushtri të fortë e cila shpeshherë kishte guximin të hynte në luftë edhe me bizantinët. Kishin një infrastrukturë të avancuar në ndërtimin e pallateve, pendëve dhe të hidrosistemit. Merreshin edhe me zejtari; vegtari, qëndisje, argjendari, vorbëtari. Besonin në idhujtari dhe ndër idhujt më i njohuri ishte Edistani, por më vonë u përhap edhe krishterimi. Nga kultura, ajo që dihet për menadhirët është se ata dinin shkrim e këndim dhe se kishin bërë disa përkthime nga gjuha greke.³⁶

m. Kindët

Një principatë tjetër e themeluar në shek e III-të të e.r.s (pas lindjes

së Isait), në lindje të Hixhazit, ishte ajo e kindëve. Themeluesi kësaj principate ishte Haxheri. Më i njohur ndër princat e kësaj principate është Umreu El-Kajsi, njëri prej poetëve më të shquar të periudhës së injorancës. I lindur dhe i rritur në Fisin Beni Esed, por për shkak të shfrenimit së tij, edhe pse ishte më i vogëli prej fëmijëve, babai, Haxheri e kishte përzënë nga shtëpia. Posa kishte marr lajmin për vrasjen e babit të tij ishte kthyer në shtëpi për tu hakmarrë ndaj vrasësve. Për këtë punë e ndihmuan edhe fiset e tjera arabe, por për rikthimin e fronit, nuk e ndihmoi askush, prandaj vendosi që të shkoj në Konstatinopol (Stambollin e sotëm) për të kërkuar ndihmë dhe përkrahje për ta kthyer fronin. Edhe atje nuk gjeti përkrahjen e duhur dhe gjatë kthimit, rrugës vdes në Ankara dhe më këtë merr fund edhe principata e Kindëve. Principata e kindëve kishte një shtrirje gati në gjithë gadishullin arabik dhe pati për objektivë që t'i bashkoj arabët nën sundimin dhe centralizimin e tyre në një principatë. Pas shpartallimit të kësaj principate, fiset arabe u decentralizuan dhe vazhduan organizimin e jetës së tyre sipas sistemit fisnor. Nga kindasit rrjedh poeti më i shquar e periudhës paraislame Umreu El-Kajsi.³⁷

19.

36. Naxhi Ma'rufi, Dr. Salih Ahmed El-Alij, Abdullah El-Fejad, libri i cituar, f. 20.

37. Po aty, f. 23.

Konak me Edisonin

Nuredin Nazarko

Abstrakt

“Konak me Edisonin” është një reflektim filozofik-letrar që eksploron përmasat ekzistenciale të jetës njerëzore përmes një udhëtimi meditativ ndërmjet mendimit filozofik, poezisë dhe artit. Teksti shqyrton tema të thella si qëllimi i ekzistencës, liria individuale, kujtesa, dashuria dhe marrëdhëniet e njeriut me shoqërinë dhe botën përreth. Përmes një ndërthurjeje të bukur të filozofisë dhe ndjeshmërisë poetike, autori argumenton se përmbushja e vërtetë njerëzore nuk mund të arrihet thjesht përmes plotësimit të nevojave materiale, por kërkon një përkushtim të vazhdueshëm ndaj pasurimit shpirtëror dhe kuptimit të mistereve të jetës.

Përmbushja e jetës njerëzore lidhet me qëllimin pse jetojmë. A duhet të kryejmë vetëm funksionet që na diktohen prej përmasës biologjike, apo jeta është shumë më tepër se kaq? Si mund të jetohet një jetë ku çdo veprim është brenda një skeme të caktuar, i përgjigjet një funksioni të caktuar për të marrë një rezultat të caktuar? Kjo do të thotë të jetosh në laborator ose thënë ndryshe të vdesësh jetën, sepse dilemat dhe përpjekjet për të ndërtuar së brendshmi njeriun pushojnë së qeni. Në këtë gjendje njeriu përsos funksionin, humbet edhe bukurinë e mistikës së jetës.

Konak me Edisonin rreh të ecë shtigjeve ku zbulohet mistika e jetës për aq sa është e mundur një gjë e tillë, ku përballësh me dilemën që e bën njeriun të ndihet njeri. Është një sprovë që nuk duhet shmangur, as duhet tejkaluar, duhet jetuar.

Nëpërmjet gjuhës së thellë, të pasur me metafora dhe simbole, “Konak me Edisonin” është një thirrje për të jetuar me vetëdije të plotë, për të ruajtur lirinë personale dhe për të kërkuar një jetë me përmbajtje dhe kuptim përtej të dukshmes. Teksti ngre pyetje ekzistenciale që i mbijetojnë kohës dhe mbeten thelbësore në përpjekjen e përbërshme të njeriut për të kuptuar veten dhe botën.

Fjalët kyçe: liria, qëllimi, kujtesa, dashuria, arti (Poezia)

THEMELET

Të ekzistosh apo të jetosh?

Një njeri që nuk ndryshon asnjëherë, që noton gjithnjë në të njëjtat ujëra, që bën një jetë të ashtuquajtur lineare, që është i sigurt dhe i qartë për çdo gjë, që karakterizohet nga një gjendje pothuajse e njëjtë emocionale rezulton të ketë bërë vetëvrasje shpirtërore, pasi në një mënyrë apo në një tjetër ka flijuar botën e tij të brendshme. (17)

Të ndryshosh apo jo? Dilemë e kabershme e njeriut. Dilemë edhe më e madhe është se ç'lloj ndryshimi duhet të bëjë njeriu? Dhe për më tepër a është gjithmonë ndryshimi një gjendje që duhet patjetër të lidhet me pasurinë materiale? Një ndryshim që sjell pasurim material dhe rrënim shpirtëror nuk i duhet njeriut dhe as bashkësisë njerëzore. Një përlindje shpirtërore, një ndriçim i brendshëm që e çon njeriun udhës së mistikës së jetës është ndryshimi që duhet.

Shpjegimi e cënon thelbin

Sa më shumë t'i shpjegojmë gjërat, aq më shumë zvogëlohet hapësira e lirisë. (18)

Përsiatja mbi atë që lexojmë është kusht për të marrë nektarin dhe për ta shndërruar në mjaltin e mendimit dhe ligjërimin. Pa lirinë për t'u endur luleve mes rreshtave do të përfundonim në një diktaturë mendimi, ku njeriut i tregohet deri dhe si duhet ta shkruajë pikën e presjen, duke ia hequr mundësinë për të provuar emocionet e një pune që nuk i bindet skemave të thata, por përsiatjes dhe meditimit.

Nostalgjia është njohje

Kujtesa për gjërat e së shkuarës nuk është e rëndësishme të jetë kujtesë për gjërat siç kanë qenë. (Proust) (20)

Njeriu nuk duhet të përpigjet të kujtojë ngjarjet e së shkuarës pikë për pikë, por më shumë duhet të kujtojë se si e ka bërë të ndihet kjo ngjarje. Nëse ka qenë ngjarje negative do të ngjallë ëmbëlsinë e përpjekjeve për t'u ringritur. Nëse ka qenë ngjarje pozitive do të ngjallë emocione që sjellin përmallim dhe përpjekje për të parë gjithmonë anët e bukura të jetës edhe kur vështirësitë vijnë duke u shtuar. E rëndësishme është që kjo kujtesë të ngjallë tek njeriu energjinë për të ecur dhe punuar gjithmonë në anën e së mirës me shpresën se një ditë njeriu do të kthehet atje ku nisi udhëtimi që u kthye në kujtesë dhe nostalgji të pashlyeshme.

Gjana të vogla e të mëdha

Normalja apo normaliteti, në fakt, është një lëndinë me mijëra bimë e lule të ndryshme, ku secila është “normale” në llojin e vet, në ngjyrën, formën, aromën, shijen, freskinë e vet unike. E tillë është edhe normalja e njerëzve në lëndinën e përpjetme të asaj që njihet si jetë – në të vërtetë, shumë ma tepër se kaq. Nëse e vazhdojmë metaforën, ideologjia – e çfarëdo ngjyre qoftë – kërkon me i heqë të gjitha lulet në lëndinë e me mbjellë vetëm një lloj. (25)

Jeta është e bukur sepse ka diversitet, kontradiksion, ulje dhe ngritje, gëzime dhe hidhërime. Çdo gjendje ka thesaret e

veta që nuk mund të zbulohen pa kaluar përmes këtyre gjendjeve. Kjo e bën njeriun të marrë frymë, të gjallojë, të gëzojë mes luleve shumëngjyrëshe të jetës. Ideologjia kërkon njëtrajshmëri, bindje dhe beshtje. Të gjithë në rresht. Të gjithë në një linjë mendimi e prodhimi. Përfundimi, të gjithë skellevër të bindur e të shtuar e pa nerv rebelimi. Prandaj njeriu duhet të jetë syçelë ndaj farave të ligësisë së ideologjive kundërnjerëzore, se nëse arrijnë të zhvillohen i zënë frymën jetës dhe e zhveshin nga ngjyrat që i japin bukuri.

Gjana të magjishme

Çka asht poezia? – pyet William Blake, qe përgjigjja që jep: “Me pa një botë të tanë në një kokrrizë rane e Qiellin në një lule t’egër; me mbajtë pafundësinë n’pllambë të dorës e përjetësinë në një deşikë.” (29)

Poezia është art dhe si e tillë nuk mund të mos burojë nga thellësia e shpirtit. Nuk mund të ketë poezi me porosi. Nëse ndodh e sigurte që poezi nuk do të jetë. Do të jetë thjesht një kombinacion vargësh që më shumë do të ngjajnë me rezultatin e një eksperimenti, sesa shprehje e përjetimit shpirtëror të autorit. Poeti duhet të krijojë i lirë dhe bash atëherë kur e ndjen se muza ka trazuar zemrën e tij. Kjo është poezia. Ky është poeti. Shumë mund të shkruajnë vargje, po jo të gjithë sa shkruajnë poezi janë poetë.

Kujtesa është çlirim

Pakkush e vret mendjen për të kuptuar siç duhet. (31)

Epoka e ekonomisë së konsumit ka sjellë një dinamikë ndryshe në perceptimin

e njeriut mbi jetën. Njeriu rend të mbajë ritmin e punës së ndryshe s’postohet nga të tjerë syresh. Varfëria dhe shqetësimi për të ardhmen e trembin njeriun dhe prandaj zhytet gjithmonë e më shumë në përpjekje për të rritur shkallën e mirëqenies që e ardhmja të jetë më pak sfiduese. Ndërkohë koha rrjedh dhe i përfshirë nga kjo vorbull gjithmonë e më pak e vret vëmendjen për kuptimësinë e jetës, për thelbet mbi të cilat qëndron statura e njeriut si njeri.

Nga ndjenja te mendimi dhe anasjelltas

Zakonisht filozofët perceptohen si ata që mendojnë, ndërsa poetët janë gjithnjë ata që jetojnë në mbretërinë e ndjenjave. Por, natyrisht që nuk mund të jetë kaq e prerë, ose kaq “e thjeshtë”. Pothuajse në çdo libër filozofie hasim çaste poetike, sikundërse te shumë e shumë poezi gjejmë sentenca filozofike... (39)

Qenia njerëzore përskaj dualitetit trup–shpirt, apo thënë ndryshe tokë–qiell, e ka të pamundur njëtrajshmërinë përgjatë jetës. Prandaj jeta e njeriut është gjithmonë surprizuese me rrjedhën dhe drejtimet që merr. Përtej çdo profesioni ka gjithmonë pak lëndë filozofike dhe poetike tek çdo njeri. Më shumë poetikë në rini, e më shumë filozofi në pleqëri. Shumë njerëz humbin në rrjedhën e jetës, sepse nuk marrin guximin të thellohen mbi këtë konfliktualitet përbrendësor që duhet të shpërthejë si një vullkan. Është në natyrshmërinë e njeriut përsiatja, vrulli ndjesor që kërkon të gjejë udhë, duke u shkrirë si flori për të hequr skorjet dhe për të na dhënë një esencë që shkëlqen dhe vlen sa të jetë jeta.

Bëj asgjë

...çdo gjë që nuk rroket dot nga arsyeja, atëherë ose është e parëndësishme, për të cilën nuk kemi nevojë, ose nuk ekziston fare, dhe si e tillë duhet hedhur pas krahëve. (42)

Shenjtërimi i arsyes prej modernitetit si përmasa kyçe verifikuese e saktësisë përmes metodës eksperimentale ka përjashtuar shumëçka nga vlerat në jetën reale, me të vetmin justifikim; nuk është e saktë shkencërisht. Arsyeja është dhuratë e çmuar për njeriun, por si çdo gjë njerëzore është e kufizuar dhe jo shtruese në shpjegimin e çdo çështje. T'i japim vendin e duhur dhe për gjërat ku arsyeja është e pafuqishme për shpjegime ta lejojmë të dorëzohet dhe të pranojë pafuqinë e saj. Vetëm kështu njeriu do të gjejë paqe me veten dhe do të shpëtojë nga andralla pa fund.

Një përrallë, pastaj shumë përralla

Përrallat na kujtojnë se njeriu është çfarë ndien, do dhe imagjionon, e jo çfarë thotë dhe vepron, pasi këto të fundit janë të kufizuara nga rrethanat, këto bija besnike të kohës dhe hapësirës. (46)

Gjuba e njeriut shpesh diktobet nga rrethanat ku gjendet dhe çfarë mban zemra jo gjithmonë shprehet. Ka stepje në atë që njeriu flet, pasi në shumicën e herëve njeriu i rubet keqkuptimit të atyre që e rrethojnë, i drubet humbjes së miqve dhe kështu detyrohet të gdhendë fjalën dhe veprën. Jo se këto nuk duben gdhendur, por kur gdhendja bëhet në kushte dhe rrethana detyruese, pjesa më e pashprehur e njeriut fluturon tek sajaset e imagjinatës, alegoria

me botën e gjallesave dhe krijesat mitike pas të cilave fshihen mrekullisht emocione, ndjenja, përshtypje, karakterizime personalitetesh të cilat kumtojnë një botë tjetër, që pasi është endur bukur gjatë në brendësinë e njeriut ia ka dalë të gjejë rrugën për në botën e fakteve.

MURET

Vetëm fjala mundet me na mbrojtje prej fjalës

Ishte fjala e tre mashtruesve ajo që e magjepsi mbretin e përrallës së Andersen-it, dhe ishte po fjala që e çmagjepsi dhe i bani të mundur me u kujtuar se ishte lakuriq: “Mbreti qenka lakuriq!” (53)

Fjala ka fuqi të jashtëzakonshme. Timbri e bën të veçantë dhe të pazëvendësueshëm pushtetin e saj. Njeriu e ka pushtetin e fjalës, por vlera e saj qëndron tek qëllimi. Në pastë qëllime djallëzore njeriu i zhveshur nga morali nuk kursebet të përdorë një fjalor të ëmbël e magjepsës për të realizuar qëllimet e tij. Në qoftë shpirtmirë e zemërgjerë fuqia magjike e fjalëve të ëmbla do të zbutë zemrat e çorientuara nga ligjërimi djallëzor dhe do t’iu kumtojë të vërtetën pa zbulurime dhe miklime trulllosëse.

Kur të vjedhin emrat

Heidegger-i qaset gjuhës si “shtëpia e qenies”. Kur një ideologji merr pushtetin politik dhe vendos për një “transplant” të disa prej organeve kryesore të gjuhës, siç janë emrat, atëherë kjo shtëpi është boshatisë dhe na kanë mbetë vetëm muret. (58)

Ideologjitë janë çdoherë kërcënuese të lirisë. Kudo ku vendosin pushtetin e tyre, njeriu dhe shoqëria i nënshtrohen tjetërsimit. Qëllimi është ripërcaktimi dhe dhënia formë njeriut sipas kallëpit ideologjik, sepse kështu manipulohen dhe sundohen lehtësisht. Ideologjitë përpigjen të fshejnë kujtesën historike, trashëgiminë e vlerave, njerëzit e rëndësishëm që kanë spikatur me potencialin dhe sakrificën e tyre në shërbim të vendit, sepse për ideologjitë historia e lavdishme nis dhe mbaron me to. Ideologjitë e thajnë shpirtin krijues të njeriut. Nëse njeriut i heq lirinë e ke zhbërë si të tillë dhe pasandaj përmes frikës shtëpinë ku ai banon ta kthesh në burg, ku edhe mirëqenia më e madhe do të ishte vuajtje e pamatë.

Të rimendosh kuptimin e filozofisë

Në të gjitha traditat, sa në Lindje e sa në Perëndim, në trajta nga më të larmishmet si: në përralla, legjenda, mite, besime, besëtytni, gojëdhëna, letërsi e shumë domene të tjera, do pikasim me një lehtësi mbresëlënëse dëshminë madhore se njeriu është trup dhe shpirt. (68)

Tradita është e pakohë dhe e pavend edhe pse përsiatja mbi të zhvillohet në kohë dhe hapësirë. Rrethanat jetësore ndryshojnë, por dilemat ekzistenciale e shoqërojnë ngaberë. Në përpjekje për të gjetur hapësirat e përgjigjeve për të përballuar realitetin jetësor, urtitë e vjetra duben rianalizuar për të dalë me sinteza të cilat do ta ndihmojnë njeriun të orientohet në detin e dallgëve bashkëkohore.

Ridiskutim mbi metodën

...roli i një autori është të përpunojë esencën, ta hollojë, pasi pjesa më e madhe e njerëzve nuk e përtypin ndryshe, prandaj lind nevoja që një e vërtetë e caktuar të vishet me një ngjarje. (73)

Dija është dhuratë. Thëllimi në të është privilegj. Nuk sakrifikon kush për dijen përveç atyre që janë të dashuruar me të. Shumica as që do ta marrin mundimin të ulen e të lexojnë gjërat më bazike. Të tjerë syresh nuk duan të thellohen në dituri sepse e quajnë humbje kohe dhe humbje kohe do të thotë humbje e parave. Për t'i bërë më të afërt principet me masën e njerëzve të diturit dubet të jenë të urtë e të matur, e nëse nuk janë të tillë nuk janë as të ditur dhe as kanë për t'i dhënë njerëzve shenjat e udhëve të tokës dhe të qiellit.

Të çlirohesh nga autoriteti

Sa më shumë të zërë vend brenda qenies një autoritet i caktuar, aq më e thellë bëhet kriza. Sikundërse sa më shumë të pavarësohemi nga autoriteti, aq më shumë do e jetojmë lirinë, që është gjendja në të cilën lindim. (81)

Njeriu është qenie që është krijuar për të qenë i lirë, por jo të gjithë e mbajnë peshën e lirisë, prandaj është i prirur për ta dorëzuar lirinë tek autoriteti dhe të çlirohet nga frika e përgjegjësive të vendimeve. Sa më shumë t'ia besojë jetën e vet autoritetit, aq më shumë e humbet jetën. Autoriteti kënaqet nga ushtrimi i shtypjes ndaj të palirëve, ndërsa të palirët ndihen të mikeluar që autoriteti u kushton vëmendje dhe shtypja ju duket dhurata më e madhe që marrin prej tij. Janë verbërisht të bindur ndaj

autoritetit. Nuk dyshojnë në vërtetësinë e premtimeve të tij dhe janë të gatshëm për çdo sakrificë për të rënë në sy të autoritetit si më të devotshmit në shërbim ndaj tij. Qenie të tilla nuk mund ta vlerësojnë asnjëherë lirinë, për rrjedhojë as jetën. Jeta e tyre ka kuptim vetëm kur marrin urdhra dhe kur i zbatojnë urdhrat si misionin më të madh të jetës së tyre. As nuk duan të mendojnë dhe i tremben asaj fare të natyrshshmërisë që i grish hera – herës për të dalë nga kornizat. Kësisoj pa u çarë ende lëvozhga e farës së lirisë e asgjësojnë, duke asgjësuar vetë jetën. Pjesa tjetër është vetëm përmbushje ditësh mbi këtë botë.

Mbi lirinë, frikën dhe sigurinë

Asgja nuk zgjat përgjithmonë, as jeta, as ato vlera që bajnë dallimin midis të jetuarit dhe të gjallarit. Ato duhen rifitu vazhdimisht, prej çdo brezi të ri, pikërisht si vetë jeta, që vazhdon falë brezit të ri! (85)

Pas 100 viteve jetë të tjera breznit do të trashëgojnë tokën. Njeriu reagon ndaj jetës, ashtu siç është formuar. Vlerat apo antivlerat nuk do të shuben me ndryshimin e brezëve. Ato do të vazhdojnë udhëtimin në këtë botë siç kanë bërë qysh nga thellësia e historisë. Çdo shekull të ri i takon për detyrë të vazhdojë të qëndrojë në kufijtë e së mirës dhe së keqes. Përpyekja për të mbetur njeri është esenciale dhe pa këtë esencë jeta e njeriut nuk do të kishte kurrë aromë. Aq sa të zgjasë jeta, të jetojmë për të ndjerë aromën më të mirë.

Mbi drejtësinë, lirinë dhe paqen

Qysh nga njeriu i parë e deri më sot, në një mënyrë apo në një

tjetër ne vazhdojmë të përballemi me sfidën për të zgjedhur ndërmjet lirisë dhe lumturisë (sigurisë), gjë që e ka trajtuar me aq art e urtësi Dostojevski te Vëllezërit Karamazov, ku dialogu mes kryepeshkopit dhe Jezuit kulmon me “akuzën” e kryepeshkopit ndaj Jezuit: “Ti i ke mësuar njerëzit të jenë të lirë, por ata nuk e duan lirinë; ata duan të jenë të lumtur.” (93)

Pa liri nuk ka njeri. Është liria pa është njeriu i tillë, në të kundërt do të kishim tjetër histori. Kjo liri nuk mund të dalë në pah po qe se jeta do të kishte vetëm një përmasë. Dubet kontradikta mes të kundërtave, vlerave dhe antivlerave që njeriu të njohë, kuptojë dhe çmojë lirinë. Të jesh i lirë është barrë e rëndë, prandaj shumica e braktisin atë në emër të sigurisë. I tremben së ardhmes dhe duan që të kenë garanci bukën. Liria që kuptohet si liri për të mbushur stomakun është keqkuptim fatal për njeriun, sepse lumturia nuk do të perceptohet më si paqe shpirtërore, por si kënaqësi e stomakut dhe përfundimi nuk do të jetë aspak ai i dëshiruar.

Mbi kujtimet dhe historinë

Lufta dhe paqja, apo Të mjerët janë edhe libra historikë, por duke qenë se nuk kanë qëllim një gjurmim “sistematik” faktesh, ato na lidhin me thelbin njerëzor në kushtet e historisë, domethënë në kushtet e kohës dhe hapësirës. (97)

Njeriu bën historinë e tij. Kalimi i viteve e ndërton atë. E në gjithë historinë e përpyekjeve mbi tokë, njeriu shpalos atë çfarë mban së brendshmi. Shprehja e shpirtit njerëzor përmes veprimeve nuk mund të jetë

një kronologji e ftohtë ngjarjesb. As edhe një renditje gurësh mozaikë. Historia e njeriut si qenie gjen më shumë hapësirë tek arti i letërsisë, sesa tek vetë historia. Përtej të gjitha ngjarjeve që ndodhin në jetën njerëzore, episode të caktuara janë ato që lënë gjurmë, aq sa dhe harresa nuk mund t'i fshijë prej shpirtit njerëzor. Dhe është pikërisht kjo lënda prej së cilës përpunohen dhe dalin në dritë vepra të mëdha letrare pavarësisht subjektit historik që mund të shijellojnë. Ndryshe arti i tyre do të ishte një hiç dhe nuk do të ngjallte asnjë emocion njerëzor tek lexuesi. Përtej kohës dhe hapësirës ku ndodhin të gjitha ngjarjet, përmasa shpirtërore e vlerave njerëzore nuk njih as kohë dhe as hapësirë dhe kthehet në burim të pashtersbëm të përpjekjeve për të njohur njeriun.

Personazhe në udhëkryq

Personazhe në udhëkryq, pa të nesërme, pa të djeshme. Personazhe pa bindje, pa peshë, si një zarf në stuhi. (99)

Ideologjitë dhe sistemet politike që kanë si qëllim parësor sundimin me çdo mjet, nuk duan njeriun me personalitet, me principe dhe vlera që i japin peshë njeriut në vetvete dhe në shoqëri. Principet janë të shenjta dhe kushdo që e jeton jetën nën hijen e tyre nuk mund të luhet si lavjerrës. Njeriu ka një të shkuar, ka një gjenealogji vlerash. Nuk mund të jetë qenie që mbin nga kërpuhja. Trashëgimia që i rrijedh ndër deje i jep edhe më shumë peshë e rëndësi. Është i qartë se nga njen dhe i kthjellët se për ku shkon. Nuk përhumbet në udhëkryqe ideologjish derisa t'i sosit jeta.

Jo përmes meje

Thellë-thellë të gjithë e dimë se çfarë duhet me ba, se nga me ia fillu, por ngaqë nuk na pritët, ngaqë na sosit shpejt durimi, ndjekim rrugën e shkurtër, kërkojmë me ndryshu botën, me shpresën se bota ka me na ndryshu edhe ne! (104 – 105)

Një nga mangësitë e njeriut, mungesa e durimit. Durimi është virtyt i lartë dhe jo të gjithë kanë durim për të patur durim. Proverbi na thotë se rruga e shkurtër të nxjerr gjatë, duke vënë në pah vlerën e durimit dhe njëkohësisht rëndësinë e ndryshimit të ngadaltë, por të gëbendur fort përgjatë jetës. Kushdo që ka nxituar për të marrë frute përpara stinës së pjekjes së tyre ka shijuar vetëm thartësi dhe hidhtësi. Mungesa e durimit është dërrmuese për njeriun. Pa durim, pa pritje, ka vetëm rrugë të shkurtër dhe të shpejtë që çojnë drejt rrënim.

Dizajn: si ta shndërrosh shpirtin në trup

Sa më shumë joshje aq më pak arsyetim, aq më pak mendim. Sa më shumë joshje, aq më shumë tufëzim, aq më pak individualitet. (108)

Arsyeja është dhuratë e çmuar për njeriun. Të menduarit është një akt i lartë analize dhe sinteze. Jo çdokush ecën rrugës së vështirë. Syresh duan përjashtësinë dhe shkëlqimin e rremë të gjërave të jetës. I nënshtrohen fuqisë së grupit shoqëror dhe ndihen më rehat si pjesë e tij sesa si individualitet dhe personalitet. Joshja që gjërat e rreme i bëjnë shpirtit njerëzor e topitin arsyen, ia humbin individualitetin, gjenealogjinë e vlerave dhe e shndërrojnë në pjesë amorfe të masës.

Petkat e realitetit

Në njëfarë mënyre, realiteti është si uji, i cili merr trajtën dhe ngjyrën e enës në të cilën hidhet. Kjo enë është fjala. (113)

Fjala bëhet shtëpia në të cilën banoni – thoshte dikur Hafizi. Njerëzit e lexojnë realitetin sipas natyrës së zemrave dhe shpirtërave që kanë. Nëse njerëzit flasin mirë do të përpiqen të shohin nga jeta anët e saj të bukura. Nëse do të flasin keq do të shohin vetëm anët e vështira dhe të errëta të saj. Gjendja në të cilën gjendet njeriu ndikon në pozitivitetin apo negativitetin e mendimeve të tij, për rrjedhojë edhe në realitetin jetësor ku jeton.

Kulturizëm

Nëse duam të dimë se cili është botëkuptimi i një komuniteti/ shoqërie, shihni se cila është ndërtesa qendrore e vendit/qytetit të tyre. Por, përveç kësaj, duhet të shihni edhe a është funksionale ajo ndërtesë apo e kanë kthyer në muze. E nëse ka ndodhë kjo e fundit, atëherë qendra është zhvendosë, sepse paraprakisht kanë zhvendosë botëkuptimin. (117)

Proceset historike janë “të pamëshirshme” si mbi njeriun, shoqërinë, ashtu dhe urbanistikën. Idetë janë ato që vendosin në lëvizje njeriun dhe historinë. Sa më pranë natyrshmërisë idetë mbi mënyrën e të jetuarit, aq më ruajtës i traditës është njeriu. Sa më i korrkolepsur me ideologji që ushqejnë hedonizmin, aq më shkatërrues i traditës do të jetë.

Kur zbulimi është mbulim

Format më të thella të komunikimit janë pa fjalë. (121)

Fjala është ura përmes së cilës njeriu komunikon me tjetrin. Ura mbart thellësinë shpirtërore të njeriut dhe shpreh në të gjithë elementët e saj ngarkesën emocionale të genies që flet. Përtej fjalëve ka gjithnjë gjendje që nuk mund të shprehen përmes tyre, pasi fjalët shpesh shtrihen para stubive shpirtërore. Do të mjaftonte një shikim, një gjest dhe gjithçka do të shprehej më së miri në heshtje, në heshtjen e thellë të shpirtit pa fjalë.

VOTRA

Kujtesë për Kujtesën

Kështu është fare e kuptueshme ajo që thotë Borges-i, se të gjithë mësuesit e mëdhenj të njerëzimit kanë dhënë mësimë gojarisht, sepse kujtesa ruhet duke i përmendur vetes dhe njëri-tjetrit të tjera gjëra nga ato që i takojnë rrjedhës së përditshme, pra jo vetëm duke i shkruar ato, por duke i biseduar. (127)

Që nga koha kur njeriu filloi të përdorë shkrimin, u duk sikur humbi vlera e kujtesës njerëzore që përcillet gojarisht nga një brez në tjetrin. Shkrimi ka rëndësinë e vet, por edhe mësimi i moralit përmes eposit, baladave, këngëve, përrallave, rrëfjave, tregimeve, proverbave, historive të rrëfyera plot ngjyra e pasion, ka patur dhe do të ketë vlerën e vet në edukimin e njeriut dhe ruajtjen e kulturës. Përmes shkrimit është më e lehtë ruajtja e kulturës, kurse përcjellja gojarisht e saj merr një tjetër vlerë. Njeriu që e përcjell brez pas brezi nuk është thjeshtë një kopjues shkrimesh të lashta, por përcjellës i një arti të hollë e të gdhendur në shpirtin njerëzor.

Vetëkënaqësi dhe mbijetesë

Shtëpitë braktisen gjithnjë e më shumë, duke u shndërruar në dhoma hoteli, kurse aeroportet, metrotë, stacionet e trenave dhe autobuzëve banohen përherë e më shumë nga individë të ngarkuar me vetmi, që duan vetëm të ikin. Me të mbërritur diku, sërish duan të ikin. Destinacioni për ta është vetëm një justifikim, ose një maskë për atë që s'janë në gjendje ta tregojnë. (131)

Shtëpia është hotel. Ide që ka bërë vendin e saj tashmë në shoqëri dhe për rrjedhojë njerëzit nuk po e shohin më shtëpinë si vendin e dashurisë, sakrificës, debatit, faljes, butësisë, përkujdesjes. Shtëpia nuk është vendi ku t'i pushon dhe nuk të thotë njeri çobu e dil prej këtu. Shtëpia është vendi me të cilin të lidhin shumë gjëra, pa të cilat jeta është nonsens. Shtëpia nuk dubet të jetë vendi ku këmbët të çojnë me përtim. Rrjedha e ngjarjeve bashkëkohore nuk dubet të na heqë kënaqësinë e shtëpisë si frymë, si dashuri e përkujdesje. Muret dhe madhështia e jashtme nuk kanë rëndësi nëse brenda tyre nuk ka frymë. Jeta që gjallon brenda mureve të shtëpisë nuk mund të kërkohet ndër vende të tjera.

Çdo utopi përfundon në distopi

Planifikimi, sipas të gjitha gjasave, është kërcënimi më i madh ndaj lirisë, dhe për pasojë edhe ndaj jetës. (133)

Thelbi i njeriut është liria. Jeta e njeriut dubet të rrjedhë si uji që në lirishtëri çan udhën e tij dhe pikturon peizazhet

jetësore si mozaik shumëngjyrësh. Sistemet politike që i tremben fuqisë së lirisë së njeriut përpigjen të orientojnë energjinë njerëzore drejt skemave të caktuara, në mënyrë që kreativiteti i njeriut të konturohet sipas planit që vjen nga lart, nga autoriteti sundues i shoqërisë që në fund të ditës ka interes vetëm për të zgjatur sundimin. Planifikimi mund të nxjerrë një shfaqje perfekte të njeriut në shoqëri, por është shfaqje pa shpirt. Jeta pa shpirt është e zymtë sado "arritje cilësore" të shënojë sistemi politik në tabelën e suksesëve.

Nga njëri kafaz në tjetrin

Nëse nuk jemi të drejtë, nuk do të na ndahen "reformat" nga shpina...(138)

Shoqëria ndryshon. Bota ecën para. Tabutë duhen thyer. Nuk jemi në kohën e Baba Qemos. Duhet reforma. Vetëm reformat do të na çojnë përpara. Ecja përpara duket si ishull i largët ku dubet mbërritur me patjetër dhe nuk ka rëndësi se si. Duke rendur pas reformave gati të të gjitha fushave të jetës, harrohet apo bëhet sikur se vlera e reformave nuk mund të qëndrojë aspak pa qenë njeriu i drejtë. Dhe njeriu i drejtë nuk ka nevojë për reforma për t'u bërë më i mirë. Vetë drejtësia është themeli, rrënja. Nëse një pemë ka rrënjën e kalbur sado krasitje dhe spërkatje me preparate t'i bësh, nuk ka për të dhënë kurrë frutat që dëshiron.

Ndërmjet komedisë dhe tragjedisë

Fatkeqësia më e madhe për një shoqëri është një elitë e cila u imponon njerëzve një mënyrë tjetër

të menduari dhe (si rrjedhojë) të jetuari; domethënë, që i mbivendoset shoqërisë dhe karakterit të saj jo që ajo të bëhet më e mirë, por më e ndryshme. (143)

Në shoqërinë ku elita bëhet njësh me pushtetin autoritar shoqëria merr goditjen e knockout. Elita kulturore parimisht duhet të jetë opozita më e fortë e çdo sistemi politik, po veçanërisht e sistemeve totalitare. Është ajo që duhet të mbjellë farat e rezistencës ndaj sundimit dhe tjetërsimit të njeriut për interesa të sistemit politik. Kur elita zgjedh të shpëtojë lëkurën e vet, atëherë çdo produkt i saj do të jetë politik. Shoqëria nuk do të drejtobet nga thelbet, por do të drejtobet drejt hijeve që elita do t'i trajtojë si vetë e vërteta. Si rezultat do të kemi një shoqëri që nuk korrigjon dhe përmirëson veten me ndërgjegje të lirë, por një shoqëri që ndryshon për të mirën e sistemit politik në aleancë me elitën kulturore.

Mjegulla nuk është aleatja e ujkut

...si mundesh me e dashtë botën kur nuk don vendin tand? (148)

Shumë syresh rendin ta kryqëzojnë vendin e tyre, duke e cilësuar si të mjerë dhe të pamerituar për të ndërtuar jetën. Ushqejnë antipati të vazhdueshme ndaj shtëpisë së tyre, sepse vendi është shtëpia, dhe ngrejnë në qiell jetën në vende të tjera. Vendi ku lind e rritesh nuk është thjesht një pjesë toke. Është vetë jeta. A mund ta urresh veten dhe të duash tjetrin më shumë se veten? Kush nuk do veten, nuk mund të dojë as tjetrin. Të duash veten nuk do të thotë të mahnitesh me të dhe të kalosh në dëlir. As nuk duhet kaluar në kompleks

inferioriteti, pasi çdokush në këtë botë ka vendin dhe fatin e vet. Para se të jemi internacionalistë duhet të duam shtëpinë tonë. Dhe nëse e duam me dashuri të pastër, nuk do ta vjedhim e plaçkitim si kaçakë të krisur e të pabindur.

Dukja, trupi dhe turpi

...nuk ka rëndësi se si je, por si dukesh... (149)

Ditët e sotme janë tepër sfiduese në pjesën e dukjes. Vlerësimi dhe pranimi nga opinioni publik varet shumë nga mënyra se si dukesh, se si prezantobesh. Njerëzit gjykojnë tjetrin që nga mënyra se si vishet, se si ushqehet, nga pasuria që zotëron dhe nga mënyra se si e prezanton në publik fuqinë e pasurisë. Në qofsh në rregull me metrin vlerësues të opinionit publik je për në pedestal, në të kundër nuk vlen një grosh. Është një trysni e jashtëzakonshme për njerëz të cilët vuajnë të jenë me patjetër në qendër të vëmendjes së opinionit publik dhe të marrin lavdet e tij. Në e paç këtë qëllim, sido që të ndihesh, do ta detyrosh veten të sillesh në shumë mënyra të cilat jo që nuk e ndihmojnë mirëqenien shpirtërore, por e sakatojnë nga të gjitha drejtimet derisa t'i nënshtrobesh tëbuajësimit.

Fetarë pa fetari

Ka një prirje dhe një përpjekje për me e ba fenë pjesë të kulturës masive apo të botës së spektaklit. (152)

E shenjta duhet të mbetet dhe të nderohet si e tillë. Nuk mund ta zbresim nga fronti dhe t'ua shërbejmë masave ashtu siç masave iu pëlqen ta shohin të shenjtën. Kompromiset janë për të gjetur zgjidhje mes njerëzish, dhe jo për të përshtatur

të shenjtën me shijet e masës. Nuk është e rëndësishme se sa do ta besojnë dhe ndjekin të shenjtën, por si ta do kuptojnë dhe jetësojnë atë që kërkon e shenjta për të qenë njeri. Spektakli, fanfarat, banderolizimi nuk i shkojnë bukurisë së të shenjtës, pasi çfarë është e bukur pa ndërhyrjen e njeriut nuk ka nevojë të zbukurohet nga njeriu.

Fjalë që vuajnë nga mungesa e përdorimit

“Caqet e gjuhës sime janë dhe caqet e botës sime”, na kujton Wittgenstein-i. (156)

Njeriu është i kufizuar si qenie. Gjuha e folur dhe e shkruar është tipar shquës i njeriut. Megjithatë dëshira e njeriut është që të zotërojë dhe shprehë shumë disiplina studimi, mbetet gjithmonë i kufizuar. Fjalët janë të kufizuara dhe shkojnë në përputhje me gjerësinë e botës personale. Çdokush shpreh prej vetes aq sa e pasur është edhe gjuha e mësuar prej tij, për rrjedhojë njeriu e ka të pamundur ta dalë nga një botë ku çdoherë që mendon se ka kaluar një cak, shfaqet sërish një cak tjetër që e përqarkëson. Sa më i gjerë caku, aq më larg sheh njeriu. Sa më i ngushtë caku, aq më vështirë e ka njeriu të njohë.

V. ANDRRAT

Etika dhe estetika përbëjnë një binom

Është qëllimi, domethënë aspekti etik, që përcakton mandej edhe dukjen, pra aspektin estetik. (162-163)

Çdo vepër varet nga qëllimi, madje edhe vetë jeta. Qëllimi përcakton mënyrën e të jetuarit dhe mënyra e të jetuarit përcaktohet nga idetë që njeriu beson dhe i ka ontologjike. Qëllimi i pastër dhe i singertë e ngre etikën në shkallën më të lartë të vlerës. Etika e nivelit të lartë bën që dhe estetika të jetë e zbukuruar me ngjyrat shpirtërore të etikës. Kushdo që dëshiron jetë të bukur, duhet të pastrojë qëllimin.

Kush janë personazhet e Hockney-t?

Nuk ka asgjë tërheqëse – kjo është tërheqja. (167)

Njeriu është i prirur të ndjekë mistikën si një përçapje drejt asaj pjese të jetës që nuk është shpalosur ende përmes gjërave të njohura. Ajo ushtron një tërheqje magnetike ndaj njeriut duke e çuar shtigjeve të reja. Po çfarë ndodh me njeriun kur gjithçka bëhet e vjetër? Kur nuk ka më asgjë nga jeta e kësaj bote që ta grisë për diçka më të lartë se konsumi material? Atëherë kjo është tërheqja e cila e vë njeriun në lëvizje për këtë mungesë të mistikes në jetën e përditshme. Shqetësimi për mungesën e saj me siguri do ta tërheqë shpirtin njerëzor në udhën e parëhershme.

Fluturimi i Chagall-it

Por, mesa duket, personazhet e Chagall-it nuk i besojnë kësaj parajse në tokë, ndaj dhe fluturojnë, duke iu dhënë Qiellit. (172)

Ëndrra e vjetër e njeriut është Qielli. Edhe pse jeta mbi tokë e tërheq njeriun me zbukurime që e ftojnë për ta shijuar atë, shpirti njerëzor mbetet gjithmonë i uritur për të ecur rrugëve të qiellit. Sado mirëqenie të zotërojë njeriu dhe sado i

debur të jetojë në të, ka gjithmonë diçka që e ngacmon dhe e bren së brendshmi. Është kjo parehati shpirtërore që e bind se ëndrrat me parajsë tokësore praktikisht janë të pamundura. Dhe atë që njeriu nuk e gjen dot në tokë e kërkon në Qiell. Prandaj fluturimi është çlirim i shpirtit nga përmasa biologjike e trupit. Materia i kethebet tokës, shpirti Qiellit.

Para shkrepjes

Por, a buzëqeshim kur buzëqeshim teksa bëjmë një foto? (178)

Buzëqeshja është bukuri e njeriut. Ajo shpreh botën shpirtërore dhe karakterin e njeriut. Pas një buzëqeshje qëndron një shpirt i pastër, i singertë, i gëzueshëm, por mund të qëndrojë dhe një shpirt tallës, qesëndisës dhe hipokrit. Pavarësisht gjendjes shpirtërore dhe karakterit, njeriu përpiqet të buzëqeshë kur del në foto. Është një e dhënë që tregon shumë për atë çfarë njeriu ka realisht nevojë në jetë. Edhe pse shpesh buzëqeshjet në foto janë një tentativë për të buzëqeshur në çast, duben përprjeje që buzëqeshjet të mos jenë vetëm për foto, për dukje dhe momentale. Dubet punuar me mirësi që të qeshë shpirti dhe jo vetëm buzët e sforcuara.

Konak

Gjendja e paqtë e mjediseve të brendshme (home) po bëhet çdo ditë e më shumë një luks që e gëzojnë pak njerëz...(181)

Mishmasbi shoqëror në epokën e mbizotëruar nga ethet materialiste ku boshti qendror është rendja për të shijuar jetën në përmasën biologjike me shpresën se

do të përfitohet edhe diçka në atë shpirtërore e ka trazuar njeriun aq shumë sa që gjendja e paqtë është bërë si uji në shkeretëtirë. Kjo pasqyrohet kudo ku shkel këmba e njeriut modern. Ankthi dhe trazimi i vazhdueshëm shpirtëror e bën të mendojë se tjetri është problemi, ngaqë njeriu që principet i ka mall vitrine justifikon veten. Kësisoj të qenit në paqe me veten është një gur i çmuar që gjendet rrallë.

VI. MUGUJT: FILLIM PRANVERE NË OBORR

...me lexu don me thanë ma shumë Dritë. (186)

Padija është errësirë që njeriun e bën të jetojë me iluzionin se dija është e panevojshme për një jetë të ndriçuar së brendshmi. Njeriu u lartësua në sajë të diturisë dhe nuk ka rrugë tjetër përveç dijes së njëmendtë për të ecur i ndriçuar edhe në anën e patreguar të hënës. Mësimi është mënyra, leximi është rruga, kuptimi është metoda dhe përcjellja e dijes tek brezat e rinj është jeta. Të lexuarit është fuqia që çel portën e dritës. Sa më shumë lexim, aq më shumë çelen kanatet.

Shpeshherë e sakrifikojmë të tashmen tonë për hir të një të ardhmeje që nuk vjen kurrë siç e parashikojmë. (190)

E ardhmja mbetet sfida e njeriut. Mendimet e tij shkojnë tek përfytyrimi se si do të jetë dhe energjinë e tij rinore e shkerin për të ndërtuar një të ardhme që asnjëherë nuk vjen ashtu si e projektton. Këtë e kupton jo shumë herët, por tashmë vitet më energjike kanë shkuar bashkë me shqetësimet e projekteve të këshjtjellave mbi orën me rërë të së ardhmes. Mbetet realiteti

dhe përvoja. Prandaj sa më shumë kalon jeta aq më shumë njeriu fokuset tek e tashmja, sepse as e shkuaara nuk mund të ndryshohet dhe as e ardhmja nuk mund të kontrollohet.

Jo çdokush mund të rrëfejë. (197)

Shumë syresh i mbushin mendjen vetes se mund të jenë të zotë në artin magjik të oratorisë. Rrëfimi, kumtimi, tregimi nuk është një ripërsëritje e thjeshtë e asaj që ke lexuar. Mund të jetë edhe e tillë nëse i qëndron besnik të mësuarit mekanik, por rrëfimi, kumtimi, tregimi do të jenë tepër të thatë dhe pa kurrfarë shije. Të rrëfesh do të thotë të përfshihesh, të ndjesh në zemër rrëfimin, të hysh në lëkurën e shkrimtarit, artistit, oratorit, filozofit, psikologut, historianit, shkencëtarit. Çfarë del nga zemra shkon në zemër. E jo të gjithë flasin me zemër, prandaj shumë flasin, por pak rrëfejnë e kumtojnë.

Nji përkthyes i mirë nuk përkthen thjesht fjalët, por kuptimet. (200)

Përkthimi është art jo i lehtë. Në epokën digjitale po ndodhin ndryshime që as ishin menduar më herët, por në përkthimin e shpirtit njerëzor teknologjia nuk është në domenin e vet. Përkthyesi mjesh tëror e bën një autor të flasë sikur të ishte rritur me gjubën në të cilën përkthehet. Përkthyesi është një autor i dytë, pasi në veprën e përkthyer tashmë ka lënë gjurmët e veta edhe shpirti i tij. Kësisoj vepra e përkthyer do t'i shërbejë më mirë kulturës së lexuesit, pasi do t'i vijë më natyrshëm, më pranë pamësisë botëkuptimore. Duben vlerësuar mjeshtrat e përkthimit.

Qytetërimet janë në një garë të pashmangshme me njëri-tjetrin, ndërsa kulturat kanë vetëm një garë: me vetveten. (202)

Qytetërimet janë në garë me njëri – tjetrin për të treguar fuqinë e zhvillimit të gjërave tokësore. Shkenca, teknika, financat, në shumicën e kohës janë përdorur për të zgjeruar territore, urbanizim, objekte madhështore në arkitekturë si shenja të fuqisë së tyre. Ndërkohë kultura nuk shqetësohet dhe aq për madhësinë e materies. Asaj i intereson njeriu, personaliteti i tij, vlerat dhe principet që i bëjnë të mundur njeriut të jetojë në paqe dhe harmoni me veten dhe kozmosin. Thënë ndryshe, njeriu është në garë me tjetrin për zotërim pasurie kur mendimi i tij është materialist, dhe është në garë me veten kur idetë e tij janë metafizike.

...dashuria është e mundur vetëm në sajë të dashurisë. (207)

Dashuria është e rrethuar me mjaft gjëra materiale, duke besuar gabimisht se ajo qëndron në këmbë në sajë të tyre. Dashuria ndaj materies është natyrore tek njeriu, por dashuria e njëmendtë që të bën njësh me Qiellin, që të bën të bësh sakrifica që për materien nuk do të bëheshin kurrë është e mundur vetëm në sajë të kuptimit të njëmendtë të vetë dashurisë si esenca e shpirtit. Shpirti është esenca e njeriut, është jeta. Pa jetë nuk ka dashuri, po edhe pa dashuri nuk ka jetë.

Pema dhe hija e saj nuk janë e njëjta gjë. (210)

Hija është përkthyes e origjinalit. Ajo i ngjan në formë origjinalit, por esenca është tjetërkund. Në këtë botë ku dyert e

perceptimit shqisor janë të kufizuar ndodh shpesh që njeriu të rëndë pas hijeve. Është rëndje ku njeriu shter energjitë dhe barron të ndalet e të mendojë mbi idetë. Harron të ndalet e të meditojë mbi atë që i jep jetë dhe dritë. Xhelaludin Rumi na thotë: “Nëse je duke kërkuar dritën, ndalu. Ti mund të jesh vetë drita”

Ata që nuk nderojnë paraardhësit e tyre, nuk duan t’ia dinë as për pasardhësit. (211)

Shumë syresh sot e shpërfillin trashëgiminë e brezave të kaluar, qoftë kjo edhe e paraardhësve të tyre në linjë gjenealogjike. Të yshtur nga idetë e të ecurit para dhe të lënit pas të së vjetrës, të mikluar nga forca që paskan për të thyer tabutë e së kaluarës dhe për t’u hedhur pa kushte në krabët e së resë, kanë humbur shumëçka nga nderimi i trashëgimisë së të parëve. Njerëzimi ka mbërritur këtu ku është sot në sajë të qindra e mijëra supeve të paraardhësve. Ndoshta do të ishte shumë më para nëse në periudha të caktuara nuk do të kishte shkatërruar të vjetrën në emër të ndërtimit të së resë. Ata që e bëjnë këtë jo vetëm që nuk kanë për të ecur para, por nuk kanë për të lënë as edhe një botë më të mirë për pasardhësit e tyre. Nderimi ndaj paraardhësve, ndaj virtyteve të tyre dhe kritika e drejtë ndaj gabimeve të tyre, është kusht që të ndërtohet një brez që do të jetë një shkallë e fortë mbështetëse për të patur një botë më të mirë dhe jo premtime boshe për një botë utopike.

Homeri ishte i verbër, por hodhi shumë dritë mbi njeriun, duke pa ma shumë se çdo poet tjetër. (214)

Verbëria e syrit e kufizon njeriun nga

shumë gjëra në jetën e përditshme, por nuk ia shuan intuitën. Verbëria e vërtetë është ajo e zemrave, ku edhe pse sytë shobin nuk mund të depërtojnë në thellësinë e shpirtit njerëzor. Nga kjo e fundit dubet të ruajë veten njeriu.

“Fjala reformë shërben për të mbuluar një proces të fshehtë vjedhjesh të trashëgimisë kombëtare.” (Sollzhenjicin) (220)

Në emër të reformave pushteti politik i jep gjithmonë e më shumë mundësi dhe hapësira vetes që të gllabërojë atë që njerëzit kanë ndërtuar për breza të tërë. Në emër të premtimeve për të ardhmen e ndritur që na pret nën qeverisjen e aksh partie duhen patjetër reforma se ndryshe nuk ecet para. Dhe në fund reformat cenojnë apo shkatërrojnë pikërisht ato gjëra që i vështirësonin sundimin pushtetit politik, por ndërkohë terreni është përgatitur dhe masat nuk i kushtojnë rëndësi ndryshimeve, sepse presin të ardhmen e lumtur. Kur kthjellohen mbi vjedhjen e personalitetit, kulturës, pasurisë është tepër vonë. Disa zgjedhin t’i shërbejnë pushtetit, të tjerë pajtoben me fatin dhe pakica rebelimin ndaj vjedhjes së dinjitetit përmes reformave.

Disa prej poezive që nuk janë shkru asnjëherë, janë pikturu; sikundërse disa prej pikturave nuk janë pikturu asnjëherë, por janë shkru. (222)

Fuqia shprehëse e njeriut është sa e kufizuar, po aq edhe e paparashikuar. Bota shpirtërore është një mister dhe asnjëherë nuk jemi të sigurtë se çfarë gjërash të çmuara do të dalin prej llavës shpirtërore, apo se sa pasuri të tjera do të ngurtësohen

si artefakte në muret e shpirtit për të pritur kobën kur muzat t'i nxjerrin prej aty përmes artit dhe formave të ndryshme të të shprehurit të tij.

Czeslaw Milosz shkon deri aty, sa thotë se, “armiku i vërtetë i njerëzimit është përgjithësimi.” (227)

Ekziston një prirje gati e përgjithshme për të bërë përgjithësime kur vlerësojmë një shoqëri, një komb, një krabinë, një fis, një fe. E keqja e përgjithësimeve është krijimi i një situatë mbyltese dhe të pashpresë në mendjen dhe zemrën e njeriut. Duket sikur të gjithë i ka mbuluar e keqja dhe i vetmi që ka shpëtuar është përgjithësuesi që as vetë nuk e di si do t'i shpëtojë së keqes. Kushdo që lexon dhe njeq historinë, filozofinë dhe psikologjinë e popujve të shkruar, do të vërejë me patjetër se kjo botë nuk mund të jetë absolutisht e mirë, apo absolutisht e keqe. Është mejdan ku e mira dhe e keqja përpiqen të mbiqotërojnë ndaj njëra – tjetrës. Kështu ka qenë dhe kështu do të mbetet. Prandaj njeriu nuk duhet të bjerë pre e përgjithësimeve, por të përpiqet të shohë të mirat e një shoqërie dhe të gjejë të ngjashmit e vet, edhe në qoftë se janë vetëm pak.

Fjala vjen, nëpërmjet pritjes së iftarit, agjërimi na kujton se durimi ose munda i ka frytet e amla, se me jetu don me thanë me duru, e me

duru nuk nënkupton me u dorëzu, por me vazhdu. (229)

Të jetosh nuk do të thotë të qëndrosh nën hijen e pemës dhe të presësh të të shërbejnë frutat më të zgjedhura. Jeta është një hapësirë ku njeriu vazhdimisht përpiqet t'ia dalë mbanë. Jo gjithmonë njeriu dubet të mësojë pasi e ka pësuar, sepse ka pësime prej të cilave ndoshta nuk mund të ringrihesh më. Historitë e popujve të kaluar na kumtojnë se jeta nuk t'i shërben frutet pa u lodhur, pa u djersitur, pa u munduar në sa e sa mënyra. Njeriu nuk dubet të humbë shpresën për të arritur në lartësinë e virtyteve, sepse asnjëherë nuk e di se në cilën ngjarje janë fshehur xhevahirët e mirësisë. Për këtë dubet durim dhe prandaj durimi do të thotë të ngrihesh e të vazhdosësh sa herë rrëzohesh dhe humb. Kjo është fitorja që shumë njerëz e kanë aq pranë dhe iu duket aq larg.

Lotët e botës nuk reshtin. Sapo dikush nis me qa, një tjetër kushedi se ku ka pushu së lotuari.” (Beckett, Duke pritur Godonë) (236)

Bota nuk mund të jetë njëngjyrëshe. Secili ka gurin e fatit të tij, që zë vendin e vet në mozaikun e jetës dhe përputhet mrekullisht me atë që i dubet njeriut për të qenë në koherencë me zbulimin e vetvetes. Prandaj fatet njerëzore janë kaaq të ndryshëm dhe të padytë.

Etika shpirtërore dhe parimet morale të Imam Gazaliut

Prof. Dr. Hajredin Hoxha

Abstrakt

Ky studim përmbledh mësimet shpirtërore dhe parimet morale të Imam Gazaliut lidhur me leximin dhe kuptimin e Kur'anit, duke u përqendruar në thellësinë e përvojës shpirtërore dhe edukatës morale që duhet të shoqërojë këtë akt. Imam Gazali ofron dhjetë parime kyçe për të ndihmuar lexuesit të zhvillojnë një lidhje të thellë dhe të singertë me Fjalën e Allahut. Parimet përfshijnë kuptimin e madhështisë së të folurit hyjnor, përvuljen, përkushtimin shpirtëror, meditimin, dhe largimin e pengesave për të kuptuar domethënien e ajeteve. Ai thekson rëndësinë e veçimit të lexuesit me mesazhin kuranor dhe ndikimin që ai duhet të ketë mbi zemrën dhe sjelljen, duke e konsideruar çdo ajet si një mesazh personal. Leximi i Kur'anit shihet si një proces i ndërthurjes së gjubës, mendjes dhe zemrës, që udhëheq lexuesin drejt avancimit shpirtëror dhe modestisë. Ky shkrim përmban një reflektim të thellë mbi dimensionin shpirtëror të leximit të Kur'anit, duke e paraqitur si një udhëtim të vazhdueshëm drejt përmbushjes shpirtërore dhe morale.

Imam Gazaliu ka pjesë shumë të bukura të thëna për çështjen për të cilën po flasim. Konsideroj se është shumë e rëndësishme të shkëpusim disa paragrafë duke dashur t'ia rikujtoj këtu lexuesit të nderuar se ato, mbase mund të duken si të përsëritura në shikim të parë, por nuk janë të tilla, ngase

Imami ka mënyrën e vet unike në prezantimin, shpjegimin dhe lidhjen ndërmjet pjesëve të këtij sistemi.

Me këtë rast, do të doja të përmend se veprat e brendshme (edukata shpirtërore) e lexuesit të Kur'anit duhet të jetë një rregull ideor, moral dhe shpirtëror për medituesit e Kur'anit, po kështu.

Imam Gazaliu thotë: Kapitulli III: Për veprat e brendshme të leximit, e që janë dhjetë:

1. Të kuptuarit e bazës dhe esencës, e thelbit të të folurit;
2. respektimi – madhërimi i Tij;
3. prania shpirtërore;
4. meditimi;
5. të kuptuarit e mirë;
6. zhveshja nga pengesat e të kuptuarit;
7. veçimi;
8. të ndikuarit;
9. avancimi;
10. dhe modestia.

1) Të kuptuarit e madhësisë së të folurit. Është e folura e Allahut.

Është mirësi dhe butësi e madhe e Tij me robërit, ngase ka bërë që, ndonëse është aq madhështor dhe nuk ka fare nevojë për krijesat, të folurit e Tij ta zbres në nivelin që t'i bëjë njerëzit të kuptojnë.

2) **Madhërimi i Folësit.** Ikrime ibn Ebi Xhehlit i binte të fikët kur e hapte mus'hafin. Është e folura e Zotit tim! Është e folura e Zotit tim! –thoshte. Kur i shkante ndërmend Arshi, Kursija, qiejt, toka, njerëzit dhe xhinët dhe gjithë çka ka ndërmjet tyre, dhe kur e dinte se Krijuesi, Mbizotëruesi dhe Furnizuesi i të gjitha këtyre është Një, dhe se të gjithë janë në dorën e Tij, ndërmjet mirësisë dhe mëshirës së Tij, si dhe ndërmjet ndëshkimit dhe fuqisë së Tij; nëse dhuron, atëherë me

mirësinë e Tij, e nëse ndëshkon, atëherë me drejtësinë e Tij...

3) Prania shpirtërore

Përkushtimi dhe vigjilenca. Në koment të ajetit: **“O Jahja, merre librin me shumë kujdes, dhe ashtu Ne i dhamë atij urtësi kur ishte fëmijë.”** (Merjem, 12) ... është thënë: merre Librin me zell dhe seriozitet, gjë që nënkupton të përkushtohesh tërësisht gjatë leximit dhe të të mos shkojë mendja tek diç tjetër...

4) **Meditimi.** Meditimi qëndron pas pranisë dhe përkushtimit shpirtëror, për shkak se ndodh që njeriu të mos mendojë për diçka tjetër përveç Kur'anit por të mos meditojë ngase dëshiron ta dëgjojë veten duke lexuar, etj. Ndërsa qëllimi i leximit është meditimi. Ka thënë Aliu (r.a.): “Nuk ka mirësi në adhurimin, në të cilin nuk ka të kuptuar, dhe as në leximin, në të cilin nuk ka të meditaruar!”

E, nëse nuk mundet të meditojë vetëm se duke e përcjellë – përsëritur fjalinë, atëherë e ta bëjë, me përjashtim kur falet pas Imamit. Ebu Dherri (r.a.) ka thënë: “I Dërguari i Allahut u fal një natë me ne ndërsa përsëriti këtë ajet:

“Nëse i dënon ata, në të vërtetë ata janë robër Tu, e nëse u falë atyre, Ti je i gjithëfuqishmi, i urti.” (el-Maide, 118)

5) **Të kuptuarit.** Për secilin ajet ta ketë të qartë atë që i përshtatet atij nga aspekti kuptimor. Kjo

ngase Kur'ani në përmban cilësi të Allahut të Madhëruar dhe vepra të Tij, përmban po kështu edhe rrëfime për profetët, rrëfime për femohuesit dhe përgënjeshtresit, përmban urdhëresa dhe ndalesa, flet për Xhenetin dhe Xhehenemin. Kështu që le t'i meditojë këto gjëra në mënyrë që t'i zbulohen domethëniet e fshehura, të cilat nuk i zbulohen vetëm se atyre të bekuarve për sukses. Ka thënë Ibn Mes'udi: "Kush e do diturinë e të parëve dhe të mbramëve, le ta studiojë Kur'anin!" Për këtë arsye, kush do që lexon ajetet në vijim:

"A nuk e shihni atë që e mbillni?" (el-Vakiah, 63) **"A më tregoni për farën që e derdhni,"** (el-Vakiah, 58) **"A e shihni ujin që po e pini?"** (el-Vakiah, 68) **"A e keni parë zjarrin që ju e ndizni?"** (el-Vakiah, 71)

...duhet që shikimin të mos e përkufizojë vetëm në ujë, zjarr, vend mbjellje dhe spermë, por se si kjo e fundit është një pikë uji, e cila më pas shndërrohet në copë mishi, për t'u formuar më pas në gjymtyrë trupore, e për të marrë më pastaj edhe karaktere të ndryshme, disa të vrazhdë, të butë, etj.

Ndërsa sa i përket gjendjes së mohuesve, le të jetë të kuptuarit e tij në shërbim të frikës nga hidhërimi dhe ndëshkimi i Allahut. Le të marrë mësim se si nuk duhet ndjekur rruga e të shkatërruarve, sepse fundi i saj është dëshpërim. Nga përshkrimi

i Xhenetit dhe Xhehenemit le të kuptojë se nuk mund të përthekohet ajo që kuptohet, ngase nuk ka fund. E, ai që nuk kupton atë që gjendet në Kur'an, qoftë edhe në nivelet më të ulëta, atëherë ai është pjesë e ajetit të 16 nga kapitina Muhamed:

"Prej tyre ka asish që vijnë të dëgjojnë ty, por kur largohen prej teje, u drejtohen atyre që kanë dije u thonë: "Çka tha ai (Muhamedi) më parë?" Ata janë zemrat e të cilëve i ka vulosur Allahu e ata udhëhiqen pas dëshirave të veta." Zaten, është thënë se nxënësi nuk mund të jetë nxënës derisa nuk gjen në Kur'an tërë atë që kërkon, nuk mëson për mangësinë sa herë që dijen e shton, pra, e kupton sa e gjerë është dija!

6) Largimi i pengesave të të kuptuarit. Shumë njerëz janë privuar nga kuptimi i domethënieve madhështore të Kur'anit për shkak të perdeve që djalli i mallkuar ka lëshuar mbi zemrat e tyre.

Muhamedi (s.a.s.) ka thënë:

"لولا أن الشياطين يحومون على قلوب بني آدم ل نظرنا إلى الملكوت
Sikur djajtë të mos rrethonin zemrat e bijve të Ademit, ata do të shihnin edhe në pushtetin qiellor (meleikutin)!"

Domethëniet e Kur'anit janë pjesë e melekutit dhe çdo gjë që shqisat nuk mund ta detektojnë dhe nuk mund të arrihet vetëm se me nurin e argumentit, është pjesë e melekutit. Gjërat që i vënë perde melekutit janë katër:

a) Që fokusi gjatë leximit të jetë vetëm në nxjerrjen, shqiptimin e tingujve. Djalli krijon mëdyshje se nuk i kanë shqiptuar mirë andaj i sheh tek i kthehen një tingulli të vetëm disa herë. Për shkak të përqendrimit vetëm në shqiptimin e tingujve, njerëzit e kësaj kategorie privohen nga kuptimi i thellë i domethënieve të Kur'anit.

b) Fanatizmi medh'hebor, i cili nuk e lë të dalë jashtë asaj.

c) Këmbëngulja në ndonjë mëkat të caktuar, të jetë mendjemadh apo të jetë pasues i epshtit. Këto gjëra janë shkak për errësimin e zemrës. Është si të thuash pluhurosje e pasqyrës që pamundëson shikimin e pastër në të. E, sa herë që epshtet të jenë më komplekse, atëherë mundësia që zemra të zbulojë domethëniet e Kur'anit pakësohet gjithnjë e më tepër.

Ndërsa, sa herë që brengat e dynjasë janë më të pakta, atëherë mundësia që zemra të thellohet në zbulimin e këtyre domethënieve madhështore, është më e madhe. Zemra është ashtu si pasqyra ndërsa epshtet sikur ndryshku – pluhuri. Ndërsa domethëniet e Kur'anit janë sikur fotot që shfaqen – duken në pasqyrë. E, përpjekja për ta ruajtur zemrën nga epshtet është sikur pastrimi i pasqyrës.

Për këtë shkak Muhamedi a.s. ka thënë:

Kur ymeti im t'i ketë dhënë më shumë vlerë se ç'duhet dynjasë dhe

parasë, atëherë frikërespekti i Islamit do të shkulet nga zemrat e tyre, ndërsa kur ta kenë braktisur urdhërimin për të mirë dhe ndalimin nga e keqja, atëherë do të privohen nga bereqeti i shpalljes.” Fudajl ibn Ijjadi duke shpjeguar këtë hadith, thotë: “Do të privohen nga kuptimi i Kur'anit. Allahu i Madhëruar ka kushtëzuar që për ta kuptuar Kur'anin duhet të jesh njeri që vazhdimisht pendohet.” Allahu thotë:

“(I bëme ashtu) Dëshmi të dukshme dhe përkujtuese për secilin njeri që ka drejtuar mendjen (te Zoti).” (Kaf, 8)

“Ai (Allahu) është që po jua dëfton juve argumentet e veta, që ju sjell furnizim prej qiellit (shiu), por përveç atyre që janë të kthyer te Zoti, të tjerët nuk marrin mësim.” (Gafir, 13)

“A është i njëjtë ai që e di se ajo që t'u shpall ty nga Zoti yt është e vërtetë, dhe ai që është i verbër? Vetëm njerëzit e arsyeshem që kanë mendje të shëndoshë e kuptojnë të vërtetën.” (Surja Rad, 19)

Ai që favorizon mashtrimet e dynjasë ndaj mirësive të ahiretit, ai nuk është prej të mençurve dhe atij, rrjedhimisht, nuk do t'i zbulohen sekretet e Kur'anit.

d) Që të ketë lexuar tefsire – koment sipërfaqësor të Kur'anit, kështu që të ndërtojë qëndrimet se nuk ka domethënie tjetër të ajeteve jashtë asaj që ka shpjeguar Ibni

Ababsi, Muxhahidi, etj, dhe se kjo nuk bie ndesh me thënien e Aliut (Allahu qoftë i kënaqur me të!): “Përveç, nëse Allahu i jep – dhuron robit të kuptuar për Kur’anin...”

7) Veçimi. Kjo nënkupton që çdo ajet ta mendosh sikur ka të bëjë me ty personalisht. Kur të lexojë ndonjë ajet njeriu për ndalimin ose lejimin, atëherë le të mendojë se ai është i ndaluar, respektivisht i urdhëruar për ta bërë atë punë. Po kështu kur të lexon ajete që premtojnë për shpërblime ose kërcënojnë për ndëshkim. Për këtë shkak Allahu ka thënë:

“Të gjitha këto që t’i rrëfyem ty nga lajmet e profetëve, janë që ta forcojnë zemrën tënde, dhe në to të ka ardhur e vërteta e këshilla, si dhe përkujtime për besimtarët.” (Hud,120) Kështu vepron edhe kur ligjërimi të jetë i përgjithshëm. Ai duhet ta interpretojë atë si individual; çfarë është për të e çfarë është për njerëzimin. Le ta llogarisë sikur ai është që po përmendet në atë ajet. Allahu ka thënë: **“... e mua më është shpallur ky Kur’an që me të t’ju tërheq vërejtjen juve dhe atij që i komunikohet (dhe të gjithë atyre që vijnë pas jush deri në ditën e kiametit)...”** (Enam,19) Muhamed ibn Ka’b el-Kuredhij ka thënë: “Kujt i ka arritur Kur’anit, ai është sikur t’i ketë folur Allahu...”

Disa të urtë kanë thënë: “Ky Kur’an është mesazhe që na kanë

ardhur nga Allahu me premtimet e Tij, e të cilat në namaze i meditojmë, në vetmi i shqyrtojmë, në adhurime dhe sunnete të pasuara i zbatojmë.”

Malik Ibn Dinar thoshte:

“Çfarë ka mbjellë Kur’ani në zemrat tuaja, o ithtarët e Kur’anit? Kur’ani është pranvera e besimtarit ashtu siç shiu është pranverë e tokës...”

8) Ndikimi. Kjo nënkupton që zemra, varësisht nga përmbajtja e ajeteve, të ndikohet. Ai duhet të përjetojë sipas çdo domethënie një gjendje dhe ndjesi që reflekton në zemrën e tij, pikëllim, frikë apo shpresë qoftë. Sa më shumë që të jetë i ditur, përlujta dhe frikërespekti ndaj Allahut do të jenë më të mëdha.

Për këtë shkak Hasan Basriu ka thënë: “Pasha Allahun, nuk ka rob që ka gdhirë sot që e lexon Kur’anin dhe beson në të, e që të mos i jetë shtuar pikëllimi dhe t’i jetë pakësuar gëzimi, t’i jetë shtuar të qarit dhe t’i jetë pakësuar të qeshurit, t’i jetë shtuar lodhja dhe angazhimi e t’i jenë pakësuar pushimi dhe neglizhenca...”

Ndikimi i besimtarit nga leximi nënkupton që ai të jetë shndërruar në vet ajetin – vargun kur’anor. Pikërisht për të arsye, Profeti (s.a.s.) qau kur Ibni Mes’udi ia lexoi ajetin 41 të kaptinës Nisa:

“Dhe si do të jetë gjendja e atyre (që nuk besuan), kur Ne do të sjellim dëshmitarë për çdo popull, e ty do të sjellim dëshmitarë mbi ata (që nuk të besuan)?”

Sytë e tij rridhnin lot për shkak se përjetimi i asaj gjendjeje kishte kapluar zemrën e tij plotësisht. Ka patur njerëz që kur kanë dëgjuar ajetet kur'anore u ka rënë të fikët, bile edhe të atillë që nuk u kanë rezistuar fare dhe kanë vdekur. Për këtë gjë thuhet: Kur njeriu e lexon Kur'anin ndërsa nuk ka përvetësuar etikën dhe moralin e tij, e thërret Allahu: “Çfarë ke ti me Fjalën Time ndërsa më kundërshton?! Nëse nuk pendohesh, lëre të folurin Tim ose Fjalën Time...” Këtu qëndron arsyeja dhe shkaku pse Sahabet (Allahu qoftë i kënaqur me ta!) ishin më shumë të interesuar në praktikimin e Kur'anit sesa në nxënien e tij përmendësh.

Leximi i njëmendtë i Kur'anit nënkupton që gjuha, mendja dhe zemra të bashkëveprojnë: gjuha përmirëson shprehjet-shqiptimin, mendja botëkuptimet dhe domethëniet ndërsa zemra këshillohet dhe merr mësim. Pra, gjuha lexon, mendja përkthen, ndërsa zemra, këshillohet.

9) Avancimi. Kjo nënkupton që të ngrihet dhe të avancojë gjatë leximit, sikur ai nuk po e dëgjon veten e tij por Allahun e Madhëruar. Leximi ka tri shkallë: më e ulëta është që të paramendojë sikur po e lexon Kur'anin para Allahut dhe Ai po shikon atë dhe po e dëgjon.

Kështu gjendja e tij sipas kësaj do të duhej të ishte lutje, përlutje, përgjërimit. Shkalla ose pozita e dytë

është që me zemër të dëshmojë sikur Allahu po e sheh dhe po i flet me butësinë e Tij dhe po bisedon me begatitë dhe mirësinë e Tij. Kjo gjendje nënkupton turpërimin, madhërimin, vëmendjen dhe kuptimin.

Pozita e parë është kur anashkalon të gjitha dhe fokusohet vetëm tek Folësi, sikur ai është zhytur thellë në shikimin e Folësit ndaj të tjerëve. Kjo është grada e mukarrebineve – njerëzve të dashur tek Allahu, ndërsa dy pozitat e para janë të djathtëve, atyre që do tu jepet libri nga e djathta në ditën e gjykimit, ndërsa gjithë të tjerët janë neglizhentët.

Për këtë shkak ka thënë një njeri i urtë: “E lexoja Kur'anin, por nuk gjeja dot kënaqësi derisa fillova ta lexoja sikur po e dëgjoja nga i Dërguari i Allahut duke ua lexuar shokëve të tij. Pastaj avancova, u bëra sikur po e dëgjoja nga Xhibrili (alejhislam) i cili ia lexonte Muhamedit (alejhis salatu ves selam). Pastaj u ngrita në një pozitë tjetër, sikur po e dëgjoja nga vet Folësi. Vetëm atëherë arrita kënaqësinë dhe dëfrimin pa të cilat nuk mund të qëndroj dot...”

10) Modestia. Kjo nënkupton që njeriu të mos e shikojë veten si të pastër nga mëkatet, si të lartësuar, si të zhveshur nga gabimet.

Kur të lexojë ajetet e premtimit dhe lëvdimit për të devotshmit le të mos e klasifikojë veten në mesin e tyre, por le të shfaq një mallëngjim

dhe dëshirë të madhe që të jetë prej tyre, ndryshe nga ajetet ku bëhet fjalë për mëkatarët dhe neglizhentët, që do të duhej ta interpretonte në vetën e parë për shkak të frikës dhe nxitimit për tu përmirësuar.

Ka thënë Omeri (Allahu qoftë i kënaqur me të): “O Allahu im! Unë të kërkoj falje për padrejtësinë time dhe përbuzjen time!” Thanë: “Padrejtësinë mund ta kuptojmë, por përbuzja si është?!”

Tha: “A nuk e keni lexuar ajetin kur’anor:

‘...Vërtet, njeriu është i padrejtë dhe shumë përbuzës.’ (Ibrahim, 34)

Sigurisht, kjo gjendje nuk mund

të arrihet pa një modesti kulmore dhe pa i vënë në shërbim, në vendin e duhur këto mbulesa. Më konkretisht, kur të lexojë ajetet e shpresës, dominon aspekti i përgëzimit dhe i zbulohet Xheneti sikur po e sheh.

E nëse dominon frika, atëherë atij i zbulohen imazhe të Xhehenemit, thuajse është duke e parë atë. Kjo për shkak se të folurit e Allahut përmban aspekte të së lehtës dhe të së butës, të së vështirës dhe të së ashprës, të shpresës dhe të frikës, dhe kjo varësisht nga gjendja dhe nga përshkrimet: prej tyre ka që kanë të bëjnë me mëshirën dhe butësinë, por edhe me hakmarrjen dhe dënimin....

HASAN EF. NAHI - PËRKTHYES I KURANIT FISNIK

Resul ef. Rexhepi

Abstrakt

Ky artikull ofron një përshkrim të jetës dhe kontributit të Hasan ef. Nahit, një prej figurave të shquara islame shqiptare, i cili realizoi përkthimin e parë të plotë të Kur'anit në gjuhën shqipe, të titulluar «Kur'ani i Madhëruar». Hasan ef. Nahi, i lindur në Gjakovë më 1905, ishte dijetar, myderriz dhe edukator me një karrierë të gjatë dhe të pasur, duke kontribuar ndjeshëm në arsimimin dhe edukimin fetar të shqiptarëve.

Artikulli përshkruan rrugëtimin e tij arsimor, përfshirë studimet e thelluara në Universitetin e famshëm të Al-Azhar-it në Egjipt, dhe përpjekjet e tij për të përcuar mesazhet e Kur'anit tek shqiptarët, edhe në rrethana të vështira politike dhe sociale. Përkthimi i tij i Kur'anit, botuar në vitin 1988, pasqyron njohuritë e thella të Hasan ef. Nahit në tefsir (shpjegimin e Kur'anit), gramatikën arabe dhe jurisprudencën islame. Përkthimi u bë me kujdes të veçantë për të përcjellë kuptimet e ajeteve në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme për lexuesit shqiptarë, duke respektuar frymën e shenjtë të Kur'anit.

Në këtë artikull shqyrtohen edhe disa veçori të përkthimit të tij, si zgjedhja e saktë e fjalëve, shmangia e përkthimeve fjalë për fjalë, dhe përkushtimi i tij për të ruajtur besnikërinë ndaj origjinalit arab. Në fund, përkthimi i Hasan ef. Nahit konsiderohet një vepër madhore dhe një kontribut i jashtëzakonshëm për kulturën fetare dhe kombëtare shqiptare. Puna e tij ka ndikuar ndjeshëm në edukimin fetar dhe në pasurimin e literaturës islame në gjuhën shqipe.

Fjalë kyçe: Hasan ef. Nahi, Kur'an, përkthim, gjuha shqipe, tefsir, Al-Azhar, edukim islam, kultura shqiptare.

*“Është detyrë e dijetarëve fetarë për ta përkthyer
Kuranin në gjuhën e popullit të vet”. (Hasan ef. Nahi)*

Pak jetëshkrim për Hasan ef. Nahin



Hasan ef. Nahi u lind më 12 mars 1905 në Gjakovë. Mësimet e para i mori në qytetin e lindjes, për t'i vazhduar më pas në Medresenë e Madhe të këtij qyteti për 12 vjet me radhë, ku mori edhe diplomën. Nga viti 1927, pas vdekjes së babait të tij - myderriz Islam efendiut, Hasan efendi, në një moshë relativisht të re, për tre vjet me radhë do ta zëvendësojë atë si mësimdhënës - myderriz, duke ligjëruar gramatikën dhe sintaksën e gjuhës arabe dhe disa lëndë të tjera.

Dëshira e madhe për t'i zgjeruar horizontet e diturisë, nga njëra anë, dhe tradita familjare islame e kultivuar për disa breza, në anën tjetër, bënë që Hasan efendi të shkonte në Egjiptit dhe, pas katër

vjet studimesh në "Al-Azharin" e famshëm, pa u kthyer asnjëherë në vendlindje, ai u pajis me dituri e kulturë si dijetar. Vajtja e Hasan ef. në Egjipt, atëbotë për shkak të kushteve të vështira të udhëtimit, siç na rrëfente vetë ai, ishte shoqëruar me shumë vështirësi. I është dashur që nga Gjakova të shkonte këmbë deri në Tiranë e nga andej për në Greqi. Në këtë vend, pas pritjeve të konsiderueshme, me anije ishte nisur për në Aleksandri. Pas disa ditë udhëtimi, më në fund arrin në Kajro, ku do të regjistrohet dhe do t'i vazhdojë studimet në gjirin e Universitetit të famshëm "Al-Azhar".

Ai u diplomua në vitin 1934, dhe në diplomën e lëshuar nga Universiteti i "Al-Azharit" është vënë data 1 Rexheb 1350 h. Pas diplomimit, Hasan ef. kishte vendosur që të kthehej në vendlindje, sepse *"...kështa vetëm një dëshirë: të vij në Kosovë dhe të ushtrtoj profesionin tim në interes dhe në dobi të popullit tim"* - është shprehur më vonë Hasan ef. Nahi.

Pas kthimit në vendlindje, fillimisht nga Këshilli i Ulemave me sili atëbotë në Shkup, ai do të angazhohej fillimisht si *"sejjar vaiç"* - d.m.th. *ligjërues shëtitës*, gjithandej nëpër Kosovë dhe kjo për katër vjet me radhë, për të vazhduar më pas si mësimdhënës në Medresenë

1. "Dituria Islame", 18, tetor 1990, f. 14 dhe "Dituria Islame", 84, shtator 1996, f. 26.

e Ferizajt², në të cilën për arsye të autoritetit e të respektit që gëzonte dhe sidomos për shkak se mësimet i mbante në gjuhën shqipe, me gjithë rrezikun e madh nga pushteti i atëhershëm serbo-sllav, filluan të vinin nxënës madje edhe nga Shkupi, ndonëse aty edhe më herët kishte medrese të ngjashme dhe me traditë.

Në vitin 1943 Hasan ef. do të transferohej në Medresenë e njohur “Mehmed Pasha”³ të Prizrenit, ku do të kryente detyrën e drejtorit, kurse një vit më vonë, Këshilli i Ulemave të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, duke e marrë në konsideratë zotësinë dhe aktivitetin e treguar gjatë shërbimeve të sipër përmendura, vendosi ta emëronte edhe në detyrën e kryemyftiut për Rrethin e Prizrenit, gjegjësisht për Rrafshin e Dukagjinit. Më 20 tetor 1943, me rastin e pranimit të detyrës së re, në prani të Këshillit të Ulemave, e kishte bërë betimin. Mirëpo, aktiviteti i gjithanshëm dhe puna e palodhshme e myderrizit bënë që ai në vitin 1948, me mbylljen

2. Rreth punës prej pedagogu në Medresenë e Ferizajt, informacione të bollshme kam marrë nga Mehdi ef. Stublla-imam në Ferizaj, e i cili në kohë të tij kishte qenë nxënës i myderrizit Hasan ef. Ai, me një rast, në Ferizaj, në xhaminë e Vogël, pati thënë: “Hasan ef. ka qenë myderriz shumë i përgatitur, sepse e ka dasht arsimin me gjithë shpirt. Me nxënësit ka qenë i rrept. Përgjigjej në çdo pyetje të nxënësve dhe se kishte merak me e pyet.”

3. Kjo medrese, e cila kishte një traditë mbi 460-vjeçare, në vitin 1948 do të suprimohet nga pushteti i atëhershëm serbo-komunist.

e medresesë së sipërpërmendur, të largohej nga puna pa të drejtë për të ushtruar veprimtari nga profesioni i tij prej mësimdhënësi, të cilin ai aq shumë e admironte. Ai vetëm në vitin 1958, pra, pas një pauze dhjetëvjeçare, në mungesë të kuadrin të kualifikuar në Medresenë e Ulët të Prishtinës, e cila kishte filluar punën pak vite më parë, gjegjësisht më 1.11.1951, Hasan ef. do të angazhohej në procesin mësimor, të cilin do ta vazhdonte me nder dhe dashuri për njëzet vjet me radhë, gjegjësisht deri më 1978, kur edhe pensionohet.

Gjatë kohës sa ishte profesor në Medresenë “Alauddin” të Prishtinës, me emrin e këtij myderrizi të nderuar janë të lidhura shumë momente të rëndësishme, si në procesin edukativo-arsimor, ashtu edhe në rritjen dhe zhvillimin e kësaj medreseje. Myderriz Hasan ef. Nahi ka dhënë një kontribut të rëndësishëm, sidomos në ngritjen e saj nga niveli i medresesë së ulët në nivel të mesëm. Shumë intelektualë të sotëm në Kosovë, në Maqedoni, në Mal të Zi, në Sanxhak e gjetiu, të cilët kanë pasur fatin të jenë nxënës të tij, me kënaqësi, pietet e dashuri ruajnë kujtimet më të mira për profesorin e tyre të respektuar.⁴ Mbi të gjitha, ata i detyrohen për arritjet e tyre në të

4. Unë kam pasur fatin që të jem nxënës i Hasan ef. Nahit në vitet 1972-1967 në Medresenë e mesme “Alaudin të Prishtinës, kurse nga viti shkollor 70-1969 e deri në qershor 1972 ta kem edhe kujdestar klase.

gjitha fushat e jetës. Me kujdes dhe me sjellje prindërore, ai vazhdimisht u sugjeronte nxënësve të tij, - e edhe autorit të këtij teksti, - që *“edhe nëse shkon në tokat arabe përsëriteni leximin e Kuranit e mos e bani batall”*. Ky citim sigurisht se iu kujtohet shokëve të gjeneratës time në veçanti.

Hasan efendiu, edhe pse kishte dalë në pension, nuk e kishte ndërprerë punën shkencore. Kështu, pa kaluar as dy muaj të plotë, ai i ishte përkushtuar një pune tepër të madhe dhe të rëndësishme, - përkthimit të kuptimeve të Kuranit fisnik. Në të vërtetë, përcaktimi i tij për përkthimin e domethënies së ajeteve të Kuranit, një punë kjo mjaft komplekse, sepse edhe mendimet e dijetarëve - myfesorëve rreth kësaj çështjeje ishin dhe vazhdojnë të jenë të shumta dhe të ndryshme, ndërsa, sipas tij, ishte e vetmja pikëpamje e pranueshme ajo që ishte në përputhje me fetvanë e *“Al-Az`hari sherifit”*⁵. Së këndejmi, kjo nismë e tij, sa e vështirë, po aq ishte edhe me përgjegjësi. Megjithatë, kjo punë kaq e frytshme u kurorëzua me sukses me botimin e *“Kur`ani i Madhëruar”* që pa dritën më 1988.

Dy fjalë rreth përkthimit të Kuranit

Kurani është libër i Allahut të Gjithëmëshirshëm, ajetet e të cilit, përmes Xhibrilit, ia zbuloi (shpalli)

5. Kur`ani i Madhëruar, përktheu Hasan Nahi, Prishtinë, 1988, f. 7.

Muhamedit (a.s.), në gjuhën e qartë arabe. Profeti (a.s.) këtë mesazh ia përcolli fillimisht popullit të tij, e pastaj myslimanët e parë u bënë përgjegjës për komunikimin e këtij mesazhi, duke e përcjellë atë me besnikërinë më të madhe edhe te popujt e tjerë⁶. Një ndër mënyrat e mësimit, e të kuptuarit të drejtë dhe të shpjegimit të Kuranit për popujt joarabë, pa dyshim se ka qenë dhe mbetet përkthimi i tij.

Për sa i përket përkthimit të Kuranit, ose të ndonjë pjese të tij, në kohën sa ishte gjallë Profeti (a.s.), informacionet e arritura deri tek ne janë të mangëta, përveç një informacioni të pamjaftueshëm të Es-Serahsiut (vd. 438 h. -1090 m.), i cili thotë se Selman el-Farisiu kishte përkthyer suren *“El-Fatiha”* në gjuhën perse.

Megjithatë, përkthimi i Kuranit ka qenë çështje që i ka preokupuar, para së gjithash, dijetarët myslimanë që nga periudhat e hershme të fesë islame, sepse myslimanët joarabë ndienin nevojë dhe kishin kërkesa të vazhdueshme për shpjegimin e Kuranit në gjuhët e tyre.

6. Në një hadith Profeti (a.s.) ka thënë: *“Komunikoni nga unë qoftë edhe një ajet”*. Profeti (a.s.) i ka urdhëruar ata që kanë dëgjuar diçka nga ai, që t’ua përcjellin të tjerëve që nuk e kanë dëgjuar. Madje, edhe në fjalimin e tij të fundit nga rrafshnalta e Arafatit, kishte porositur: *“Le t’i komunikojë prezenti atij që mungon”*. Më gjerësisht: *“Edukata Islame”*, 58-59, v. 1996, f. 11-12.

Ç'është e drejta, polemikat dhe diskutimet e dijetarëve myslimanë, arabë e joarabë, sa i përket mundësisë dhe (mos)lejimit të përkthimit të Kuranit në gjuhë të tjera, vazhdimisht qenë të pranishme në qarqet shkencore. Me dëshirë që të mos u kthehemi atyre polemikave, kësaj here do të mjaftohemi vetëm me përmendjen e mendimit të pranuar nga shumica e dijetarëve, të cilët pohojnë se Kurani iu ka zbuluar Profetit (a.s.) në gjuhën arabe, se namazi duhet të kryhet ekskluzivisht në gjuhën burimore, d.m.th. në arabisht dhe se legjislacioni e "ixhtihadi" mund të bëhen vetëm me tekstin arab të Kuranit dhe nga ai. Meqenëse Islami është fe universale dedikuar gjithë njerëzimit, atëherë domosdo është e nevojshme që edhe Kurani të përkthehet, të shpjegohen kuptimet e domethëniet e tij dhe të sqarohen porositë e tij për të gjithë njerëzit. Prandaj, duke pasur parasysh se përkthimi i fjalëpërfjalshëm i Kuranit, identik me tekstin origjinal, është i pamundshëm dhe i paarrtshëm, në anën tjetër është theksuar se domethënia e ajeteve të tij mund të përkthehet.⁷

Përkthimi më i hershëm i Kuranit, nga sa dihet, është bërë në persishte në kohën e princit samanit, Mensur bin Nuh në vitin 345 h./956 m.

7. Po aty, f. 22. Më gjerësisht për këtë, mund të konsultohet edhe Kurani i Madhëruar, i përkthyer nga Hasan Nahi, f. 7.

Ndërkaq, përkthimi i pjesshëm më i hershëm i botuar i Kuranit, sipas Ekmeludin Ihsanoglu, është ai i vitit 1515 në gjuhën angleze, i botuar në Londër⁸, kurse sipas dr. F. Mehdiut, përkthimi i parë i Kuranit në Evropë është ai në gjuhën latine në vitin 1543⁹.

“Kur’ani i Madhëruar” - përkthyer nga Hasan ef. Nahi

Përkthimi i kuptimeve të Kurani-Kerimit nga Hasan ef. Nahi, ose siç figuron në ballinë “Kur`ani i Madhëruar”, botuar në Prishtinë, më 1988, ka gjithsej 746 faqe. Prej tyre 35 faqet e fillimit janë në funksion të informacioneve për Kuranin si dhe shënime të tjera të rëndësishme. Nga shënimet në fillim shihet se e përktheu nga arabishtja prof. Hasan

8. Titulli i plotë i këtij përkthimi është “Here begyneth a lytell treatyse of the turkes law called Al Coran. And also it spekef of Machamet the Nygromancer”, Londër, 1515, marrë nga “Bibliografia botërore mbi përkthimet kuptimore të Kurani Kerimit-përkthimet e botuara 1515-1980”, Stamboll, 1986, me autor Ekmeluddin Ihsanogllu, përktheu Nehat Krasniqi, në “Edukata Islame”, nr. 58-59, Prishtinë, 1996, f. 31. Në “Kurani i Madhëruar” përkthyer nga H. Nahi, f. 7, shënon se përkthimi i parë në Evropë është bërë në gjuhën latine më 1141, në gjuhën italiane më 1513, e kështu me radhë, por nuk e përmend burimin. Kujtoj se konstatimi i E. Ihsanogllut është më i saktë, sepse është më i pranueshëm në qarqet shkencore botërore.

9. Dr. Feti Mehdiu, “Përkthimet e Kuranit në gjuhën shqipe”, bot. “Logos-A”, Shkup, 1996, f. 7.

(Islam) Nahi e që është edhe botues. U shtyp në shtypshkronjën “Ognjen Prica” - Zagreb në një tirazh prej 5.000 ekzemplarësh.

Këtij botimi, në fillim i paraprin një *Parathënie* e shkruar nga Sadri Prestreshi, bashkëpunëtor shumëvjeçar i përkthyesit, icilika qenë myderriz në Medresenë “Alauddin” të Prishtinës gjatë kohës kur aty ka punuar edhe Hasan efendiu. Kurse në vazhdim, pason shkrimi mbi jetën e hazreti Muhamedit (a.s.), ku flitet shkurtimisht për përmbajtjen e disa ajeteve të Kuranit, të cilat drejtpërdrejt ose tërthorazi, hedhin dritë mbi jetën e Muhamedit (a.s.)¹⁰ Këtë botim, edhe më shumë e begatojnë, duke ia lehtësuar dukshëm punën lexuesit, edhe *Përmbajtja dhe Përmbajtja e temave sipas sureve* (f. 17-21), si: *ushqimet e ndaluara, lufta mbrojtëse, triumfi i islamizmit, dispozitat mbi trashëgimin, pasojat e hipokrizisë* etj.¹¹

Këtë përkthim e karakterizon lidhshmëria e sureve dhe ajeteve mes tyre, sepse, siç është e njohur, në të kuptuarit e drejtë të qëllimeve të sureve dhe të ajeteve, rol të rëndësishëm ka edhe *“munasebetu-l-ajeti lima kablehu”* - *“lidhshmëria e ajetit me ajetin pararendës”*, e që në shkencën e tefsirit është një çështje mjaft e rëndësishme. Po kaq të rëndësishme

janë edhe njohuritë solide të përkthyesit lidhur me shkakun e zbritjes së ajeteve dhe të sureve të Kuranit (sebebi nuzul), gjë e cila i ka ndihmuar dukshëm në përkthimin e drejtë të ajeteve, gjegjësisht të sureve të Kuranit. Prandaj, një përfillje e kësaj metodologjie, ndihmon me të madhe në të kuptuarit e drejtë të domethënies së ajetit, e rrjedhimisht edhe në përkthimin e kuptimeve të tij. Nuk janë të shpeshta rastet, megjithëse janë aty-këtu evidente, kur njëra pjesë e ajetit e shpjegon pjesën paraprake të tij, ndërsa përkthyesi, duke e pasur parasysh këtë, e ka aplikuar dhe e ka përkthyer me akribi shkencore. Ja një shembull:

أَمْ خُلِقُوا مِنْ غَيْرِ شَيْءٍ أَمْ هُمُ
الْحَالِقُونَ.

të cilin Hasan efendiu e përkthen:

“A mos vallë, ata janë krijuar pa Krijues, apo mos janë ata krijues të vetvetes?!”¹²

Pjesën e parë të ajetit *“min gajri shejin”*, në mbështetje të pjesës së dytë *“halikun”*, nuk e përkthen fjalë për fjalë - *“prej asgjëse”*, por e përkthen *“pa Krijues”*.

Gjuha e përdorur në këtë përkthim, ia mundëson lexuesit që ai me lehtësi t`i kuptojë domethëniet e ajeteve të Kuranit, megjithëse shmangiet nga gjuha standarde shqipe aty-këtu edhe paraqiten. Edhe më të lehtë dhe më të përdorshëm për ta krahasuar domethënien e bën teksti origjinal, të cilin në të njëjtën

12. Kurani: Et-Tur, 35.

10. “Kurani i Madhëruar”, f. 9.

11. Kurani i Madhëruar, përktheu Hasan Nahi, Prishtinë, 1988, f. 18-31. Ngjashëm edhe tek dr. Fetih Mehdiu, Përkthimet e Kuranit, op. cit., f.72.

faqe e shoqëron edhe përkthimi, edhe pse në disa vende, për shkaqe teknike dhe në mungesë të një kujdesi më të shtuar, kjo gjë nuk është realizuar në tërësi dhe me përpikëri.¹³

Është e njohur se disa fjalë në Kuran, - e që nuk janë edhe të pakta, - jo gjithmonë përdoren në të njëjtin kuptim. Andaj, për ta zgjedhur fjalën më të saktë, atë më të qëllueshmen, është e domosdoshme që paraprakisht të konsultohen shumë komentime - tefsire dhe përkthime të tjera, të cilat sigurisht se do të udhëzojnë drejt, me gjithë faktin se kuptimin e vërtetë dhe të saktë të fjalëve të Kuranit e di vetëm Allahu (xh.sh.). Një gjë e tillë, Hasan efendiu, me siguri për shkak të njohjes solide të gjuhës arabe dhe shkencës së tefsirit e të usuli-fikhut (metodologjisë), në të shumtën e rasteve, i ka shkuar mjaft mirë për dore, kështu që fjalën e njëjtë e ka përkthyer me saktësi sipas domethënies së saj që synohet në ajet dhe jo gjithkund në mënyrë të njëjtë. Ja një shembull: fjala “*emvaten*” tek ajeti:

كَيْفَ تَكْفُرُونَ بِاللَّهِ وَكُنْتُمْ أَمْوَاتًا
فَاحْيَاكُمْ

13. Krahaso: f. 349, 365, 373, 551, 595 etj. Ç’është e vërteta, edhe teknologjia bashkëkohore disa çështje teknike tashmë i ka lehtësuar dukshëm e që në kohën kur Hasan ef. ka punuar kjo nuk ka qenë në mundësitë e tij. Sot, ne e kemi ku e ku më lehtë në shumë aspekte e në veçanti në përgatitjen teknike të materialeve.

e cila në gjuhën arabe ka disa kuptime, si: “*mosekzistimi fare i një gjëje*”, “*mosekzistimi i gjallërishtëm*” - në kuptim të vdekjes natyrore, “*mosekzistimi i gatishmërisë për të besuar*”, “*vdekeje*” etj. Në ajetin e sipërpërmendur, përkthyesi, me të drejtë, duke i ikur përkthimit tekstual dhe duke e favorizuar atë domethënie që e synon ajeti, e bën këtë përkthim: “*Si mund të mos e besoni Allahun, ju që s’keni qenë e Ai ju ka dhënë jetën...*”. Siç dihet, fjala “*emvaten*” në të shumtën e rasteve përkthehet si *vdekeje*, e në rastin konkret do të ishte “*keni qenë të vdekur*”, por përkthyesi, me të drejtë, nuk e përkthen kështu, sepse po të vepronte kështu do të kishim një përkthim jo shumë të saktë dhe ajeti në fjalë do të na dilte jo fort i kuptueshëm, ndaj, në këtë rast e përkthen si “*që s’keni qenë*”.

Përkthimit tekstual, të fjalëpërfjalshëm, Hasan efendiu i shmanget për mrekulli në shumë raste dhe kjo bën që ajetet të kuptohen më lehtë dhe, natyrisht, edhe drejt, si p.sh. tek ajeti:

وَالسَّابِقُونَ السَّابِقُونَ

të cilin Hasan efendiu e përkthen si “*Ata që kanë prirë (në besim), do të prijnë edhe në Xhenet*”, sepse po të përkthehej tekstualisht ky ajet do të dilte “*të parët të parë*”, që në gjuhën shqipe nuk ka asnjë lloj kuptimi. Me këtë rast, fjala është për ashabët (shokët) e Profetit (a.s.), ose, thënë ndryshe, për gjeneratën e parë të besim-drejtëve.

I ngjashëm me këto raste është edhe përkthimi i fjalës “*mubitun*”, që në gjuhën arabe rëndom kuptohet se fjala është për “oqean”, ndërkaq përkthyesi, duke e zgjedhur alternativën më adekuate, kur e përkthen ajetin e 19 të sures së dytë, e formulon kështu: “...Por Perëndia i ka rrethuar (*qafirat*) me fuqi (*e s’kanë shpëtim*)”.

Sikurse e thamë edhe më lart, përkthimin e Kuranit nga Hasan ef. Nahi e karakterizon fryma e vetë Kuranit me të gjitha premisat e tij, ngase ai përkthimin e Kuranit kryesisht e bën me Kuran, e që në fakt është mënyra më e mirë dhe më e saktë. Sa për ilustrim, mund t’i përmendim ajetet 31-32 të sures “En-Nexhm”. Prandaj, ky përkthim, kujtoj unë, në një masë të madhe, arsyeton qëllimin e tij. Për të qenë edhe më i kuptueshëm, ndihmesë ofrojnë edhe shpjegimet e bëra, të cilat përkthyesi i vë brenda kllapave dhe këto raste janë të shpeshta.

Në vazhdim po sjellim disa ajete me tematikë të ndryshme, sa për t’i marrë shembull, të cilat, them se Hasan efendiu i ka përkthyer në mënyrë solide dhe të saktë, pavarësisht nëse ato i plotësojnë ose jo edhe kriteret e shqipes standarde:

- Surja e dytë, El-Bekare, ajeti 230:

فَإِنْ طَلَّقَهَا فَلَا تَحِلُّ لَهُ مِنْ بَعْدِ حَتَّى
تَنْكِحَ زَوْجًا غَيْرَهُ فَإِنْ طَلَّقَهَا فَلَا جُنَاحَ
عَلَيْهِمَا أَنْ يَتَرَاجَعَا إِنْ ظَنَّا أَنْ يُقِيمَا حُدُودَ
اللَّهِ وَتِلْكَ حُدُودُ اللَّهِ يُبَيِّنُهَا لِقَوْمٍ يَعْلَمُونَ.

Pra, “E, nëse burri e lëshon gruan (*për të tretën herë*), nuk mund të martohet më me të, pa u martuar ajo me një burrë tjetër. Pra, në qoftë se ndahet nga burri i dytë, atëherë nuk kanë mëkat as ajo e as burri i parë për martesë të sërishme me shoqi-shoqin, nëse mendojnë se do t’i respektojnë dispozitat e Perëndisë; këto janë dispozitat e Perëndisë, që ua shpjegon Ai njerëzve që kuptojnë”.

- Pastaj, po të shikohet me kujdes edhe përkthimi i sures “Et-Tekvir” mund të konstatohet se si Hasan efendiu disa ajete i fillon me shkronjë të vogël, për faktin se kontesti i tyre është në vazhdimësi, pra njëri pas tjetrit, e jo se secili prej tyre është i pavarur nga pararendësi i tij: ... إذا لشمس كورت...

1. “Kur Dielli e humb shkëlqimin,

2. dhe kur yjet të rrëzohen (*errësoben*),

3. dhe kur malet të lëvizin,

4. dhe kur devetë mbarse të mbetën pa çoban (*të pakujdes*),

5. dhe kur shtazët e egra të tubohen,

6. dhe kur detet të vlojnë,

7. dhe kur shpirtrat të bashkohen me trupëra,

8. dhe kur vajza e varrosur për së gjalli, do të pyetet

9. për çfarë faji është mbytur,

10. dhe kur të shpërndahen listat (*librat e veprave të njerëzve*),

11. dhe kur qielli zhvendoset,

12. dhe kur të flakërojnë skëterra,

13. dhe kur të afrohet Xheneti,

14. çdo kush do të di për veprat që ka përgatitur.

(Deri këtu, përkthyesi e ofron krejtësisht si një tërësi, prandaj ajetet i ndan me presje, kurse vetëm në fund të ajetit e përmbyll tekstin me pikë. Dhe vazhdon):

15. Dhe - betohem në yjet - që përëndojnë,

16. të cilët lëvizin dhe zhdukën nga shikimi (*horizonti*),

17. dhe në natën kur bie terri,

18. dhe agimin kur gdhinë (*zëbardhëllon drita*).

19. Me të vërtetë, Kurani është fjalë e të Dërguarit fisnik (*Xhebrailit*),

20. të fuqishëm, të çmuar nga Zoti i Arshit (*Kozmosit*),

21. të cilin e dëgjojnë (engjëjt) dhe është i besuar (*i madh*).

Pra, shikuar fetarisht - dhe mbi të gjitha kjo kërkohet prej dijetarit - ky është një përkthim brilant, plotësisht i kuptueshëm dhe mbi të gjitha ka frymë fetare.

Megjithëkëtë, për të qenë objektiv, duhet të theksojmë se përkthimi i Kuranit në gjuhën shqipe nga Hasan ef. Nahi, si çdo punë tjetër e njeriut, nuk është i përkryer, edhe ai ka disa mangësi, të cilat, me rastin e ndonjë ribotimi eventual, me pak punë do të mund mënjanoheshin, ashtu që vlera e këtij përkthimi do të ishte akoma më e

madhe. Me këtë rast, gjithnjë sipas meje, do t'i përmend vetëm disa nga ato mangësi, jo se duam që t'ia ulim vlerën këtij përkthimi, përkundrazi, vetëm për faktin se dëshirojmë që atë ta begatojmë edhe më shumë. Fundja, këtë edhe ia kemi borxh myderrizit tonë shumë të dashur e të respektuar.

Së këndejmi, përdorimi i shpeshtë në përkthim nga Hasan efendiu i emrit Allah me Perëndi, kujtojmë se do të duhej të zëvendësohej me emrin e bukur Allah, ose, kur është fjala për "Rrab" të përkthehet Zot, edhe pse jam i vetëdijshëm se përkthyesi këtë e ka bërë për shkak të ndikimit të gjuhës popullore, sidomos në regjionin nga i cili vinte vetë ai (përkthyesi). Po ashtu, e quaj më të drejtë që shkronja "y" e përdorur në shumë vende, të zëvendësohet me shkronjën "u", sepse qëllimi këtu është për saktësi dhe jo për ndonjë dialekt.

Është mëse e nevojshme, madje do të thoshim e domosdoshme, që për disa sure dhe për disa ajete të ofrohen shpjegime shtesë, të cilat do të ishin në të mirë të lexuesit dhe për t'i kuptuar sa më lehtë kuptimet e atyre ajeteve. Do të ishte me interes, po ashtu, që të përktheheshin edhe emërtimet e sureve, të cilat në brendi të tekstit edhe janë të përkthyer, por jo edhe në fillim. Kjo në fakt nuk do të paraqiste kurrfarë vështirësie, veçse do të ishte një plotësim teknik, i cili,

na thotë mendja, do ta begatonte botimin e ardhshëm.

Përdorimi i fusnotave, në të cilat do të shkruheshin shpjegime të nevojshme, duke përfshirë edhe shkakun e zbritjes së disa ajeteve e të ngjashme, të cilat në botimin e parë mungojnë, është diçka më se e domosdoshme, sepse ato vetëm sa do ta begatonin këtë punë madhore. Në këtë aspekt, mund të bëhen edhe plotësime të tjera të kësaj natyre. Në fakt, kur bëjmë fjalë për botimin e parë të këtij përkthimi, gjithmonë do të duhej t'i kemi parasysh dy gjëra:

Së pari, kohën dhe rrethanat kur ka jetuar dhe ka vepruar Hasan ef. Nahi, e pse jo edhe moshën e tij; dhe, së dyti, kohën kur është botuar ky përkthim, - d.m.th. vitin 1988, pra tash e njëzetetë vjet më parë, - kur kushtet teknike, siç janë sot përdorimi i kompjuterëve, për një përgatitje më të mirë teknike, nuk ishte i mundshëm.

Me gjithë këto, puna e madhe e myderrizit tonë të nderuar Hasan ef. Nahit është një kontribut jashtëzakonisht i çmueshëm.

Me këtë rast, duhet përmendur puna e mirë që ka bërë Instituti Shqiptar i Mendimit dhe Qytetërimit Islam nga Tirana, i cili vite më parë ribotoi përkthimin e Kuranit nga Hasan efendiu, një botim mjaft ekskluziv dhe i cili i ka mundësuar një shtrirje edhe më të gjerë të tij. Është e vërtetë se botuesi (AIITC), në emër të redaktimit, i ka bërë disa

ndryshime botimit të tij të parë, përkthimit origjinal nga Hasan ef. Kujtojmë se, megjithëse në aspektin sintaksor është me vend kjo gjë, në mënyrë që përkthimi në shqip të kuptohet më lehtë, kjo "liri" e redaktimit, nganjëherë edhe largohet dukshëm nga botimi i parë i Hasan efendiu dhe më as që përngjan me të. Shembuj ilustrues të kësaj natyre ka aq shumë sa nuk ia vlen as të përmenden. Prandaj, nëse botuesi (AIITC) dëshiron të kontribuojë në këtë drejtim, është obligim moral dhe intelektual t'i përmbahet botimit të parë të përkthimit të Hasan efendiu për aq sa ka mundësi, ndryshe do të kemi një Kuran të përkthyer në shqip, por jo më atë të Hasan efendiu.

Si përfundim

Përkthimi i Kuranit nga Hasan ef. Nahi është një vepër e pazëvendësueshme, i cili, pas një periudhe shumëshekullore, ka begatuar kulturën tonë fetare dhe kombëtare. Punonjësve të shkencave islame dhe jo vetëm, u është ofruar ndihmesë e madhe. Përkthimi i kuptimeve të Kuranit nga Hasan efendiu, e ka bërë atë të pavdekshëm. Me këtë përkthim, ai i ka bërë nder të gjithë shqiptarëve dhe të tjerëve që e njohin gjuhën shqipe. Me botimin e këtij përkthimi, kanë përfituar shumë lexues të apasionuar nga literatura islame dhe, çdo familje që e ka lexuar

ka përfituar jashtë mase. Megjithatë, përfitimin më të madh dhe më së shumti hajrin ia kanë parë studiuesit, punëtorët shkencorë, studentët, e të tjerë.

I Madhi Zot e shpërbleftë myderrizin tonë të nderuar për këtë punë të madhe që ka bërë, për veprën kaq kapitale që na e ka lënë trashëgim.

Recension për librin: “KONFERENCA E BUJANIT GURTHEMEL I SHTETËSISË SË KOSOVËS (31 Dhjetor 1943 dhe 1 e 2 Janar 1944)” nga autori Alban Dobruna.

Prof. Asoc. Dr. Ilirjana Kaceli
Kolegji Universitar Bedër

Abstrakt

Recensionin shqyrton librin “KONFERENCA E BUJANIT GURTHEMEL I SHTETËSISË SË KOSOVËS (31 Dhjetor 1943 dhe 1 e 2 Janar 1944)”, shkruar nga Prof. Asoc. Dr. Alban Dobruna, i cili ndriçon një nga ngjarjet kyçe të historisë së Kosovës dhe luftës çlirimtare shqiptare gjatë Luftës së Dytë Botërore. Konferenca e Bujanit, mbajtur në një periudhë kritike historike, shënoi themelimin e Këshillit Nacionalçlirimtar për Kosovën dhe Rrafshin e Dukagjinit dhe miratimin e Rezolutës së Bujanit, një dokument që për herë të parë shpalli të drejtën e vetëvendosjes për shqiptarët e Kosovës dhe synimin për bashkimin me Shqipërinë.

Libri trajton me kujdes dhe thellësi tematika kyçe, të organizuara në katër kapituj: arsimimin e kuadrove shqiptare dhe ndikimin e ideve komuniste, organizimin e rezistencës antifashiste, thirrjen dhe vendimet e Konferencës së Bujanit, si dhe reagimet e partive komuniste shqiptare dhe jugosllave ndaj saj. Dobruna analizon ndikimin e vendimeve të Konferencës në periudhën pas Luftës së Dytë Botërore dhe rolin e tyre në rrugëtimin e Kosovës drejt shpalljes së pavarësisë në vitin 2008.

Autori thekson rëndësinë kombëtare dhe ndërkombëtare të Konferencës së Bujanit si akti i parë legjislativ për vetëvendosjen e Kosovës, duke ofruar një analizë të thellë të rrethanave historike dhe ndikimeve afatgjata politike e shoqërore. Libri paraqitet si një burim i rëndësishëm historiko-shkencor për studiuesit dhe lexuesit e interesuar në historinë dhe politikën bashkëkohore shqiptare.

Fjalë kyçe: Konferenca e Bujanit, rezistenca antifashiste, vetëvendosja, historia e Kosovës, Rezoluta e Bujanit, politika shqiptare.

Konferenca e Bujanit është një ndër ngjarjet më të rëndësishme të historisë bashkëkohore tek shqiptarët dhe veçanërisht për historinë e re të shtetit të Kosovës. Në këtë konference e ka zanafillën edhe formimi i organit më të lartë politik të Lëvizjes Nacionalçlirimtare (më tej LNÇ) në Kosovë, Këshillit Nacionalçlirimtar për Kosovë e Rrafsh të Dukagjinit.

Konferenca i zhvilloi punimet nga data 31 dhjetor 1943 deri më 2 janar 1944 në fshatin Bujan të Malësisë së Gjakovës (sot ndodhet në rrethin e Tropojës-Shqipëri), sepse në territorin e Kosovës nuk kishte asnjë zonë të lirë. U zgjodh ky fshat dhe kulla e Sali Manit, bajraktarit të Krasniqes, meqenëse historikisht Gjakova dhe malësia e saj kishin qenë gjithmonë të lidhura në përpjekje për liri dhe pavarësi.

Në këtë Konferencë u mbledhën delegatë nga të gjitha krahinat e Kosovës duke e listuar atë, si Konferencën e Parë Nacionalçlirimtare të kësaj treve. Delegatët me vota të përbashkëta

zgjodhën Këshillin, më pas Kryesinë dhe përpiluan Rezolutën, që do të ishte platforma e parë politike, e cila do të ndiqej nga populli shqiptar i Kosovës në luftë kundër pushtuesve deri në çlirimin e tyre me të drejtën e vetëvendosjes deri në shkëputjen përfundimtare. Pra boshti kryesor i punimeve të konferencës ishin vendimet që dolën me emrin “Rezoluta e Bujanit”, ky fakt tregoi se për herë të parë shqiptarët e Kosovës njëzëri deklarorin shkëputjen dhe pavarësinë politike të Kosovës nga Serbia e Jugosllavia dhe kërkonin realizimin e të drejtës së ligjshme për bashkimin e këtij populli me tokën mëmë, Shqipërinë.

Shtypja politike dhe shfrytëzimi ekonomik gjithmonë hasin në rezistencë. Mirëpo, kur rezistenca kthehet në kryengritje të armatosur, ajo shndërrohet në luftë çlirimtare, siç edhe ndodhi në Luftën e Dytë Botërore. Populli shqiptar i Kosovës dhe i gjithë kombi ynë, asokohe po kalonin momente të vështira, vendimtare e historike. Ishte koha kur miliona njerëz po vdisnin nga makineria nazifashiste apo dhe koha

kur fatet e popujve të vegjël po lëkundeshin.

Ndaj me të drejtë autori përcakton se “Dokumenti historik i Bujanit” ishte produkt i momentit historik. Popujt e Ballkanit, brenda kësaj familjeje të madhe edhe populli shqiptar, parimin e vetëvendosjes e kanë kultivuar e njohur përmes mendimtarëve të vet liberalë, por edhe përmes kulturave, dëshirave dhe aspiratave të tyre, luftës për çlirim kombëtar e të drejtave sociale. Në këtë kontekst mund të përmendim veprimtarinë e Komitetit “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës (1918-1925)”, “Lëvizjen Kaçake gjatë periudhës midis dy luftërave botërore”, “Rezolutën e Bujanit”, programin e “Lidhjes së Dytë të Prizrenit” gjatë viteve të Luftës së Dytë Botërore etj.

Koncepti i parimit të vetëvendosjes përmban në vetvete, komponentë dhe premisa të shumta, si nga përmbajtja e tij, ashtu edhe nga modifikimet dhe mundësitë e realizimit të këtij parimi. Brenda parimit të vetëvendosjes gjejmë koncepte të lirisë së të drejtave të njeriut, ardhmërinë në pikëpamje të vetë iniciativës dhe të drejtën për vetëvendosje, shtetësinë, pavarësinë, sovranitetin politik të kolektivitetit nacional. Ky parim u duk qartë që në pjesën e parë të këtij dokumenti ku deklarohet se: “*Kosova e Rrafshi i Dukagjinit është krabinë e banuar me shumicë nga populli shqiptar i cili si*

gjithmonë, ashtu edhe sot dëshiron me u bashkuë me Shqipërinë?”

Autori si studiues dhe hulumtues shkencor e ka rritur veprimtarisë e tij në fushën kërkimore-shkencore, ndaj duke vlerësuar punën e tij përcaktojmë që ky punim i ri historik është monografia e tretë e tij. Kjo tregon për punën e palodhur, këmbënguljen dhe pjekurinë e studiuesit, i cili na përshkruan me shumë karakterin dhe objektivin kryesor të punimeve të Konferencës, të cilat sipas tij shprehen të lidhura në mënyrë specifike me lindjen dhe zhvillimin e lëvizjes çlirimtare në Kosovë, lëvizje që në vetvete përherë tentoi të jetë objektivisht e pavarur. Këtë autori e argumenton me vendimet që u morën në Konferencë ku siç shprehet vetë ai: “*vendimet ishin një provë e sinqeritetit dhe vërtetësisë së politikës pushtuese jugosllave*”.

Sipas tij, “Rezoluta e Bujanit” ka qenë akti i parë legjislativ i përfaqësuesve të popujve të Kosovës, dokument historik që ka synuar pavarësinë e Kosovës në bazë të së drejtës për vetëvendosje. Kjo Konferencë pati rëndësi të madhe historike, sepse shprehu hapur që në fillim bashkëpunimin dhe bashkërendimin me aleatët e koalicionit antifashist në botë. Prandaj, përveç karakterit kombëtar, mund të themi që konferenca kishte edhe karakter ndërkombëtar, sepse me praninë e përfaqësuesve aleatë dhe me garancitë e tyre

çështja e Kosovës u ngrit në arenën ndërkombëtare, duke mbrojtur me vendosmëri edhe të drejtën e vetëvendosjes së popullit shqiptar.

Kjo monografi me emrin shumë domethënës “KONFERENCA E BUJANIT GURTHEMEL I SHTETËSISË SË KOSOVËS” përmban një strukturë të qartë dhe të ndarë në katër kapituj kryesorë, të cilët trajtojnë tematika të ndryshme, por të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën. Kapitujt do të shoqërohen nga parathënia dhe përfundimet, si dhe një pjesë e veçantë rreth burimeve dhe literaturës që autori ka përdorur. Çdo kapitull ndjek një linjë logjike të ngjarjeve dhe analizave historike që përshkruajnë periudhën nga pushtimi nazifashist i trevave shqiptare deri në shpalljen e Pavarësisë së Kosovës në vitin 2008.

Autori punimin e tij e nis me parathënien ku përshkruan më së miri gjendjen, aspiratat dhe dëshirën e popullit të Kosovës për të vënë bazat themelore të institucioneve shtetërore të tyre, pavarësisht faktit se pavarësia e këtij vendi do të realizohej me shumë luftë (Lufta Çlirimtare e Kosovës 1997-1999) e përpjekje, me shumë mund e sakrificë, duke vuajtur pasojat e spastrimit etnik nga regjimi serb deri në shpalljen e pavarësisë. Kosova u shpall e pavarur më 17 Shkurt 2008.

Në kapitullin e parë që emërtohet: “*Arsimimi i kuadrove shqiptare dhe përhapja e ideve komuniste*”,

autori përshkruan me detaje si dhe analizon rrugën që ndoqën apo mënyrën se si u arsimuan kuadrot shqiptarë. Më tej vazhdon me përhapjen dhe ndikimin e ideve komuniste në këtë proces. Në fillim të kapitullit diskutohet edhe për pushtimin nazifashist të trevave shqiptare por dhe për ndikimin e këtij pushtimi në zhvillimin politik dhe ideologjik të popullsisë shqiptare. Pjesa më e rëndësishme e këtij kapitulli fokusohet në kontaktet e komunistëve shqiptarë të Kosovës dhe Shqipërisë, duke shfaqur mënyrën se si këto kontakte ndikuan në përhapjen e ideve komuniste dhe organizimin e rezistencës antifashiste në Kosovë.

Në kapitulli e dytë me titull “*Organizimi i rezistencës antifashiste në Kosovë*”, autori jep me shumë detaje mënyrën sesi u organizua rezistenca antifashistenë Kosovë, duke përfshirë luftën dhe strukturat komanduese që operonin në këtë rajon. Një pjesë e madhe e këtij kapitulli do të kushtohet edhe marrëdhënieve midis partive të dyja vendeve, Partisë Komuniste Shqiptare dhe Partisë Komuniste Jugosllave, por edhe rrethanave historike që i paraprinë Konferencës së Bujanit. Analiza e bërë është e detajuar dhe e mbështetur në dokumente historike dhe burime arkivore, duke nxjerrë në pah përpjekjet dhe sfidat me të cilat përballeshin luftëtarët antifashistë në Kosovë.

Më tej monografia vazhdon me kapitullin e tretë të cilin e emërton “*Thirrja për Konferencën e Bujanit*”. Në këtë kapitull autori është i përqendruar në Konferencën e Bujanit, një moment kyç në historinë e Kosovës gjatë Luftës së Dytë Botërore. Diskutohet thirrja për këtë konferencë, rezoluta që u miratua, por edhe jehona që pati në Kosovë dhe më gjerë. Rezoluta e Konferencës së Bujanit dhe ndikimi i saj politik dhe shoqëror në periudhën pas Luftës është analizuar me kujdes, duke nxjerrë në pah rëndësinë e kësaj ngjarje për vetëvendosjen e shqiptarëve të Kosovës.

Reagimet dhe qëndrimet do të ishin të ndryshme, ndaj autori e përmbyll veprën e tij me kapitullin e katërt me titull “*Reagimet e PKJ-së dhe PKSH-së ndaj Konferencës së Bujanit*”. Nëpërmjet një analizë të gjerë dhe me detaje trajton reagimet e dy Partive Politike, Partisë Komuniste Jugosllave dhe asaj Shqiptare, qasjen dhe qëndrimet ndaj Konferencës së Bujanit. Përpyekjet për shfuqizimin e rezolutës së Bujanit nga ana e PKJ-së dhe pasojat e këtyre përpyekjeve për Kosovën në përfundim të Luftës së Dytë Botërore janë të detajuara në këtë pjesë. Kapitulli përfundon me një analizë të ndikimit të Konferencës së Bujanit në Kosovë, që nga viti 1945 deri në shpalljen e pavarësisë më 17 shkurt 2008, duke e lidhur

kështu periudhën e rezistencës me zhvillimet e mëvonshme politike.

Në përfundimet e librit, autori jep një vlerësim të përgjithshëm të ndikimit të ideve komuniste dhe rezistencës antifashiste në zhvillimin e shoqërisë shqiptare në Kosovë. Analiza përfshin ndikimet afatgjata të këtyre ngjarjeve dhe mënyrën se si ato kanë formësuar identitetin politik dhe kulturor të shqiptarëve të Kosovës. Ky libër është punimi i parë i plotë historiko shkencor për një konferencë të madhe shqiptare siç ishte “Konferenca e Bujanit”, e cila mori vendime të rëndësishme për popullin e Kosovës, duke e ngritur lart nga ana politike dhe juridike.

Përfundimisht mund të themi se libri “KONFERENCA E BUJANIT GURTHEMEL I SHITETËSISË SË KOSOVËS (31 Dhjetor 1943 dhe 1 e 2 Janar 1944)” i autorit Prof. Asoc. Dr Alban Dobruna, është një burim i vlefshëm për studiuesit e historisë bashkëkohore Kosovare dhe më gjerë të politikës shqiptare. Struktura e qartë dhe analiza e detajuar e ngjarjeve historike e bëjnë këtë libër një kontribut të rëndësishëm në kuptimin e periudhës së rezistencës antifashiste dhe zhvillimeve të mëvonshme në Kosovë. Rëndësia e Konferencës së Bujanit dhe ndikimi i saj afatgjatë janë trajtuar me kujdes, duke ofruar një perspektivë të re dhe të thelluar për lexuesit.

Recensë mbi librin “Bardhësitë e atdheut” me autor z. Afrim Mustafa

KRYEPËRMENDORE PIRAMIDË E PËRMENDOREVE TË ATDHEUT TONË

Prof. Dr. Mehmet Halimi

Abstrakt

Ky shkrim trajton vlerat dhe rëndësinë e librit “Bardhësitë e atdheut” të autorit Afrim Mustafa, një vepër monumentale që përfaqëson një testament historik dhe kulturor të kombit shqiptar. Përmes një analize të thelluar, autori ofron një pasqyrë gjithëpërfshirëse të luftërave çlirimtare dhe sakrificave të tri ushtrive shqiptare: UÇK-së së Kosovës, UÇK-së së Maqedonisë dhe UÇPMB-së. Libri shfaqet si një kryevepër historike e bazuar në fakte, rrëfime dhe dokumente të sakta, duke i përjetësuar ngjarjet dhe figurat heroike që kontribuuan në çlirimin dhe bashkimin kombëtar.

Shkrimi vlerëson gjithashtu stilin e pasur dhe gjuhën e pastër të autorit, që ndërthur saktësinë historike me artin e rrëfimit, duke e shndërruar librin në një pasuri të paçmueshme për historiografinë shqiptare. Përmes kësaj vepre, Afrim Mustafa na kujton se liria dhe uniteti kombëtar kërkojnë jo vetëm guxim, por edhe përkushtim intelektual e kulturor. “Bardhësitë e atdheut” mbetet një burim frymëzimi dhe një dëshmi e pavdekshme e historisë dhe sakrificave shqiptare, e cila do të vazhdojë të shërbejë si udhërrëfyes për brezat e ardhshëm.

Fjalët kyçe: historia kombëtare, Afrim Mustafa, luftërat çlirimtare, uniteti kombëtar, historiografia shqiptare.

“Shkruaj se kur ke talentin dhe s’e përdorë është krim.” (Lasgush Poradeci)

Autori Afrim Mustafa na ka sjellë një vepër intelektuale e piramidale të bazuar në të thëna e të dhëna, në rrëfime e përjetime reale, në argumente e fakte konkrete historike...

Me rastin e përrurimit të veprës serioze e dinjitoze, emblematike e enciklopedike para shtatë vjetësh, më 5 maj 2015, në Fakultetin e Studimeve Islame, duke iu drejtuar pjesëmarrësve të pranishëm të këtij përrurimi madhështor, unë pata shkruar: “Prania juaj e madhështon, e solemnizon dhe e kuptimson këtë tubim, duke e kurorëzuar një vepër kapitale dhe enciklopedike-historike të autorit – AFRIM MUSTAFA, i cili falë dëshirës së madhe dhe vullnetit të flaktë, duke investuar shumë mund, djersë e punë, duke kaluar shumë net pa gjumë, punoi vijimisht e intensivisht dhe arriti t’i tejkalojë të gjitha pengesat drejt synimit e qëllimit të caktuar, në realizimin e kësaj vepre madhore të historisë sonë kombëtare. “Fjala ime përsëritet u mirëprit me kureshtje të madhe e interesim të veçantë, gjë që e dëshmon edhe publikimi i saj në disa revista e gazeta. E, tani edhe pas shtatë vjetësh, me rastin e ribotimit të kësaj vepre të autorit në fjalë, ruaj të njëjtin respekt e ngrohtësi njerëzore, si ndaj autorit, po ashtu edhe ndaj veprës së tij, i cili shpreh e kultivon në këtë vepër simbolikën e bashkimit kombëtar, si ide, porosi e program të

Rilindjes Kombëtare, të artikuluar e të kurorëzuar në Lidhjen Kombëtare Shqiptare të Prizrenit (1878-1881), të cilin kur e pyetëm përse këtë vepër madhore kaq vëllimore nuk e keni ndarë në tri vëllime? Ai u përgjigj: – tri ushtritë çlirimtare, UÇK-ja e Kosovës, UÇK-ja e Maqedonisë dhe UÇPBM-ja e Preshevës, Bujanocit dhe e Medvegjës, kishin një ide, një synim e një qëllim të përbashkët – çlirimin dhe bashkimin e trojeve shqiptare, ashtu, siç e kishte edhe Lidhja Shqiptare e Prizrenit, fryma e së cilës, kurrë nuk u zbeh, as nuk u shua, që nga shekulli XIX e deri më sot, dhe se ajo nuk do të shuhet, derisa ideja e synimi dhe qëllimi programatik e politik i Lidhjes së Prizrenit të realizohet tërësisht. Kjo ide frymon e vibron, tejpertej indit thelbësor në veprën integrale të autorit Afrim Mustafa, vepër kjo që përfaqëson një vlerë kapitale, emblematike dhe enciklopedike, e shkruar me një gjuhë të pastër e stil të rrjedhshëm e të latuar lapidar. “Gjëja kryesore është, të shkruash sa më tepër. Lapsi është krijuesi dhe mësuesi më i mirë dhe më i mrekullueshëm i të shprehurit” (Ciceroni) dhe se “Lapsi është gjuha e mendjes” (Servantesi). Ndërsa, shkrimtari ynë i shquar, Lazgush Poradeci këshillon: “Shkruaj, se kur ke talentin dhe s’e përdorë, është krim”. Madje, sipas këshillave dhe mësimëve të Kuranit, ngjyra apo lapsi, me të cilën shkruan shkencëtari



ose shkrimtari, është e barabartë me gjakun që derdh dëshmori në fushëbetejë kundër armikut, për çlirimin e popullit e atdheut të vet.

Format dhe mënyrat e luftës për çlirim kombëtar janë të shumta dhe të ndryshme, por ne mund të dallojmë e të veçojmë tri mënyrat më të shquara, më thelbësore, më të rëndësishme e më përmbajtësore, e këto janë: Lufta dhe rezistenca me dituri, me pasuri dhe me trimëri, me jetë me gjënë më të shenjtë e më të shtrenjtë të njeriut, që sakrifikon dhe flijon jetën e vet në luftën konkrete me armë në dorë, ballë përballë me armikun, bie dëshmor, bëhet kurban dhe themel i lirisë së popullit dhe atdheut të vet, vdekja e të cilit nuk duhet vajtuar. Sepse, ai ka fituar krenarinë e lavdinë, pavdekshmërinë dhe përjetësinë historike. Mirëpo, lufta nuk bëhet pa armë e pa pasuri, pa dituri e pa diplomaci dhe pa strategji, madje, këta janë faktorë bazë, që i paraprijnë, e zhvillojnë dhe udhëzojnë luftën konkrete në fushëbetejë. Faik Konica, një

intelektual i ditur e i ngritur, me nam e famë, një poliglot e diplomat i spikatur, shkrimtar e atdhetar i dalluar dhe i shquar, për t’u arsyetuar para popullit, me përvujtni e modesti, me përulësi e sinjeritet njerëzor tha: “Unë nuk jam njeri i luftës. Palla (shpata) ime është pena. Me këtë, përpiqem t’i ndihmoj atdheut.” Edhe, në fillim shekullin XXI, eprorët ushtarakë të KFOR-it, kur i shkuan Mehmet Gjevorit, autorit të abetares shqipe e flakakadanit të arsimit kombëtar, e gjetën duke shkruar me laps në dorë në tavolinën e tij të punës, i trokitën në dritare dhe e pyetën:

– A ke armë?

– Po kam – iu përgjigj Mehmet Gjevorit.

– Ku i ke armët? –Ja ku i kam, -ngriti lapsin. Lapsi është arma ime, me të cilën, tërë jetën i kam ndihmuar popullit tim. Ata qeshën dhe shkuan. Ndaj, edhe autori i kësaj vepre madhore, i cili falë dëshirës së tij të madhe dhe vullnetit të flakët, diturisë së tij, prirjes dhe talentit për të

shkruar, mjeshtër i fjalës dhe i pendës, duke investuar shumë energji, mund e punë, duke punuar gjatë kohë, arriti t'i mposhtë, t'i mbizotërojë e t'i tejkalojë të gjitha ngecjet e pengesat, drejt qëllimit e realizimit dhe kurorëzimit të kësaj veprë intelektuale e piramidale të bazuar në të thëna e të dhëna, në rrëfime e përjetime reale, në argumente e fakte konkrete historike.

Mbështetur në faktografi historike, shkencore e publicistike, autori Afrim Mustafa me saktësi e përpikëri, me mjeshtri e dashuri, me seriozitet e dinjitet, si një kronikan i rryer e i vyer, që syrit të tij, nuk i shpëtoi asgjë, ai i përshkroi të gjitha ngjarjet e ndodhitë, të gjitha betejat e ushtarëve dhe eprorëve ushtarakë të të tri ushtrive çlirimtare, duke ndjekur çdo betejë, në çdo hap e në çdo vend, i bëri ngjarje e beteja të përjetshme, ushtarë e eprorë luftarakë e historikë, që do të zënë vend të çmuar dhe të merituar në historiografinë tonë të lavdishme mbarëkombëtare shqiptare. Në këtë mënyrë, autori, mbështetur në themelet e betejave të të tri ushtrive tona çlirimtare, sajoi dhe ndërtoi një veprë të përkryer lapidare me vlera piramidale të historiografisë sonë kombëtare. Tash e tutje, kjo veprë do të shërbejë si një veprë bazë, që do t'ua lehtësojë punën kërkimore dhe shkencore historianëve tanë, që do të marrin mundimin e guximin, vullnetin e durimin dhe synimin, të

merren me ndriçimin dhe studimin e betejave të të tri ushtrive tona çlirimtare në fjalë. Ndaj, kjo veprë nuk mund të anashkalohej, por ajo do të shërbejë si pasurim e argument dokumentimi dhe citimi e dëshmi e betejave të zhvilluara.

Me këtë veprë, autori duke qenë edhe vetë një vlerë, ai krijoi një veprë me vlerë jo vetëm publicistiko-shkencore e historike, por edhe me vlerë artistike, sepse edhe historia është art...

Duke pasur parasysh faktin se ngjarjet e ndodhitë, betejat e luftërat, nëse nuk shkruhen, ato nuk ruhen, por shlyhen në arkivin gojor e mendor. Sepse, kujtesa për to, mund të pësojë ndryshime e variantizime, ose zbehet e zhduket, krejtësisht. "Kujtesa është gjah, kurse shkrimi është kurth" (f.j.u). Ashtu siç e zë kurthi gjahun e nuk e lëshon të ikë dot, po ashtu, edhe shkrimi e zë kujtesën dhe e përjetëson. Me këtë veprë madhore publicistiko-shkencore të historisë sonë kombëtare, autori i nderuar, Afrim Mustafa e ka pasuruar literaturën për historinë tonë kombëtare, duke përjetësuar shumë beteja e përleshje kundër armikut të egër e barbar serbo-sllav dhe i ka vënë në bazamentin faktiko-historik, shumë viktima e shumë dëshmorë e heronj, gjaku i të cilëve na sollti lirinë, i ka bërë të pavdekshëm, sepse liria fitohet, ajo nuk dhurohet. Ajo është e shenjtë dhe shumë e shtrenjtë. Ndaj,

me ndërgjegjësini e përgjegjësini më të lartë njerëzore e kombëtare, duhet ta çmojmë e ta gëzojmë, duhet ta ruajmë e ta vlerësojmë, siç i ka hije një populli liridashës e paqedashës. “Ne duhet të përpiqemi vijimisht e intensivisht, që ta ndërtojmë e lulëzojmë atdheun tonë, që të jemi të denjë e krenarë, që jetojmë në të, e nëse është nevoja, edhe të vdesim për të” (Harri Fulc).

Populli ynë, qytetarët tanë, ashtu siç mburremi e krenohemi me luftëtarët, dëshmorët e heronjtë tanë, po ashtu, mburremi e krenohemi edhe me njerëzit e dijes e të pendës, të artit, të kulturës e të teknikës, që kanë shkruar dhe afirmuar vlerat historike dhe artistike, të kombit dhe të atdheut tonë. Sepse, shkolla shqipe, shkronjat e alfabetit shqip janë të lara e të shkruara me gjak. “Më vrisni, por lejoni, që gjaku im të shërbejë për ngjyrë, që t’i shkruani shkronjat e alfabetit shqip” (Petro Nino Luarasi). Autori, me punën e vet të lodhshme e të mundimshme, por të ngulmët, të vullnetshme e të ndërgjegjshme publicistiko-shkencore, fillimisht, krijoi idenë (bëri skicimin skeletor), e hartoi planin e realizimit dhe të jetësimit të saj, i dha shije e kuptim, vlerë e qëllim kësaj vepre të dobishme e shumë të rëndësishme, për të gjithë pjesëtarët e hisedarët e kombit shqiptar, kudo që gjenden ata, në rruzullin tokësor, sepse të gjithë kontribuan në fitoren e lirisë.

AFRIM MUSTAFA ka bërë një punë serioze, shkencore dhe dinjitoze, humane e njerëzore dhe vepra e tij monumentale, mund të konsiderohet kryepërmendore e përmendoreve.

Pra, me këtë vepër, autori, duke qenë edhe vetë një vlerë, ai krijoi një vepër me vlerë, jo vetëm publicistiko-shkencore e historike, por edhe me vlerë artistike, sepse edhe historia është art. Ndaj, në këtë rast e çast, mund të themi me plot gojën se, autori AFRIM MUSTAFA ka bërë një punë të mirë serioze, shkencore dhe dinjitoze humane e njerëzore, me hartimin e kësaj vepre monumentale, që mund të konsiderohet kryepërmendore e përmendoreve. Ndaj, e përshëndesim sinqerisht, e përgëzojmë dhe e urojmë përzemërsisht për këtë vepër madhore, që përfaqëson një përmendore dokumentare me vlerë të lartë enciklopedike të historiografisë sonë kombëtare edhe me rastin e ribotimit e ndërplotësimit dhe pasurimit me vlera të shtuara faktografiko-historike.

Duke i uruar shëndet e vullnet, nxitje e cytje, dashuri e përsosmëri, nga autori presim për të na dhuruar edhe vepra të tjera me cilësi edhe më të lartë shkencore, me stil të rrjedhshëm, me gjuhë të pastër e të qartë të gjuhës sonë të ëmbël e të artë amtare!

Prishtinë, 24 qershor 2022

Grueja në myslimanizmë

Abstrakt

Artikulli trajton rolin dhe statusin e gruas në Islam, duke u fokusuar në mësimet e Kuranit dhe ndikimin transformues të Hazreti Muhammedit në përmirësimin e pozitës së gruas në shoqëri. Islami, sipas autorit, sollë një revolucion të vërtetë në mënyrën se si gratë trajtobeshin, duke e ngritur dinjitetin dhe nderimin ndaj tyre në nivel të lartë shpirtëror dhe shoqëror. Duke përdorur fjalët “erhám” dhe “takva”, Kurani thekson rëndësinë e respektit dhe përvulësisë ndaj grave, veçanërisht duke i lidhur ato me rolin e tyre të shenjtë si nëna.

Artikulli analizon gjithashtu ndryshimet që Islami sollë në jetën e grave, duke përmirësuar statusin e tyre si vajza, bashkëshorte dhe nëna. Një nga parimet thelbësore të Islamit është sigurimi i drejtësisë dhe mbrojtjes për gratë, përfshirë të drejtën e tyre për pronësi dhe pavarësi ekonomike. Po ashtu, Islamit i atribuohet shfuqizimi i zakoneve të egra, si vrasja e foshnjave vajza dhe trajtimi i grave si pasuri apo skellever.

Hazreti Muhamedi, pavarësisht jetës së tij si jetim pa nënë dhe baba, shpalli mesazhe që theksonin nderimin dhe dashurinë për prindërit dhe gratë, duke vendosur bazat e respektit dhe drejtësisë që përshkojnë traditën islame. Artikulli përfundon duke vënë në dukje ndikimin e thellë të Islamit në ruajtjen e moralit dhe drejtësisë gjinore, përmes rregullave dhe ligjeve të Sheriatit, të cilat mbrojnë dinjitetin dhe të drejtat e grave.

Fjalë kyçe: *Islami, gruaja, Kurani, Hazreti Muhamedi (s.a.s.), nderimi i gruas, drejtësia gjinore, Sheriati.*

Kurani tuej e përdorë fjalën erhám kundrejt grues e tuej lidhë këtë fjalë me një “vavi-atife” me propozicionin e pastajshëm, çfaq një parim që lypsen volume për koment të tij. Zoti nepër këtë ajet urdhnon: Nderoni me pervûjtní

grát-erhám-qi ju barin juve. Në këtë ajet kemi shumë pika që lypsen marrë para sýshë. E para: Përparandëj as një reformator Besimit, asnjë pejgamber, as një kryetar feje e as një libër i shëjtë nuk i ka kumtue nierzimit ndonjë porosi që gravet duhet me i bâmun nderim.

Urdhni qi në kët rasë leçiti pejgamberi i ynë Hazreti Muhammedi asht mâ i pari e mâ i plotsuemi. Gràt qi mâ parë përdoreshin si kafshë, për mbas këtej do të gjëjshin e nderimin e meritueshëm pranë gjithë nierzimit. E jo vetëm kaq: Edhe Perendija, si për ç' do nieri qi asht n'udhë të tij, përdorë dhe kundrejt gravet po atë fjalë nderimi. A mundet me iu dhanë grues një pozitë mâ e naltë se kjo. Me një fjalë Kurani tuej na vue në një anë perlim ndigjesen ndaj Zotin, në tjetrën ânë na vën detyrë nderimin ndaj gruen.

Siç thamë për gruen Zoti përdorë dhe fjalën tak vâ. Randsín e kësaj fjalë mund t'a kuptojnë vetëm ata qi njohin gjuhen ara bishte. Kjo fjalë s'ep sallte kuptimin e fjalës hurmet (nderim). Prandej me ket fjalë duhet

të kuptojmë jo vetëm nderimin ndaj gruen, por një nderim të tillë qi të jetë mâ i përvûjtë e mâ i pastër. Nepër kët koncepton në jetën e grues u bâ një revolucion i madhnueshëm.

Brahmanët e Budistët qi mbaheshin si tepër fetarë priftnit krishtënë të kuvendeve qi dalloheshin në devocion e së fundi edhe ebrejt qi konsiderojshin vehten për një popull i zëgjedhun e mbajshin këta fëmnen per një plaçke të ndyet qi nuk meriton kurrfarë nderimi. Por Muhammedi qi leu (lindi) në mes të një populli qi vorronte për së gjalli fëmnat edhe

ato qi teprojshin i përdorte si një mjet shfrimit epshuer, me një herë, me zanin e tij të naltë predikoj menyren mâ të thjeshtë të Besimit edhe nderimin e grues; e kët predikim të tij e përsriten edhe shekujt. Po; Zoti asht krijuesi i vërtetë i gjithsis. Por grueja ka një detyrë për me ia veshë nieriut formen e tij nierzore. Prandej Perendija e ka naltsue gruen në mâ të naltën shkallë.

Pika tjetër me randësi e ajetit asht: përdorimi i fjalës er hãm në vend të fjalës së grues. Në përdorim të kësaj fjalë asht marrë para sÿshe mâ i nalti e mâ i fisnikshmi qeUllim: anallëku. Nierzët janë të detyruem me nderue gruen me mâ të madhin nderim përse ajo do të bâhet nânë, do të vuejnjë nepër mjerime, do të bajë mjaftë flije për kërthinin qi do të bartin në bark.

Duhet t'a ndijshin ndjeksat e Qerishta's, Buda's e të Mesi's kët knmtim të Hazreti Mohammedit. Mjerisht se e ndijnë shumë vonë, mbas shumë shekujshë. I madhi Muhammed kishte mbetë pa nânë tuej kënë endë gjasht vjeç. Me gjithë këtë, aj as kët kohë të vogël nuk e kishte kalue në parzmë të nânës; por tu një kujdestare e tij. Vetë pejgamberi kishte lé mbassi i kishte vdekë i atij: Don me thanë se aj qyshë kalama kishte mbetë i pà babë e i pà nânë. Me gjithë këtë fëmi jetim Zoti i Lum vetë Dijenija hyunore e kishte dergue me i mësuem nierzimit nderimin ndaj prindin e ndaj gruen.

Buda lën t'amen, Mesija shqypton se nuk kishte mâ çka ti bante s' âmes e Mohammedi, i pà nânë e i pà babë, kumton urdhnin e Zotit në nderim të prindvet e të grues e nuk mjafton me kaq por shprehë edhe ndâsit e zêmrës së vet të dhimbshme: El' Xhennetu tahte akdamil' ummehât (Xhenneti nën kambë të na-

navet). Xhenneti âsht qellimi kryesuer i besimtarevet: mekanizma e gjithë punëvet të mira. Kët lumni, po, kanë qellim të lutunat, te falunat (n jazë e nemazë), agjinimet e flijet (kurbanët) e Bajramit.

Ky hadith i Hazreti Mohammedit vên nën kambë të nanavet Xhennetin, idhealin mâ të plotnuem të lumnis. Kush i kà nderue mâ tepër se kaq nanat? Mohammedi u kà dhanë po kët pozitë nderimi edhe tezevet.

Thuhet se një ditë vojti para Mohammedit një nieri edhe i rrefej se kishte krye një mkat të madh, edhe kërkoj mënyren se si m'u liruem prej tij. Mohammedi e pyeti:

- A ké nânë?

- Jo.

Po teze?

- Po, o i dërguemi Perendís.

-Atëherë bâni një të mirë asaj, se mundet qi Perendija t'i falë mkatet. Kurani mbasi urdhnnon me ajetin e sipërm nderimin e nanavet, vên edhe kët porosí: "Zoti ju ka kurdoherë nën vrejtye".

Kjo barrë na u vue prej të madhit Zot me qellim qi dashtnín

prindore mos t'a shlyjmë kurrnjisherë prej zêmret edhe kur tërritemi, e jo vetëm për vogjli, kur kujdesi i nânës e dhimbsunija e saj asht prore mbi né.

Pjesa e fundit e ajetit qorton një ves të keq qi ishte i përhapun n' Arabi aso kohe.

Arabët shpërdorshin për dobí të tyne pasunín e jetimavet. Kur jetimët ishin fêmna, mytevelit i merrshin ato me pà-hir; e kështú tuej i zotnue ato, përzijshin me pasuni të vet edhe pasunin e tyne. Si Rromakët e hershëm a po si Inqlizët para tridhetë vjetësh edhe arabët i trejtojshin grát e martueme porsí kalamâj. Burrat bâheshin zotnuesat e pasunivet të gràvet të tyne. E myslimanizmi para tremdhet e sá shekujvet deklaroi se pasunija e grues, edhe e pá-kurrkënd kjo kjoftë, nuk duhet cënuem e damtuem nepër kurrfarë pretextit. Për veç këtij ajet ai morrëm prej Sure'-i Nisa's ka 'dhe shumë ajete tjera në Kurán të ladueshëm qi bâjnë fjalë mbí gruen. Shum janë reformat qi në jeten fêmnore ká pertrim myslimanizmi. Âsht përmirsuem ç' do, fazë nepër të cilën përshekohet grueja: si fëmi, si vajzë, si shoqe e si nânë. Në ç' do shteg të jetës i âsht siguruem grues e drejta e asht mprojtun interesa e saj. Në veprimet reciproke të burrit me gruen, grues i janë siguruem interesa mâ të mdhaja se të burrit edhe janë vuem rregulla qi njohin nderimin e fëmnës.

Duhet të dihet se myslimanizmi nuk asht filosofi mendtare ose një besim dogmatik; të gjitha bazat e myslimanizmit kanë më vehte posibilitetin veprues; janë shpjeguem se si mund të veprohet mbi këto baza. Në sheriatin islam ka parime etiket (esasati-ahlakije) shumë të mrekullueshme; ashtu që asht siguruem edhe për- mbarimi i tyre.

Një ndër sherbime që bëni myslimanizmi kje me shlye zakonet e mbrapshtë të futurit në dhe të foshnjëve. Në Arabi e ndër vise tjera ishte përhapun vesi i shemtueshëm i gjakderdhjes të nieriut për hir të hyunivet të rrëshme e i mbytyes së foshnjëve. E grat ishin më të dhimshmet therore të këtyne legjendave e mizorivet

Kurani na lajmon se, “Kur i lajmojshin ndokujt se Zoti i kishte falë një bi, fytyren e tij ia qarkonte një hije e zezë mjerimi edhe u deshpronte tepër e medje edhe u turpnonte, tuej mëndue se atë pjellë të pa fajshme a do t’u vorronte a po do t’u lënte gjallë për me vuejtun nën mizori”. Sa keq gjykojshin këta nierze fatkeqë! E këtyne të mjerëvet Perendija u ep sihariqin me këto fjalë të madhnueshme: “Ne i mbytni fëmijt t’uej prej frige se ata do të t’iu rrijnë pa hanger, shporiniu këtij mkat të madh, se Perendija si ju ashtu ‘dhe atyne do t’iu apin ushqimin (rizkun)”.

Një ditë në mes të Hazreti Mohammedit e të Kajsi Temimit rrodh ky fjalim; kur i Miri Pejgamber mbante në prehen një vajzë të vogël:

- O Mohammed! I kujt asht ai fëmi që po përkëdhelë ashtu?

- I ëmi, përgjegjet pejgamberi.

- Po t’ ishte ai fëmi i ëmi, ia pret Kajsi, nuk e përkëdhelshe ashtu, por e futshem në dhe për së gjalli.

- Prà ti, i thote zëmër-bardhi pejgamber, jë një fatzi i madh; Zoti të ka mungue ty një dashtni nierzore, më të madhen dhanti që ai i lum ia dha nieriut.

Felligshtin (débauche-fuhës) që plandosi në më të përfrigueshmen dekadencë gruen, myslimanizmi e ndaloj rreptsisht edhe me kurr një mënyrë nuk e lëjoj këtë. Urdhnon po kjo fé myslimane: Bini njëqind shkopi burrit e grues, të xânun në kurvni. Mos t’iu vijë aspak mëshirë në zemër në zbatim të këtij urdhnit të Perendís.

Arabët si katolikët e atëhershëm e si rromakët e dikurshëm as vejushat as robneshat nuk i lëshin m’ u martue; në vend që myslimanizmi lëjoj të martoheshin vejushat edhe iu dha vend robëvet në mes të nierzëvet të lirë, tueji a njoftun atyne të drejtat nierzore.¹

1. Marrë nga revista “Zani i Naltë”, nr. 8, Tetor 1925.

Abstracts in English

Studies

1. Islamic Periodicals in Albania During World War II – The Journal “Kultura Islame”

MSc. Dorian Demetja, Director of the Directorate of Culture, Albanian Muslim Community.

Albanian Islamic periodicals began to take shape in the early 20th century, developing alongside the country’s path to independence. Their role became more defined with the establishment of the Albanian Muslim Community. However, the outbreak of World War II brought an abrupt halt to “Zani i Naltë”, the official publication of the Muslim Community, leaving a significant gap in religious and patriotic education—both of which were crucial at the time.

To fill this void, the Muslim Community of Albania launched “Kultura Islame”, a journal that was published from September 1939 to February 1946. Initially, it served as a monthly publication covering religious, philosophical, literary, moral, and social topics. Over time, its scope expanded to include religious, literary, scientific, and artistic themes, reflecting the evolving intellectual and cultural needs of its readers.

2. The Approach of Classical and Modern Scholars Regarding “Al-Hurūf al-Muqatta‘a” – The Disjointed Letters

Armand Asllani – Editor-in-Chief of the journal “Zani i Naltë”, Albanian Muslim Community.

This paper delves into one of the most intriguing and debated topics in Qur’anic studies: Al-Hurūf al-Muqatta‘a, or the Disjointed Letters, which appear at the beginning of 29 surahs in the Holy Qur’an. These unique letters, pronounced individually rather than

forming complete words, have sparked curiosity and debate among scholars since the earliest days of Islamic thought. Some believe that their true meaning is known only to Allah, while others argue that they carry specific messages that can be interpreted.

Throughout history, scholars—both classical and modern—have proposed various explanations. Some view these letters as symbols of divine miracles, evidence of the Qur'an's inimitability, or signs of the prophethood of Muhammad (peace be upon him). Others suggest that they serve as attention-grabbing devices, divine oaths, or even teaching tools for introducing the Arabic alphabet.

This paper explores these diverse perspectives by examining interpretations found in Qur'anic exegesis (tafsir) and contemporary Islamic literature. While the exact meaning of Al-Hurūf al-Muqatta'a remains a mystery, their presence in the Qur'an continues to inspire curiosity and scholarly exploration, leaving open the possibility of deeper understanding in the future.

Keywords: *Al-Hurūf al-Muqatta'a, Qur'an, classical scholars, modern scholars, Qur'anic miracle.*

Islamic Sciences

3. The Creation of Adam and Hawwa According to Imam Maturidi Dr. Osman Nuri Demir

This article explores Imam Maturidi's perspective on the creation of Adam and Hawwa, shedding light on one of the most significant theological discussions in Islam. Drawing from his interpretations of Qur'anic verses, Maturidi presents a rational and systematic approach to understanding human creation.

According to Maturidi, Adam was both the first human and the first prophet, created from pure and carefully chosen earth that underwent various stages of preparation. He emphasizes that the essence of human creation is unique and perfectly suited to human nature, firmly rejecting any notion that it could be impure or unworthy.

*Maturidi also argues that both Adam and Hawwa originate from the same source, which he refers to as *nafs-i wahida* ("a single soul/self"). He stresses that all humans share this common origin, and there is no inherent superiority between men and women in terms of their creation. While Hawwa is acknowledged as the first woman, Maturidi does not support the widely held belief that she was created from Adam's rib. Instead, he relies strictly on Qur'anic verses and authentic hadiths, distancing himself from speculative narratives.*

What stands out in Maturidi's approach is his emphasis on reason and symbolism. He interprets both the physical and spiritual aspects of human creation in a way that highlights deeper meanings rather than focusing solely on literal interpretations. Most importantly, he

underscores that human superiority is not determined by the manner of creation but by one's actions and moral integrity.

In the end, Maturidi's analysis offers a profound and inclusive perspective on human nature—one that rejects gender-based superiority and instead focuses on equality, responsibility, and moral excellence as the true measures of distinction.

Keywords: *Imam Maturidi, creation of Adam, creation of Hawwa, nafs-i wabida, Islamic theology, gender equality, Qur'an, tafsir.*

History

4. The Arabs Before Islam

Prof. Dr. Qazim Qazimi

This article explores the lives of the Arabs before the arrival of Islam, shedding light on their geographical environment, religious beliefs, cultural practices, education, and social structure. The Arabian Peninsula, a vast desert region with a strategic trade position, was home to a mostly nomadic population that lacked political unity. Society was organized into patriarchal tribes and clans, where loyalty to one's kin was paramount. Social divisions were stark—nobles held power and prestige, while slaves formed the lowest and most marginalized class. The economy revolved around livestock herding and trade, particularly through the caravan routes that connected Arabia to powerful civilizations like Byzantium, Persia, and India.

Culturally, poetry held a central place, serving as a means of storytelling, preserving history, and expressing personal and tribal honor. However, formal education and political institutions were largely underdeveloped. In terms of faith, the Arabs had transitioned from the monotheism of Abraham (peace be upon him) to widespread polytheism, with idol worship being deeply rooted, especially in Mecca. At the same time, Jewish and Christian communities were present in some regions, though they remained a minority.

Arab social traditions placed great emphasis on hospitality, loyalty, and honor, but also included harsh customs, such as the practice of burying infant girls alive due to social and economic pressures. Politically, small Arab principalities such as those in Yemen, Palmyra (Tadmur), and Petra held some influence but were often under the control of larger empires like Byzantium and Persia.

Despite their fragmented and largely unstructured way of life, the arrival of Islam and the revelation of the Qur'an brought a transformation that would unify the Arab people and lay the foundations for one of history's greatest civilizations.

Keywords: *Pre-Islamic Arabs, Jahiliyyah, Arabian Peninsula, tribal society, polytheism, trade, poetry, cultural transformation.*

Philosophy

5. Konak with Edison Nuredin Nazarko

“Konak with Edison” is a profound and poetic meditation on the human experience, exploring the mysteries of existence through the lens of philosophy, art, and poetry. It delves into life’s deepest questions: What is our true purpose? Is life merely a cycle of biological functions, or does it hold a greater meaning? How can we live authentically when so much of our existence seems dictated by predetermined roles and expectations?

The author challenges the idea of living within rigid structures, where every action serves a fixed purpose leading to a predetermined result. Such a life, he argues, is not truly lived but merely performed—like an experiment in a laboratory where human curiosity, struggle, and self-discovery are stripped away. When we prioritize function over meaning, we risk losing the beauty and mysticism that make life worth living.

“Konak with Edison” seeks to walk the winding paths where life’s mysteries reveal themselves, embracing the dilemmas that make us truly human. These challenges should not be avoided or ignored—they must be experienced fully. Only by engaging with the uncertainty and depth of life can we find true fulfillment.

Written in a language rich with metaphor and symbolism, “Konak with Edison” is an invitation to live with awareness, to protect personal freedom, and to seek a life of depth and meaning beyond the surface of everyday existence. The questions it raises are timeless, offering a thought-provoking journey for anyone seeking to understand themselves and the world around them.

Keywords: *freedom, purpose, memory, love, art, poetry.*

Morality

6. Spiritual Ethics and Moral Principles According to Imam Al-Ghazali Prof. Dr. Hajredin Hoxha

This study explores Imam Al-Ghazali’s profound insights into the spiritual and moral dimensions of reading and understanding the Qur’an. Al-Ghazali believed that reciting the Qur’an should not be a mere ritual but a deeply transformative experience that nurtures both the heart and soul. To help believers develop a sincere and meaningful connection with the Word of Allah, he outlined ten key principles.

These principles emphasize the importance of recognizing the greatness of divine

speech, approaching the Qur'an with humility and devotion, engaging in deep contemplation, and removing distractions that hinder understanding. Al-Ghazali encouraged readers to internalize the message of the Qur'an, seeing every verse as a personal communication from Allah, meant to inspire reflection and ethical growth.

According to him, true recitation is not just about pronouncing words but about aligning the tongue, mind, and heart in a way that leads to spiritual elevation and moral refinement. The Qur'an, he argued, should shape one's character, guiding believers toward humility, sincerity, and righteousness.

This article highlights the spiritual depth of Qur'anic recitation, presenting it as a lifelong journey of self-improvement and inner peace. Through Al-Ghazali's wisdom, we are reminded that the Qur'an is not just a book to be read—it is a divine conversation meant to transform our hearts and actions.

Personality

7. Hasan Ef. Nahi – Translator of the Noble Qur'an Resul ef. Rexhepi

This article sheds light on the life and legacy of Hasan Efendi Nahi, a remarkable Islamic scholar whose dedication to faith and education left a lasting impact on Albanian-speaking Muslims. He is best known for completing the first full translation of the Noble Qur'an into Albanian, titled "Kur'ani i Madhëruar".

Born in 1905 in Gjakova, Hasan Ef. Nahi devoted his life to religious scholarship and education. His journey took him to the prestigious Al-Azhar University in Egypt, where he deepened his understanding of Tafsir (Qur'anic exegesis), Arabic grammar, and Islamic jurisprudence (Fiqh). Despite facing political and social challenges, he remained committed to making the message of the Qur'an accessible to Albanians.

His translation, published in 1988, was not just a linguistic achievement but also a spiritual mission. He carefully selected words to preserve the depth and beauty of the Qur'an's message while ensuring clarity for Albanian readers. Unlike literal translations that risk distorting meaning, Hasan Ef. Nahi's approach sought to capture the essence of the Qur'anic text while maintaining its sacred integrity.

His work stands as a monumental contribution to Albanian religious and cultural heritage, shaping generations of believers and enriching Islamic literature in the Albanian language. Through his dedication, he not only brought the words of the Qur'an closer to his people but also strengthened their spiritual and intellectual connection to their faith.

Keywords: *Hasan Ef. Nahi, Qur'an, translation, Albanian language, Tafsir, Al-Azhar, Islamic education, Albanian heritage.*

Recension

8. Review of the Book: “The Bujan Conference: A Cornerstone of Kosovo’s Statehood”, Author: Alban Dobruna Reviewer: Prof. Assoc. Dr. Ilirjana Kaceli

This review explores the book “The Bujan Conference: A Cornerstone of Kosovo’s Statehood (December 31, 1943 – January 1-2, 1944)”, written by Assoc. Prof. Dr. Alban Dobruna. The book delves into one of the most significant moments in Kosovo’s history and the Albanian liberation movement during World War II. The Bujan Conference, held during a crucial historical period, marked the formation of the National Liberation Council for Kosovo and the Dukagjin Plain and led to the adoption of the Bujan Resolution—a groundbreaking document that, for the first time, asserted Kosovo Albanians’ right to self-determination and their aspiration to unite with Albania.

The book thoughtfully examines key themes, structured into four chapters: the education and political formation of Albanian cadres, the organization of the anti-fascist resistance, the decisions made at the Bujan Conference, and the reaction of both the Albanian and Yugoslav communist parties. Dobruna also analyzes how the conference’s resolutions influenced post-war political developments and their lasting impact on Kosovo’s long struggle for independence, culminating in 2008.

The author highlights the historical and political significance of the Bujan Conference, describing it as the first official act advocating for Kosovo’s self-determination. Through a detailed historical analysis, the book provides valuable insights into the long-term political and social consequences of the conference’s decisions. It serves as an essential resource for scholars, historians, and readers interested in the history of Kosovo and the broader Albanian political landscape.

Keywords: *Bujan Conference, anti-fascist resistance, self-determination, Kosovo history, Bujan Resolution, Albanian politics.*

9. Review of the Book: “Bardhësitë e Atdheut” (The Purities of the Homeland) Author: Afrim Mustafa Reviewer: Prof. Dr. Mehmet Halimi

The Importance and Legacy of the Book “Bardhësitë e Atdheut” by Afrim Mustafa. This review explores the significance of Afrim Mustafa’s book, “Bardhësitë e Atdheut” (The Purities of the Homeland), a powerful and deeply meaningful work that stands as a historical and cultural testament to the Albanian nation. Through detailed research and compelling storytelling, Mustafa provides a comprehensive account of the struggles and

sacrifices made by the three Albanian military forces: the Kosovo Liberation Army (UÇK), the National Liberation Army (UÇK) in North Macedonia, and the Liberation Army of Preševo, Medveđa, and Bujanovac (UÇPMB).

More than just a historical record, the book serves as a tribute to the resilience, courage, and unity of the Albanian people. Built on verified facts, eyewitness testimonies, and historical documents, it immortalizes key events and heroic figures who played a vital role in the fight for freedom and national unity.

One of the book's greatest strengths is Mustafa's rich and eloquent writing style, which skillfully blends historical accuracy with a deeply emotional and engaging narrative. His ability to present history with both precision and passion transforms this work into an invaluable contribution to Albanian historiography.

At its core, "Bardhësitë e Atdheut" is a reminder that national freedom is not just won through battles, but also through intellectual and cultural commitment. It stands as a source of inspiration and a timeless testament to Albanian history and sacrifice, ensuring that future generations remain connected to their past and motivated to preserve their heritage.

Keywords: *National history, Afrim Mustafa, liberation wars, national unity, Albanian historiography.*

Retrospective

10. The Role of Women in Islam

This article explores the role and status of women in Islam, focusing on the teachings of the Qur'an and the transformative influence of Prophet Muhammad (peace be upon him) in improving women's position in society. Islam brought a profound shift in how women were viewed and treated, elevating their dignity, rights, and status both spiritually and socially. The Qur'an highlights the importance of kindness and respect toward women, particularly through the concepts of "erhâm" (mercy and family bonds) and "taqwa" (piety and mindfulness of God), reinforcing their sacred role, especially as mothers.

The article also examines the positive changes Islam introduced to women's lives, improving their status as daughters, wives, and mothers. One of Islam's key principles is justice and protection for women, ensuring their right to own property, economic independence, and social dignity. Islam played a crucial role in abolishing harmful pre-Islamic customs, such as female infanticide and the treatment of women as mere property or commodities.

Prophet Muhammad (peace be upon him), despite experiencing the loss of both parents as a child, strongly emphasized the importance of honoring and respecting women and parents. His teachings laid the foundation for a society in which women were recognized, protected, and valued.

The article concludes by emphasizing Islam's enduring role in promoting morality and gender justice. Through the principles of Sharia, Islam continues to safeguard the dignity, rights, and respect of women, ensuring their rightful place in both family and society.

Keywords: *Islam, women, Qur'an, Prophet Muhammad (peace be upon him), women's rights, gender justice, Sharia.*

Rregullat e shkrimit

Çdo shkrim duhet të ketë një strukturë, që duhet të përmbajë në mënyrë të detyrueshme elementët e mëposhtëm:

1. Artikulli duhet të jetë punë studimore e kërkimore, shkencore origjinale.
2. Titulli i artikullit të jetë sintezë e problematikës që trajton. Ai nuk duhet të jetë më i gjatë se 35 karaktere.
3. Të vihet emri i autorit me gradën shkencore përkatëse. Poshtë emrit të jepet pozicioni zyrtar i tij/saj.
4. Poshtë këtyre, në krye të shkrimit, me një paragraf të veçantë mund të jepet një abstrakt, duke radhitur të gjitha nënçështjet.
5. Artikulli duhet të jetë i strukturuar me disa nënçështje, sipas tematikës që shtron.
6. Nënçështja e parë e çdo artikulli duhet të jetë “Hyrja”, ku të jepen qëllimi dhe objektivat që e kanë shtyrë autorin për ta shkruar atë dhe rëndësia e botimit të tij.
7. Të gjithë nëntitujt të jenë me “Bold” dhe shkrim “Italik”, “Times New Roman 12” dhe të paraprihen nga numrat 1, 2, 3, etj.
8. Në fund të artikullit duhet të jetë një nënçështje e posaçme me titull: Sugjerime a përfundime.
9. Artikull duhet të ketë në fund bibliografinë.
10. Artikulli duhet të ketë footnote-a dhe referenca në fund të faqes, për të treguar burimin e një citati a të një informacioni që jepet në tekst dhe duhet të shkruhet me shkrim “Times New Roman 10” dhe të përmbajë: autorin, titullin e veprës, shtëpinë botuese, vitin dhe vendin e botimit, numrin e faqes nga është marrë citati. Shprehjet e marra ekzaktësisht nga materialet e tjera të botuara më parë duhet të jenë në thonjëza.
12. Kur informacioni merret nga interneti, duhet shënuar data; p.sh., 10 maj, 2008. Në fund të footnote-s vihet pikë dhe ajo rregullohet me «Justify».
13. Artikulli duhet të jetë jo më pak se 5 faqe dhe jo më shumë se 15 faqe kompjuterike.
14. Artikulli duhet të respektojë rregullat gramatikore të gjuhës shqipe standarde.
15. Shkrimi duhet të jetë “Times New Roman” me “Spacio 1”. Të mos mungojnë shkronjat “ç” dhe “ë”. I gjithë teksti të jetë “Justified”.

